

**Banka popullore e Republikës së Maqedonisë**  
Sektori për mbikëqyrje, rregullativë bankare dhe stabilitet financiar  
Drejtoria për stabilitet financiar dhe rregullativë bankare



***RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË VITIN 2016***

Korrik, 2017

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pranë  
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lektuar).



## PËRMBAJTJA

<b>Rezyme .....</b>	<b>5</b>
<b>I. AMBIENTI MAKROEKONOMIK .....</b>	<b>12</b>
<b>1. Ambienti ndërkombëtar .....</b>	<b>12</b>
<b>2. Ambienti vendor .....</b>	<b>20</b>
<b>II. SEKTORI JOFINANCIAR .....</b>	<b>29</b>
<b>1. Sektori „familje“ .....</b>	<b>29</b>
1.1 Stoku i borxhit dhe cenueshmëria e sektorit “familje” .....	30
1.2 Norma e kursimit, të ardhurat e disponueshme dhe konsumi personal i sektorit “familje” .....	39
1.3 Aktiviteti financiar i sektorit “familje” .....	42
<b>2. Sektori korporativ .....</b>	<b>44</b>
2.1 Realizime të sektorit korporativ .....	45
2.2 Huazimi i sektorit korporativ .....	55
<b>III. SEKTORI FINANCIAR .....</b>	<b>63</b>
<b>1. Struktura, shkalla e përqendrimit dhe përfitimit të sektorit financiar në Republikën e Maqedonisë.....</b>	<b>63</b>
<b>2. Lidhja ndër-sektoriale, kanalet e ngjitjes dhe ndikimi i tyre në stabilitetin financiar .....</b>	<b>68</b>
<b>3. Institucionet depozitare.....</b>	<b>70</b>
3.1 Bankat .....	70
<b>4. Sektori i sigurimeve.....</b>	<b>81</b>
4.1 Karakteristikat dhe rreziqet e sektorit të sigurimeve .....	81
<b>5. Sigurimi pensional i financuar nga kapitali .....</b>	<b>85</b>
5.1 Fondet pensionale të detyrueshme të financuara nga kapitali .....	85
5.2 Fondet pensionale vullnetare të financuara plotësisht .....	92
<b>6. Institucionet tjera financiare (kursimoret, shoqëritë për lizing dhe shoqëritë financiare) .....</b>	<b>96</b>
<b>7. Fondet investuese .....</b>	<b>99</b>
<b>8. Tregjet financiare vendore .....</b>	<b>103</b>
8.1 Tregu i depozitave të pasigurta .....	103
8.2 Tregu primar.....	107
8.3 Tregtia sekondare me letra me vlerë (tregu përmes sportelit) .....	109
8.4 Tregtia sekondare të segmenteve të institucionalizuara .....	110
8.5 Tregu valutor .....	113
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>115</b>

<b>Shtojca nr. 1 Anketa mbi përceptimin e bankave për rreziqet në veprimtarinë e tyre .....</b>	<b>116</b>
<b>Shtojca nr. 2 Testimi i stresit të sistemit bankar të Republikës së Maqedonisë duke zbatuar skenarin e analizës dhe matricën e infeksionit...</b>	<b>121</b>
<b>Shtojca nr. 4 Monedhat digjitale dhe rreziqet që lidhen me to.....</b>	<b>128</b>



## Rezyme

Në vitin 2016, sistemi financiar si dhe ekonomia e RM në tërësi u përballën me një sfidë të madhe në lidhje me stabilitetin si rezultat i ngjarjeve politike në vend të cilat kulminuan në prill dhe maj të vitit 2016 dhe u reflektuan në rrjedhat e sistemit bankar. Megjithatë, sistemi financiar në Maqedoni në vitin 2016 arriti të ruan stabilitetin e tij. Për këtë kontribut kyç ka Banka popullore në drejtim të ruajtjes së stabilitetit të kursit valutor, në drejtim të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve si një objektiv parësor, por edhe si përkrahje e stabilitetit financiar si një objektiv ligjor i Bankës popullore, së bashku edhe me menaxhimin e likuiditetit të bankave, të cilat më së shumti i ndjenë pasojat nga ngjarjet e prillit dhe majit.

**Ambienti ndërkombëtar ngeli i cenuar edhe në vitin 2016**, i përcjellur me rreziqe në raport me ecurinë e rikuperimit të eurozonës dhe rreziqeve gjeopolitike, efektet e Bregxit, efektet e zgjedhjeve presidenciale në SHBA si edhe josisuria në relacion me çmimet e produkteve primare në tregjet botërore. Paralajmërimet e kryetarit të ri Amerikan për mundësi të rritjes së nivelit të proteksionizmit në nivel të tregjeve globale si dhe vendimit të referendumit Britanik për dalje nga Unioni Evropian, mund ti shkaktojnë një grusht perspektivave për ekspansion të qëndrueshëm dhe të fuqishëm të ekonomive, ku investimet do ishin viktime e parë si pasojë e lidhjes së tyre të ndërsjellë me rrjedhat tregtare. Përveç pasigurisë së rritur të agjentët ekonomik, ngjarjet e këtilla në ambientin ndërkombëtar nuk kanë ndonjë efekt të theksuar ndaj ekonomisë vendore.

**Zhvillimi i pandalshëm tekniko-teknologjik si dhe inovacionet digjitale të vazhdueshme të pranishme në rrjedhat ekonomike në gjithë botën nuk i anashkalojnë as edhe financat.** Institucionet financiare shumë e më shumë shfrytëzojnë IT-sisteme të sofistikuar dhe në mes veti janë të ndërlidhur me qendra të dhënave komplekse, sisteme të pagesave dhe sisteme të shlyerjeve-barazimeve, të cilët e lehtësojnë realizimin e aktiviteteve financiare, por edhe njëkohësisht e rritin ekspozimin e rreziqeve operative dhe e theksojnë nevojën e rezistencës ndaj rreziqeve kibernetike si një lloj i veçantë i rrezikut operativ. Gjithashtu, rritja e fortë dhe aplikimi i inovacionit digjital në financa (të njohura si "Fintek") kërcënohen tërësisht ta ndryshojnë paraqitjen në botën financiare. Përdorimi i valutave digjitale, si alternativë e valutave sovraane, apo të financuara nëpërmjet përmes ofertave fillestare e të ashtuquajturave koini, si zëvendësim të financimit nëpërmjet tregut të kapitalit, kontribuoi për zgjerimin e mundësive investuese. Megjithatë, këto janë instrumente private dhe të parregulluara, dhe për këtë arsye konsiderohen mekanizma dhe instrumente financiare të një rreziku të lartë. Përvoja e gjertanishme ka treguar se veçanërisht këto inovacione edhe pse me një profitabiliteti të lartë në periudhën fillestare të futjes së tyre, në vete përmbajnë potencial për humbje për investitorin individual, por edhe "pengesa" në të bërit politika në sistemin financiar. Paraqitja e inovacioneve digjitale në financimin e bankave sipas të gjitha gjasave do afektojë disintermediacionin, ndryshime rrënjësore në mekanizmat e pagesave, në kursimet dhe aktivitetet kredituese. Në të njëjtën kohë, bartësit e politikave do të duhet të sigurojnë rezistencë të sistemit financiar si rezultat i sulmeve të shpeshta, depërtim në sisteme dhe incidente e që janë tejet të sofistikuar, të orientuar dhe shumë vështir për tu identifikuar dhe realizim të kontrolleve. Disa organizata me aktivitet parësor në fushën e mbrojtjes së informacionit dhe sistemeve të informacionit, si dhe disa organe rregullator kanë dalë tashmë me standardet për rritjen e sigurisë së hapësirës digjitale. Pas këtyre aktiviteteve, Banka popullore ka zhvilluar një pajisje në bazë të së cilit bankat do të jenë në gjendje të kryejnë vetëvlerësimin e rreziqeve kibernetike, gatishmërinë për t'u përballur me rreziqet potenciale kibernetike.



**Ambienti makroekonomik në ekonominë vendore u ndikua nga paqëndrueshmëria e brendshme politike, e cila filloi në vitin 2015 dhe u thellua më tej në vitin 2016, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit.**

Eskalimi i situatës politike në vend në prill të vitit 2016, shoqëruar me spekulime mbi devalvimin e kursit të këmbimit të denarit dhe stabilitetit të bankave vendore dhe depozitave të deponuara në to, që çoi në një shkatërrim të besimit të publikut në sistemin bankar (veçanërisht më e theksuar te familjet) tërheqjen e shumave më të theksuara të depozitave nga familjet, veçanërisht të pranishme në prill dhe maj të vitit 2016. Tërheqja e depozitave shoqërohej edhe me rritjen e prirjes së familjeve për të disponuar me valutat e gatshme, gjë që shkaktoi një rritje të kërkesës për valutë në tregun e këmbimit dhe në tregun valutor. Në periudhën prill-maj, BPRM intervenoi me neto shitjet e valutave, ndërsa në maj e rriti bazën e normës së interesit, duke zvogëluar njëkohësisht ofertën e bonove të thesarit në përputhje me nevojat e likuiditetit të bankave. Krahas kësaj, u rrit rezerva e detyrueshme për depozitat në denarë me klauzolën dhe qen aktivizuar ankandet për depozita të bankave te BPRM. Të gjitha këto masa, në kombinim menaxhim adekuat të likuiditetit nga ana e bankave, të cilat pa ndërprerë i realizojnë të gjitha kërkesat për pagesa të depozitave, mundësuan stabilizimin e pritjeve të subjekteve ekonomike dhe rrjedhimisht lëvizjet pozitive në tregun valutor, si dhe qetësimin e zhvillimeve të pafavorshme në tregun e depozitave. Në aspekt të stabilizimit të zhvillimeve në pjesën e dytë të vitit dhe ruajtja e mëtejme e vlerësimeve për stabilitet të fundamentit të ekonomisë vendore, në tetor BPRM ndërpreu mbajtjen e ankandëve të depozitave valutore ndërsa duke filluar nga dhjetori, filloi me normalizimin e politikës monetare duke zvogëluar normën bazë të interesit gjatë tri tentimeve, me çka u rikthye në nivelin e fillimit të vitit 2016(3.25). Kundrejt pasigurisë së shkaktuar nga situata e brendshme politike si dhe presioneve spekulative, në vitin 2016 ekonomia e Maqedonisë realizoi rritje reale të PBB prej 2.4%, që edhe pse më e ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak (3.8% në vitin 2015), paraqet realizim solid në krahasim me mjedisin. Në kushte të rënies së investimeve bruto, promotor kryesor të rritjes ishin eksportet neto, të kryesuara kryesisht nga kapacitete të reja të orientuara nga eksporti dhe efekti i favorshëm i çmimeve të importeve të naftës, si dhe konsumi privat, gjatë zhvillimeve të favorshme në tregun e punës dhe pagave. Borxhi i jashtëm, si dhe borxhi publik, po rriten, por ngarkesa me borxh ende është i moderuar.

Borxhi i sektorit korporativ vendor vazhdoi të rritet edhe në vitin 2016 (arriti 66.2% e PBB) me përdorimin më të dukshëm të burimeve të jashtme të financimit për llogari të borxhit të ulët te bankat vendore. Borxhi ndaj jorezidentët kryesisht përbëhet nga huat mes kompanive dhe kreditë tregtare. Në vitin 2016, ngarkesa me bor e sektorit privat ndaj bankave vendore u zvogëlua, por u rrit në raport me besorësit e jashtëm edhe atë kryesisht në bazë të huave të ndërsjella mes kompanive dhe kredisë tregtare. Rritja eventuale e çmimeve të lëndëve të para në bursat botërore do ishte sfiduese për kompanitë vendore, pasi do i rriste shpenzimet e sektorit korporativ, si pasojë e rritjes së çmimeve të komponentëve hyrës në procesin e punës, që mund të bëj presion edhe ndaj çmimeve të produkteve vendore dhe të shkaktoj pritje inflatore më të larta te subjektet vendore. Në vitin 2016 sektori korporativ nuk agregon nivel, tregoi rezistencë ndaj efekteve negative të mjedisit të brendshëm politik të paqëndrueshëm dhe ruajti performancën operationale, të pasqyruar nga rritja e vlerës së shtuar, treguesit e profitabilitetit dhe ruajtja e dinamikës së qëndrueshme të indikatorëve të borxhit dhe efijencës në përdorimin e mjeteve.

Realizimet e larta të kapaciteteve të reja me pronësi të huaj e të orientuara kah eksporti si dhe kontributi i tyre i theksuar në rritjen e eksportit dhe rritjen e PBB nuk përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm që kushtëzon nivelin e realizimit të rrezikut të kredisë në portofolin e kredive të korporatave të bankave vendase dhe realizimin e tyre. Në fakt, këto kapacitete të reja prodhuese janë shumë pak të ngarkuara me borxh te bankat vendore dhe nuk



shfrytëzojnë ndonjë shërbim të rëndësishëm nga to, duke pasur parasysh qasjen më të lehtë në tregjet financiare ndërkombëtare dhe mundësitë për të siguruar financim nga tregu, në kushtet përgjithësisht më të favorshme nga opsionet financiare të disponueshme në Republikën e Maqedonisë. Nga ana tjetër, rritje e kërkesave të kredive nga pjesa më e madhe e pjesës së ngelur të sektorit korporativ në Maqedoni është e kushtëzuar nga nevoja për ristrukturimin e borxhit ekzistues ose investime në stoqe dhe kapital qarkullues që ndikojnë në drejtim të ngadalësimit të rritjes së përkrahjes kreditore nga bankat vendore. Cilësia më e dobët e portofolit kreditues të bankave nga shoqëritë jofinanciare perceptohet nga pjesëmarrja e kredive jofunksionale në gjithsej kreditë e sektorit të korporatave, i cili në fund të vitit 2016 shënonte afër 10%, pavarësisht shlyerjeve të detyrueshme të kryera gjatë vitit rrjedhës. Niveli i kredive jofunksionale, së bashku me leverixhin e lartë (borxh më të lartë krahasuar me kapitalin) të kompanive, janë faktorët kryesor për rritjen e orientimit të bankave drejt mbështetjes së kredive për familjet në periudhën e kaluar disa vjeçare.

Borxhi i **sektorit** "familje" nuk është i lartë (është 23% e PBB-së). Në kushtet e zhvillimeve të favorshme të tregut të punës dhe pagave, borxhi i familjeve vazhdoi të rritet edhe në vitin 2016 me një ritëm më të shpejtë se rritja e aktiveve financiare dhe të ardhurave të disponueshme, gjë që shkaktoi një përqendrim të disa prej treguesve të nivelit të borxhit, likuiditetit dhe aftësia paguese të këtij sektori. Masat rregullatore të vendosura nga BPRM për të ndaluar rritjen e shpejtë të ekspozimit të kredisë në bazë të produkteve të kreditit të destinuara për financimin e konsumit të familjeve (kartelat kreditore, tejkalimet në llogaritë rrjedhëse, kreditë afatgjata të konsumit) kanë mundësuar një ngadalësim të rritjes së huamarrjes së familjeve mbi këtë bazë, si dhe në normën vjetore të rritjes së borxhit të përgjithshëm ndaj këtij sektori (i cili megjithatë akoma është dy shifror). Edhe pse nuk është vërejtur ndonjë realizim i rëndësishëm i rrezikut të kredisë në portofolin e familjeve, përsëri është i nevojshëm monitorimi i kujdesshëm i rreziqeve. Aktiviteti kreditues i bankave për financimin e konsumit të familjeve shënoi një rritje solide, gjatë lehtësimeve të kritereve kreditore (norma më të ulëta por të rregullueshme, maturim më të gjatë dhe siguri më të ulët), i cili me një përqendrim më të lartë të borxhit të familjet me të ardhura më të ulëta, imponoi një nevojë për një monitorim të kujdesshëm të rreziqeve të mundshme të borxhit të lartë të segmenteve të caktuara në këtë sektor. Rritja e miratimeve të kredive banesore, me afat të gjatë, me komponentë valutore dhe normë interesi të përshtatshëm, ndërlihet me aktivitetin e sforcuar të ndërtimitarisë në vendin tonë në vitet e fundit por edhe rritjes së kërkesës së patundshmërive. Zhvillimet e këtij tregu kanë një natyrë dukshëm pro-ciklike, ku pabarazitë e mundshme në tregun e patundshmërive, zakonisht ndërlihen me stabilitet financiar të cenuar. Megjithatë, bankat e RM kanë një qasje mjaft të kujdesshme për kreditimin banesor me kërkesën për një vlerë më të lartë të kolateralit në krahasim me vlerëne kredisë.

Familjet kanë konfirmuar rolin kyç si kreditori më i rëndësishëm i sistemit bankar vendas, nga sjellja e të cilit varet në masë të madhe nga likuiditeti i bankave dhe vëllimi i përgjithshëm i aktiviteteve të tyre.

Kështu, tërheqja e depozitave nga ana e familjeve në tremujorin e dytë të vitit 2016 dhe rritja e sforcuar e konvertimit valutore të kursimeve, pavarësisht nga kostoja e ekspozuar për shkak të interesit të humbur për ç'afatizimin dhe tërheqjen e depozitave nga bankat dhe humbjet në dallimet në kurs për shkak të konvertimit në valutë të huaj, paraqite në stres-test të vërtet për bankat. Krahas qetësimit të shpejtë të situatës në muajt e ardhshëm, megjithatë, deri në fund të vitit 2016, depozitat në të parë dhe depozitat në valutë shënojnë rritjen më të madhe në bazën e depozitave të bankave, që ka të bëjë me situatën akoma të paqëndrueshme politike në vend, si dhe normave të ulëta të interesit. Norma relativisht e ulët e kursimeve familjare, e agreguar (e cila është në një zonë pozitive në tre vitet e fundit,



por ka rënë ndjeshëm në vitin 2016 duke rënë në vetëm 0.8%), paraqet një faktor kufizues për volumin potencial të financimit të aktiviteteve të bankave vendase, kryesisht të orientuara drejt aplikimit të modelit tradicional të biznesit në veprimtarinë e tyre. Megjithatë, depozitat e familjeve vazhdojnë të jenë burimi i vetëm më i rëndësishëm i financimit të aktiviteteve bankare, me një pjesëmarrje prej 49.7% në gjithsej pasivin e sistemit bankar.

**Sistemi financiar i Republikës së Maqedonisë** ka një strukturë relativisht të thjeshtë, me ndërvarësi minimale të aktiviteteve të segmenteve individuale dhe mungesë të instrumenteve dhe shërbimeve financiare komplekse. Stabiliteti i sistemit financiar kushtëzohet nga stabiliteti i sektorit bankar si segment dominues (aktivet i tij merr pjesë me 84.7% të mjeteve të sistemit financiar, përkatësisht me 73.2% të PBB-së për vitin 2016), ku janë koncentruar edhe kursimet e sektorit jofinanciare. Ndërlidhshmëritë pronësore midis institucioneve të posaçme të sistemit financiar, si dhe vlera të kredive që bankat i miratojnë mes tyre, por edhe të institucioneve financiare jobankare, janë relativisht të vogla, kështu që rreziku i infektimit përmes këtyre kanaleve është i kufizuar. Megjithatë, depozitat e institucioneve të tjera financiare, pothuajse edhe të parëndësishme në bazën e depozitave të sistemit bankar, janë veçanërisht të rëndësishme për disa nga institucionet financiare, pasi ato janë një nga investimet e tyre më të rëndësishme. Kështu, shtëpitë brokere, kompanitë e sigurimeve dhe fondet investuese "mbajnë" shumicën e aseteve të tyre si depozita me bankat, stabiliteti i të cilave është jetik për stabilitetin e këtyre institucioneve financiare jo-depozituese. Nga ana tjetër, në mesin e disa prej bankave më të vogla, depozitat nga institucionet e tjera financiare përfaqësojnë gjithashtu një përqindje të konsiderueshme të gjithsej depozitave të këtyre bankave, gjë që tregon se daljet e papitura të depozitave nga institucionet e tjera financiare mund të çojnë në një jostabilitet likuiditeti në disa nga bankat më të vogla.

*Sistemi bankar* e tejkaloi me sukses këtë vit krize, duke ruajtur stabilitetin e saj. Në gjysmën e parë të vitit 2016 ndryshime më të rëndësishme u regjistruan vetëm në treguesit e likuiditetit, edhe pse ato mbetën në një nivel të kënaqshëm edhe pse ato ngelën në nivelet të kënaqshëm edhe në tremujorin e tretë u kthyen në nivelet e zakonshme. Në fund të vitit 2016, depozitat e përgjithshme të sistemit bankar u rritën me 5.4% ndërsa rritja e kredisë, me përjashtimin e efektit të masës rregullatore për shlyerjen e plotë të plasmaneve jofunksionale të mbuluara plotësisht nga korigjimi i vlerës, u mbajt në një nivel solid dhe në fund të vitit ajo ishte 6%.

Në përputhje me masën rregullatore të vendosur, pjesëmarrja e kredive jofunksionale në gjithsej plasmanet e bankave u zvogëluar nga 10.8% në fund të vitit 2015 gjer në 6.6% në fund të vitit 2016. Rreziku për mjetet e veta të bankave ndaj ekspozimit eventuale të rrishtit të kredisë nga kreditë jofunksionale nuk është i lartë për shkak të mbulimit të tyre të lartë me korigjimin vleror të ndarë, por edhe për shkak të vëllimit të kënaqshëm dhe të cilësisë së mjeteve vetanake të bankave.

Në vitin 2016, bankat treguan një fitimit operativ për një të tretën krahasuar me vitin e kaluar, gjë që është veçanërisht e rëndësishme nga pikëpamja e formimit të brendshëm të kapitalit, në kushte të mungesës ose vetëm shuma të vogla të rikapitalizimit nëpërmjet emetimeve të reja të aksioneve. Treguesit e solventitetit dhe të rekapitalizimit të sistemit bankar janë të larta, edhe përkundër zvogëlimeve të theksuara në vitin 2016 e cila më së shumti ishte rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të aktivitetit të ponderuar me rreziqe. Ndryshimet e reja të Ligjit për bankat që filloi të zbatohet nga marsi i vitit 2017, do të thotë një modernizim i rëndësishëm të kornizës rregullatore, duke inkorporuar rregullat e reja të Komitetit të Bazelit dhe Rregulloren evropiane mbi të ashtuquajturat shtresave mbrojtëse të kapitalit, përmbushja e të cilave në mënyrë shtesë do të rikuperoj solventitetin e bankave. Në kushtet e niveleve më të ulëta historike të normave të interesit për depozitat dhe





zvogëlimin të hapësirës për shkurtime të mëtutjeshme, ruajtja e profitabilitetit të lartë në periudhën e ardhshme është një sfidë e rëndësishme për bankat. Kjo, e plotësuar me synimin për braktisje graduale e zbatimit të normave të përshtatshme të interesit në afat mesëm, do të imponoj nevojën e ndryshime në ecurinë e bankave në tregun e kredive dhe depozitave, si dhe në fushën e administrimit të rrezikut.

Edhe pse më pak në vëllim, fondet pensionale janë të rëndësishme kryesisht në rolin e investitorëve institucionalë dhe mjetet e investuara në to janë një komponent i rëndësishëm i aktiveve financiare të familjeve, nga të cilat varen të ardhurat e ardhshme të disponueshme dhe sigurimet sociale të personave fizik. Mjetet në fondet pensionale rriten edhe gjatë vitit 2016 dhe disa vite radhazi shënojnë normë të rritjes mbi 20% (mjete e fondeve pensionale private marrin pjesë me 9.4% në aktivin e sistemit financiar, përkatësisht me 8.1% të PBB, për vitin 2016). Një pjesë e rëndësishme e plasmanit të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare janë në letrat me vlerë shtetërore vendore, dhe në vitet e fundit, rriten investimet në fondet pensionale të ashtuquajturat fondet e tregtuara të bursave që mbartin një rrezik mesatarisht më të lartë të investimeve në instrumentet e borxhit, por gjithashtu edhe një rendiment më të lartë.

Përkundër rritjes së qëndrueshme të mjeteve dhe zgjerimit të gamës së produkteve kompanive të sigurimeve dhe zhvillimit të kanaleve të shpërndarjes përmes të cilave ofrohen shërbimet e sigurimit, aktivitetet e tyre edhe matej kanë ngelur modeste, sidomos në klasën e sigurimit të jetës (mjetet e kompanive të sigurimeve marrin pjesë me 3.5% në mjetet e sistemit financiar, përkatësisht 3% të PBB për vitin 2016). Sektori i sigurimeve karakterizohet me nivel të lartë të solventitetit dhe pozita të qëndrueshme likuide, si dhe përkushtim gjatë plasmanit të mjeteve të lira (kryesisht në formën e depozitave te bankat vendore dhe letrat me vlerë të lëshuara nga shteti).

Segmentet e mbetura të sistemit financiar kanë pak rëndësi për sistemin financiar (duke përbërë 2.4% e totalit të aktiveve të sistemit financiar, përkatësisht 2.1% të PBB për vitin 2016). Përfundimisht bëjnë *fondet investive*, mjetet e të cilëve, megjithëse ende të vogla (me vetëm 0.7% të aktiveve të sistemit financiar), shënojnë në vazhdimësi nivele të larta rritjeje dhe janë një alternativë investimi, për momentin, sjell kthime tërheqëse për investitorët, veçanërisht në kushtet e uljes së normave të interesit për depozitat në banka.

Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e mjeteve të fondeve investuese janë plasuar si depozita, të cilat ngadalë bëhen depozita të rëndësishëm në disa prej bankave vendore. Gjatë tre viteve të fundit, numri dhe aktivi i kompanive financiare si segmenti "më i ri" i sektorit financiar janë në rritje të vazhdueshme, por pa ndryshime të rëndësishme në rëndësinë relative të sistemit financiar. Hyrja e përsheptuar në tregun e kompanive financiare që miratojnë kredi në vlera të vogla, por me tarifa jashtëzakonisht të larta në formën e interesit apo provizioneve dhe kompensimeve të ngjashme imponon nevojën për forcimin e mbikëqyrjes së institucioneve përkatëse ndaj këtij segment të sistemit financiar. Vëllimi i veprimtarive të kursimoreve, kompanive të lisingut dhe shtëpive brokere shënojnë rënie disavjeçare, e ndërsa në vitin 2016 u zvogëluar edhe numri i kompanive të lisingut.

Ndikimin që e kanë *tregjet financiare* në Republikën e Maqedonisë ndaj stabilitetit financiar në vend është më i ulët se ndikimi që zakonisht është karakteristik i tregjeve financiare në ekonominë e zhvilluar, por megjithatë rëndësia e tyre nuk duhet të injorohet.

Tregu valutor i këmbimit dhe roli i Bankës popullore në aspekt të ruajtjes së kursit stabël të denarit kundrejt euros, kanë një rëndësi kyçe jo vetëm në aspekt të qarkullimit të disa segmenteve të tregut financiar në vend, por edhe për ruajtjen e ekuilibrit ekonomik dhe

stabilitetin në kuadër të sistemit financiar. Kjo dëshmohet edhe nëpërmjet qarkullimit të realizuar në tregun valutor në vitin 2016, i cili ishte në një nivel tejte të lartë (77% të PBB), krahasuar me segmentet e tjera të tregut financiar. Rëndësia dhe efikasiteti i këtij tregu erdhën në shprehje sidomos në muajin prill dhe maj të vitit 2016, kur, për të ruajtur qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të denarit kundrejt euros, Banka popullore ka ndërhyrë në tregun valutor duke shitur valuta dhe ka siguruar bankat me likuiditet valutor të nevojshëm në vlerë që përfaqëson 5.3% të vlerës mesatare të rezervave valutore gjatë vitit 2016. Bazuar në përkushtimin e demonstruar të Bankës popullore për të ruajtjes së kursit të këmbimit të qëndrueshëm, në gjysmën e dytë të vitit, u ul pasiguria e subjekteve ekonomike, gjë që rezultoi me ndërhyrje në drejtim të riblerjes së valutave, të cila e tejkaluan sasinë e shitjeve të realizuara në gjysmën e parë e vitit. Me këtë edhe përkundër efektit të disfavorshëm të situatës politike dhe presioneve në tregun valutor, ndërhyrjet e Bankës popullore në tregun valutor në vitin 2016 rezultuan me blerje neto të valutave në vlerë prej 0.7% të rezervave valutore mesatare për gjatë vitit .

Banka popullore dhe Ministria e financave janë emetuesit më aktive të letrave me vlerë në tregjet primare të vendit, nëpërmjet të së cilëve mundësohet realizimi i objektivave të politikës monetare dhe menaxhimit të borxhit publik të shtetit, përkatësisht. Nga ana tjetër, institucionet financiare (parasëgjithash bankat, fondet pensione, kompanitë e sigurimeve) janë investitorë më të rëndësishëm në letrat me vlerë të lëshuara në këto tregje. Prandaj, zhvillimet në tregun primar kanë një rëndësi të madhe në realizimet e këtyre segmenteve institucionale të sistemit financiar. Gjatë vitit 2016, raporti në mes sasisë së ofruar dhe sasisë së kërkuar të instrumenteve në tregun primar, në përgjithësi ishte i balancuar. Diçka më të theksuar në aspekt të oscilimeve të zhvillimeve në mes ofertës dhe kërkesës së instrumenteve në tregun primar ishte në tremujorin e katërt të vitit 2016, kur oferta e letrave me vlerë shtetërore u zvogëluar, duke marrë parasysh lëshimin e mëparshëm të Eurobondit në tregjet ndërkombëtare. Sektori korporativ pothuajse mungon në tregjet primare të letrave me vlerë dhe nuk përdor financimin e tregut, që është një faktor kufizues për një rritje të konsiderueshme të aktiviteteve në këtë sektor. Vlera e përgjithshme e emetimeve të reja të letrave me vlerë të realizuar në vitin 2016 përfshijnë rreth 55.2% të PBB, nga të cilat vetëm 0.2 pikë përqindje llogariten për letrat me vlerë pronësie të emetuara (nga një bankë), ndërsa letrat me vlerë të borxhit të korporatave mungon.

Aktivitetet e rritura të bankave për tregtimin në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara veçanërisht qen evidente në tremujorin e dytë të vitit 2016 për shkak të rritjes së nevojave të likuiditetit gjatë tërheqjes së depozitave nga familjet nën ndikimin e situatës së paqëndrueshme politike në vend. Përkundër rritjes së qarkullimit në treg të depozitave të pasiguruara ndërbankar (që arriti në 8.5% të PBB për vitin 2016), edhe matej bëhet fjalë për një treg i cekët , me në sasi relativisht të vogël të depozitave të tregtuara, kryesisht në afat të shkurtër (brenda ditës). Kjo nga ana e vet siguron një rrezik sistematik modest për bankat vendore, përkatësisht ekspozim të ulët të bankave ndaj rrezikut të infektuar, përkatësisht nga bartja e problemeve eventuale të likuiditetit nga njëra bankë në tjetrën.

Tregjet për mes sportelit janë shumë pak të përdorura për tregtimin sekondar të letrave me vlerë të borxhit dhe transaksioneve repo ndërmjet bankave, me çka kanë pak ndikim të mundshëm në stabilitetin financiar të vendit. Qarkullimi i këtij tregu u rrit në vitin 2016 (arriti në 1.7% të PBB për vitin 2016), që në masë më të madhe rrjedh nga rritja e tregtimit të bonove të thesarit, ndërsa më i moderuar është kontributi i tregtimit të bonove shtetërore. Në të kundërt, qarkullimi i realizuar i repo transaksioneve ndërbankare është më shumë se katër herë më i ulët krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2016 qarkullimi nga tregtimi klasik në tregun sekondar të kapitalit (Bursën e Maqedonisë) është ende i vogël (0,4% të



PBB), me çka konfirmohet roli i reduktuar ndjeshëm dhe tashmë i marginalizuar i këtij tregu në ekonominë vendore, pavarësisht niveleve të rritura të çmimeve gjatë vitit të kaluar dhe lidhjes së bursave të rajon.



## I. AMBIENTI MAKROEKONOMIK

### 1. Ambienti ndërkombëtar

Në vitin 2016, rruajtja e stabilitetit financiar ishte nën ndikimin e sfidave të numërta të shkaktuara nga ambient ndërkombëtar. Periudha e gjatë e normave të ulëta të interesit dhe inflacioni i ulët si dhe rritja e ngadalshme ekonomike ishin karakteristikat themelore të ambientit makroekonomik në të cilin funksiononte sistemi financiar ndërkombëtar. Edhe pse ekonomia globale gradualisht rikuperohej, pasiguria është e lartë dhe buron nga disa burime të natyrave të ndryshme. Pasiguria e zhvillimit të politikës amerikane në lidhje me lehtësimin e fiskalitetit dhe shtrëngimin e politikës monetare, lajmërimet për proteksionizmit dhe masat e kufizimeve tregtare kontribuan në rritjen e rreziqeve për stabilitetin financiar. Ekonomia e eurozonës u rikuperua, por në të njëjtën kohë ishte e ndikuar nga ngjarje të ndryshme që çuan në rritjen e rreziqeve gjeopolitike (Bregxit, votimi i referendumit mbi ndryshimet në kushtetutën e Italisë, zgjedhjet politike në shtetet anëtare, sulmet terroriste) që mund të ndikojnë negativisht në rritjen në të ardhmen. Periudha relativisht e gjatë e inflacionit të ulët dhe normave të ulëta të interesit në të cilat funksiononte ekonomia botërore, si dhe cikli shoqëruar i lehtësimeve në politikën monetare në ekonomitë e zhvilluara mbaron apo afrohet kah fundi. Ekonomisë amerikane po i afrohet "normalizimi i ri", ndërkohë që ekonomisë së eurozonës pritet ti ndodhë pak më vonë. Kjo do të nënkuptonte një ri-normalizim i politikës monetare dhe një mpresje të lakoreve të rendimentit. Prandaj, përveç ndryshimit të kursit të politikës monetare e prishme është edhe vazhdimi i reformave strukturore të cilat janë bazë për rritjen e qëndrueshme ekonomike paralelisht me konsolidimin fiskal. Në suaza evropian dhe ndërkombëtar, sistemi financiar përballet me sfidat që dalin nga kërkesat e reja rregulatore të kapitalit dhe likuiditetit si dhe nevojën për ndryshime të mëtejshme strukturore për të ruajtur dhe rritur profitabilitetin.

Tabela 1  
Treguesit ekonomik  
Në përqindje

Rritja reale vjetore e PBB	2015	2016	2017 projektim	2018 projektim
SHBA	2,6	1,6	2,3	2,5
UE	2,4	2,0	2,0	1,8
Euro zona	2,0	1,7	1,7	1,6
Gjermania	1,5	1,8	1,6	1,5
Inflacioni	2015	2016	2017 projektim	2018 projektim
SHBA	0,1	1,3	2,7	2,4
UE	-0,002	0,2	1,8	1,7
Euro zona	0,033	0,2	1,7	1,5
Gjermania	0,1	0,4	2,0	1,7
Norma e papunësisë	2015	2016	2017 projektim	2018 projektim
SHBA	5,3	4,9	4,7	4,6
UE	9,4	8,5	8,1	7,8
Euro zona	10,9	10,0	9,4	9,1
Gjermania	4,6	4,2	4,2	4,2
Investimet / PBB	2015	2016	2017 projektim	2018 projektim
SHBA	20,3	19,7	20,0	20,6
UE	19,7	19,9	20,0	20,0
Euro zona	19,9	19,9	20,0	20,2
Gjermania	19,2	19,1	19,1	19,2


Burimi: FMN.

reforma më të thella strukturore (në fushën e fuqisë punëtore, produktivitetit, konkurrencës dhe sigurisht politika fiskale).

Në vitin 2016, eurozona kishte rritje ekonomike të ulët por stabile me shpresën se kjo dinamikë do të vazhdojë edhe në vitet 2017 dhe 2018. Promotor kryesor të rritjes ishte kërkesa e brendshme, e cila u ndikua nga niveli relativisht i ulët i çmimeve të naftës dhe nga politika monetare e adaptueshme e BQE. Zbatimi i reformave strukturore në disa shtete anëtare, veçanërisht në fushën e tregut të punës, mbështeti gjithashtu rimëkëmbjen që ndikonte në uljen e normës së papunësisë. Sidoqoftë, shkalla relativisht e lartë e papunësisë dhe niveli i ulët i investimit vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes dhe rritjen potenciale ekonomike, e cila shpreh nevojën për




**Grafik1**  
Normat bazë të interes të BQEdhe FED dhe shtrirja  
Në përqindje



Burimi: BQE dhe BPRM.

**Grafik2**  
Ecuria e mimeve mesatare të naftës së papërpunuar,metaleve dhe ushqimeve  
Euro, Indeks:2005=100



Burimi:FMN.

Shënim: Indeksi i metalit është një indeks i kompozit që përfshin çmimet e bakrit, aluminit, xehet e hekurit, kallajit, nikelit, zinkut, plumbit dhe uranimit.

Dinamika e rimëkëmbjes së disa vendeve të veçanta të eurozonës në vitin 2016 është e ndryshme dhe e kushtëzuar nga ca faktorë specifik. Për ekonominë e Maqedonisë, të një rëndësisë të veçantë janë trendet e aktiviteteve ekonomike me partnerët më të rëndësishëm tregtar. Gjermania, si vendi me peshën më të madhe në këmbimin tregtar<sup>1</sup> të Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, shënoi rritje të qëndrueshme ekonomike dhe pozitive janë edhe pritjet për periudhën e ardhshme. Kjo duhet të jetë një shtytës pozitive për eksportet e Maqedonisë dhe për ekonominë në tërësi, duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të eksportit për një ekonomi të vogël dhe të hapur si Republika e Maqedonisë<sup>2</sup>.

**Në vitin 2016, ambienti ndërkombëtar u karakterizua nga udhëheqja e politikave monetare divergjente nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara.** FED vazhdoi normalizimin e politikës monetare në kushte të arritjeve ekonomike solide të SHBA<sup>3</sup>, ndërsa BQE me politikë monetare stimuluese<sup>4</sup> që kushtëzoi përmirësimin e kushteve ekonomiko financiare në eurozonë. Duke marrë parasysh lidhjen e ekonomisë së Maqedonisë me ekonominë e vendeve të BE-së, politika e BQE-së ka një ndikim në politikën makroekonomike dhe flukset ekonomike në vendin tonë përmes disa kanaleve (kanali financiar, kanali tregtar, kanali i kursit të këmbimit dhe kanali i pritjeve – besimi<sup>5</sup>)

<sup>1</sup>Pjesëmarrja e këmbimit tregtar me Gjermaninë % e PBB për vitin 2016 shënoi 28.2%.

<sup>2</sup>Në vitin 2016, kontributi i eksporteve neto arriti në 0.6% në rritjen e PBB-së.

<sup>3</sup>Në dhjetor 2016, Fed në tregun e parasë rriti normën e interesit me 0.25 pikë përqindje (nga 0.50% në 0.75%) si rezultat i vlerësimeve të FED për përshpejtimin e rritjes ekonomike, si dhe për presione të mundshme inflacioniste në të ardhmen.

<sup>4</sup>Në mars të vitit 2016, BQE ndërmoi një pako masash për të liberalizuar më tej kushtet e financimit në eurozonë. I uli normat e interesit (norma e interesit të operacioneve bazë të rifinancimit nga 0.05% në 0.00%, norma e interesit të depozitave nga -0.30% në -0.40% dhe norma e interesit për sigurimin e kredive brenda ditës nga 0.30% në 0.25%), dhe mori masa shtesë. Është marrë vendim për të zbatuar katër operacione shtesë të shënjestruar të rifinancimit afatgjatë (TLTRO II) me afatë katërvjeçar, duke filluar në qershor 2016, me një normë interesi në nivelin e normës bazë të interesit të BQE. Më pas, për bankat aktiviteti i kreditit të cilëve do të tejkalojë objektivin e caktuar, do të zbatohet norma më e ulët e interesit për vlerën objektivit, por më së shumti në nivelin e normës së interesit të depozitave. Gjithashtu është rritur blerja mujore e obligacioneve në kuadër të programit për lehtësim sasior (nga 60 në 80 miliardë euro) që nga prilli i vitit 2016, gjithashtu, duke përfshirë blerjen e letrave me vlerë të borxhit të korporatave jo-financiare nga eurozona me një rejting të përshtatshëm të investimeve. Megjithatë, në një takim të rregullt në dhjetor, BQE vendosi të zvogëlojë shumën e riblerjes së letrave me vlerë të siguruar brenda programit për lehtësim sasior nga 80 në 60 miliardë euro në muaj (që nga prilli i vitit 2017), por e zgjati afatin e tyre nga gjashtë në nëntë muaj.

<sup>5</sup>Më detajsh në analizën "Periudha e gjatë e normave të ulëta të interesit dhe zbutjes e politikës monetare në eurozonë - efektet në rajon" Anita Angelovska-Bezovska, Ana Mitreska dhe Sultania Bojçeva-Terzijan, faqja e internetit e Bankës popullore, <http://www.nbrm.mk/?ItemID=FF52431A1F645B4D9F25856709D584F6>.




Lidhja e ekonomisë së vendit me vendet e eurozonës tregon mundësinë e derdhjes së goditjeve të mundshme nga eurozona drejt ekonomisë së Maqedonisë.

### **Inflacioni në nivel global për gjatë vitit 2016 në mënyrë graduale sforcohet.**

Rritja ka të bëjë me rimëkëmbjen graduale të çmimeve të produkteve primare, dhe veçanërisht të rritjes së çmimeve të energjisë<sup>6</sup> në tremujorin e fundit të vitit, pas një rënieje të vazhdueshme vjetore në nëntë muajt e parë të vitit 2016. Megjithatë, inflacioni u ruajt në nivel të ulët në eurozonë edhe nën shënjestrimin prej rreth 2% e cila u arit në tremujorin e parë të vitit 2017.

Grafik3

Zhvillimet e rendimenteve të letrave me vlerë dhendryshimet e fletë obligacioneve  
Në poena



Burimi: Shërbim elektronik ndërkombëtar në dispozicion për publikimin e informacioneve. Shënim: Indeksi MOVE është mesatarja e ponderuar e obligacioneve me maturim të ndryshëm dhe tregon ndryshueshmërinë implicite të obligacioneve qeveritare për 30 ditët e ardhshme. Më të zakonshmet janë obligacionet dhjetëvjeçare.

### **Vendimi i Britanisë për të dalë nga Unioni Evropian ("Bregxit") kah mesi i qershorit të vitit 2016, rriti pasigurinë politike dhe ndikoi në paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare.**

Për momentin, procesi i Bregxit nuk përbën rrezikun kryesor të stabilitetit financiar të euro zonës duke pasur parasysh ndikimin e kufizuar në ekonomi<sup>7</sup>. Por edhe krahas kësaj, BQE u rekomandoi bankave dhe institucioneve financiare në kohë të ndërmarrin planet e realokimit të kushteve financiare kah anëtarët tjerë të EU me qëllim më lehtë tejkalimin e procesit të Bregxit. Duke pasur parasysh lidhjen e vogël midis ekonomisë së Maqedonisë dhe asaj britanike, efektet e mundshme direkte të daljes së Britanisë së madhe nga Unioni Evropian ndaj ekonomisë e vendit janë të vogla, por të mundshme janë rreziqet indirekte të ndikimit të Bregxit ndaj Bashkimit Evropian si partneri ynë më i rëndësishëm tregtar. Në këtë kontekst, duhet pasur parasysh se kur Britania e madhe doli nga UE, për marrëveshje tregtare me Britaninë e Madhe nuk do të zbatohet më marrëveshjen e tregtisë së lirë midis UE dhe Republikës së Maqedonisë.

<sup>6</sup>Rritja e çmimeve të naftës është kryesisht për shkak të marrëveshjes së arritur midis anëtarëve të OPEC për të reduktuar prodhimin e naftës dhe gatishmërinë e Ruisë (e cila nuk është anëtare e OPEC) për t'u bashkuar me masat duke reduktuar prodhimin e saj të naftës. Marrëveshja u arrit më 30 nëntor 2016 në Vjenë dhe filloi të zbatohet nga 1 janari 2017. Marrëveshja do të zbatohet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, me mundësinë e vazhdimet edhe për gjashtë muaj të tjerë.


<sup>7</sup>Raporti i Stabilitetit Financiar, BQE, maj 2017.



Grafik4

Zhvillimet e indeksit të çmimeve të aksioneve (majtas) dhe indekset e ndryshimeve implicite të çmimeve të aksioneve (djathtas)

Në pikë




Burimi: Shërbim elektronik ndërkombëtar në dispozicion për publikimin e informacioneve.

Prandaj, shkëmbimi i ardhshëm tregtar midis Maqedonisë dhe Britanisë së Madhe në masë të madhe do të varet shumë nga përmbajtja e marrëveshjes dypalëshe të tregtisë së lirë, e cila eventualisht do të nënshkruhej midis dy vendeve. Mos nënshkrimi i një marrëveshjeje të tillë do të nënkuptonte që tregtia midis Britanisë së Madhe dhe Republikës së Maqedonisë do të bëhej në përputhje me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë të ngarkuar me detyrimet doganore.

Grafik 5

Rendimenti i obligacioneve shtetërore në Eurozonë (majtas) dhe në SHBA (djathtas)


Në përqindje



Burimi: FED

**Përkundër pritjeve pozitive (në aspektin e rritjes ekonomike, inflacionit, rendimenteve) në muajt e fundit të vitit 2016, tregjet financiare ndërkombëtare vazhdojnë të konsiderohen si një burim rreziku për stabilitetin financiar.** Paqëndrueshmëria e tregjeve financiare ndërkombëtare në vitin 2016 u kushtëzua nga më shumë ngjarje (Bregxit, zgjedhjet presidenciale amerikane, marrëveshja e shteteve anëtare të OPEC dhe treguesit më të mirë ekonomikë në eurozonë në gjysmën e dytë të vitit), gjë që ndikoi në prirjen e investitorëve për të ndërmarrë rrezik. Për gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, rendimenti i i letrave me vlerë shtetërore në SHBA dhe eurozonë shënuan rënie. Ky trend u sforcua kah mesi i vitit me vendim të Mbretërisë së bashkuar për dalje nga Unioni evropian.

**Grafik6**  
Shtrirja e interesit  
Në përqindje



Burimi: Blumberg

Rendimentet në Eurozonë deri në fund të vitit mbetën akoma në nivel të ulët, me çka kontribuan masat e mëtejshme të lehtësimit monetar të BQE. Nga ana tjetër, rendimenti i letrave me vlerë evropiane të borxhit (segmenti 5 deri në 10 vjet) shënuan korigjim në rritje në tremujorin e fundit të vitit 2016 nën ndikimin e rritjes së rendimenteve të letrave me vlerë shtetërore amerikane të kushtëzuara nga vazhdimi i normalizimit të politikës monetare në SHBA. Në këtë kontekst, kah fundi i vitit 2016 dhe fillimit të vitit 2017, rënia e rendimentit të obligacioneve të Maqedonisë kontribuan në ngushtimin e shtrirjes së normës së interesit midis obligacioneve të Maqedonisë dhe të obligacioneve të krahasueshme gjermane.

Pritjet e sforcuara për rritjen e mëtejshme të normave të interesit nën ndikim të shtrëngimit të kushteve monetare nga FED, paraqet një rrezik potencial për mbajtësit ekzistues të instrumenteve me rendiment fikse nga eurozona për shkak të zvogëlimit të vlerës së tregut (çmimeve) të këtyre instrumenteve. Gjithashtu, ripërtëritja e pasigurisë politike mund të ndikojë gjithashtu në rritjen e primeve të rrezikut për instrumentet me rendiment fikse.

**Në vitin 2016, u rritën rreziqet që rrjedhin nga ngarkesa e lartë me borxh të sektorit privat dhe sidomos të sektorit publik të EU,** në kushtet e normave të ulëta të interesit, inflacionit të ulët dhe kushteve të favorshme financiare. Përkundër prirjes së përgjithshme rënëse, në disa vende të BE pjesëmarrja e borxhit të vendit si % të PBB mbeti në nivel të lartë. Qëndrueshmëria e borxhit mund të paraqet një sfidë për disa vende të BE-së për shkak të pritjeve rritëse të normave të interesit dhe rreziku i rritjes së shpenzimeve për rifinancimin e vendeve dhe huamarrjen e ardhshme. Pjesë më e madhe e borxhit të vendit financohet nga sektori bankar që krijon një rrezik të një lidhje prapavajtëse, realizimi i të cilit varet nga aftësia kreditore e këtyre dy sektorëve.






Grafik7

Primi për vendet e caktuara (majtas) dhe bankat (djathtas)

Në përqindje



Burimi: Shërbimi elektronik ndërkombëtar në dispozicion për publikimin e informacioneve.

**Në vitin 2016, bankat në eurozonë vazhduan të përballeshin me një profitabilitet të ulët, me nivele të larta të kredive jofunksionale dhe me sfidën e gjetjes së burimeve të reja të kapitalit.** Mjedisi me norma të interesit dhe të rendimenti në nivel të ulët si dhe rritja e ngadalësuar ekonomike ishte një barrë shtesë në krijimin e të ardhurave nga ana e bankave. E gjithë kjo e vështirësoi rolin e bankave si ndërmjetësues financiar në eurozonë, të cili edhe ashtu u përballën me probleme të pazgjdhura nga kriza globale dhe sfidat e reja (për shkak të nivelit të lartë të kërkesave jofunksionale, profitabiliteti i ulët, nevojës për ndryshime në modelin afarist). Rritja modeste e kredisë pati një ndikim pozitiv në margjinën e interesave, mor megjithatë nuk ishte e mjaftueshme, por gjithashtu edhe paqëndrueshmëria e theksuar e tregjeve financiare, sidomos në gjysmën e parë të vitit 2016, e bëri procesin e rikuperimit edhe më të vështirë. Presionet e tregut u zvogëluan kah fundi i vitit 2016 me rritjen e normave të rendimentit në SHBA dhe pritjet për një rritje të inflacionit në UE. Rritja e çmimit të aksioneve të bankave dhe rritja e pritjes së normave të interesit duhet të japin efekte pozitive në profitabilitetin, duke gjeneruar të ardhura më të larta të interesit.

Njohja dhe sigurimi i duhur i kredive jofunksionale, si dhe gjetja e një **strategjie efektive për zgjidhjen e problemit të nivelit të lartë të kredive<sup>8</sup> jofunksionale** është prioritet i bankave. Në këtë drejtim, iniciativat për zhvillimin e një tregu sekondar efikas që do të mundësojë zgjidhjen e problemit të kredive jofunksionale nëpërmjet sekuritizimit të tyre ose shitjes së kompanive të specializuara që do të menaxhojnë huat jofunksionale. Në thelb, këto janë rekomandimet kryesore të BQE të lëshuar në mars të vitit 2017 ndaj bankave për të trajtuar problemin e nivelit të lartë të kredive jofunksionale<sup>9</sup>.

Në kushte të profitabilitetit të ulët, bankat në UE akoma përballen me **sfidën e gjetjes së burimeve të reja të kapitalit** për përshtatje të mëtejshme të kërkesave për lartësinë e mjeteve të veta dhe shpërndarjen e shtresave mbrojtëse të kapitalit<sup>10</sup>. Një sfidë tjetër është edhe përbushja e kërkesave të Direktivës për rikuperimin dhe zgjidhjen e

<sup>8</sup>Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016, kreditë jofunksionale të bankave në eurozonë përbënin 5.4% të aktiveve të bankave. Por më shumë se një e treta e shteteve anëtare të BE-së kanë një normë të kredive jofunksionale më të larta se 10%.

<sup>9</sup> Guidance to banks on non-performing loans, European Central Bank, Banking Supervision, Mars viti 2017.

<sup>10</sup>Në harmoni me direktivat Evropiane 2013/36 dhe Regullativës Evropiane 575/2013 (Capital Requirements Directive and Regulation).



bankave me probleme<sup>11</sup>, sipas të cilave bankat në UE duhet të kenë instrumente që nëse është e nevojshme, mund t'i transformojnë ato në kapital dhe të forcojnë pozicionin e tyre të solventitetit. Në nëntor të vitit 2016, Komisioni Evropian **njoftoi rishikimin e këtyre rregulloreve (më hollësisht në tekstin në kornizë) me qëllim të rritjes së konsistencës midis kërkesave të rregullatorëve rrjedhëse dhe forcimit të politikave makroprudente, me qëllim të rritjes së stabilitetit të bankave me rëndësi sistemore a me atë edhe stabilitetin e sistemit financiar në tërësi.**

**Ndryshimet e mëdha të rregullatorëve frekuentues që inkorporohen në UE, e që janë orientuar kah rritja e stabilitetit të bankave dhe të sistemit financiar, në përgjithësi,** nënkuptojnë nevojën për monitorimin dhe përshtatjen e rregullativës kombëtar të këtyre kërkesave të reja<sup>12</sup>. Në plan afatgjatë, priten përfitime nga një sistem bankar i shtrënguar, më i mirë i kapitalizuar dhe më i qëndrueshëm në Evropë. Në afat të shkurtër, harmonizimi i kërkesave të reja rregullatore për shumë vende është sfiduese e veçanërisht për vendet e rajonit duke përfshirë këtu edhe bankat në Republikën e Maqedonisë. Kjo është për shkak të faktorëve më specifik: 1) Tendencë e zvogëlimit të ekspozimit të shumicës së bankave evropiane në vendet e rajonit. Nevoja për gjetjen e burimeve të reja të kapitalit, dhe në kushtet e një procesi të pranishëm të shlyerjes së detyrimeve, mund të ndikojë në tërheqjen e aktiviteteve të bankave të rajonit nga eurozona; 2) Zbatimi i kërkesave (standardeve) të reja dhe më të rrepta të kredisë në një nivel të konsoliduar (grupor) që nuk marrin parasysh karakteristikat specifike të vendit ose tregut në të cilin veprojnë këto banka (filialet); 3) Mungesë ose vonesë të vlerësimit për nivelin e përputhshmërisë së kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator të vendeve të rajonit me atë që zbatohet në BE nga autoritetet përkatëse në UE.

**Në të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë, synimi i qartë është ndjekja e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, para së gjithash standardet që zbatohen në UE.** Nga ky aspekt, vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë së kornizës rregullatore dhe mbikëqyrës është e një rëndësie të veçantë për vendet e rajonit. Në fakt, duke pasur parasysh vlerësimin e rejtë të kredites të këtyre vendeve, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kapitalit në UE, bankat në BE të cilat janë të pranishme në rajon, janë të obliguara në deklaratat e tyre të konsoliduara të zbatojnë ponder më të lartë të rrezikut (100%) për investimet e filialeve të tyre në instrumente të emetuara nga pushteti qendror dhe banka qendrore e vendit përkatës, deri sa Komisionin Evropian nuk mer vendim që do të sigurojë që standardet rregullatore dhe mbikëqyrëse në këto vende janë ekuivalente me ato të aplikuara në UE.

Kërkesat më të larta të kapitalit për bankat amë në këtë bazë kanë kontribuar tashmë në kufizimin e ekspozimit të filialeve të bankave të huaja ndaj pushtetit qendror dhe bankës qendrore të vendeve të rajonit, e që ka një ndikim negativ në zhvillimin e politikës fiskale dhe në kanalin e transmetimit të politikës monetare. **Për këtë arsye, të një rëndësie të veçantë për vendet e rajonit është zbatimi i shpejtë i vlerësimit të përshtatshmërisë së kornizës rregullator dhe mbikëqyrës vendor me kornizën Evropiane, e cila duhet të zbatohet nga organet përkatëse të UE.**

Shikuar sipas **llojit të normës së interesit**, pjesëmarrja e kredive të reja të miratuara me normë interesi të ndryshueshme ka rënë në 36.4% në dobi të kredive të reja të miratuara me normë fikse të interesit. Rritja e borxhit afatgjatë me normë të fiksuar të interesit rrjedh nga borxhi (kryesisht të kreditë banesore) te i cili norma e interesit është e fiksuar gjatë disa viteve të para të pagesës së kredisë, periudhë kjo pas së cilës zbatohet normë e ndryshueshme ose e rregullueshme e interesit.<sup>44</sup> Përmes mundësisë për përshtatje të lartësisë së normave të interesit, bankat e transferojnë riskun potencial nga ndryshimi i normave të interesit mbi shfrytëzuesit e kredive. Kjo rezulton me rritje të cenueshmëria së familjeve në rast të lëvizjes së njëanshme të lartë të normave të interesit të bankave, për shkak të pamundësisë për të parashikuar kostot për pagesë të kredive të shfrytëzuara. Synimi i bankave, e nxitur nga Banka popullore, për një ndërprerje graduale të normave të

**Grafik27**


Struktura e borxhit të familjeve sipas produkteve kreditore sipas llojit të normës së interesit



Burimi: Regjistri kreditor i Bankës popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Grafik28**

Norma mesatare e kredive të familjeve sipas llojit të produktit kreditues



Burimi: Regjistri kreditor i Bankës popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

\*Vërejte: Normat e interesit nuk janë të ponderuar.

<sup>44</sup>Rritja e borxhit me normë interesi fikse rrjedh nga rregullat e raportimit, sipas së cilave, kreditë normat e të cilave janë fikse në disa vite të para (mes 3 dhe 5) pas miratimit të tyre (ndërsa pas kalimit të asaj periudhe është parashikuar aplikimi më i shpeshtë i norms së interesit të përshtatshëm), në vitet e para ato raportohen si kredi me normë interesi fikse në shumën e plotë.




përshtatshme të interesit dhe përcaktimit të fiksuar të normave të interesit ose për lidhje të ndryshimit të normave të interesit me faktorë të tregut, do të mundësojë transparencë më të lartë dhe vetëdijesim të rritur të personave për lartësinë e borxhit në pjesën e normës së interesit.

Grafik29

Norma mesatare e interesit të kredive të reja të miratuara për familjet, sipas valutës (majtas) dhe sipas produkteve më të rëndësishme kreditore (djathtas)

Në përqindje




Burimi: Regjistri kreditor i Bankës popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave

Grafik30

Huazimi mesatar për familje në varësi nga të ardhurat mujore

Në mijë denarë




Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Në vitin 2016 vazhdoi trendi i zvogëlimit të normave mesatare të ponderuara të interesit<sup>45</sup> së kredive të reja të miratuara, me çka **çmimi i totalit të kredive ka rënë në nivelin më të ulët në periudhën pas krizës**. Lëvizja rrenëse e normave të interesit është më e shprehur te kreditë me klauzolë valutore, ndërsa te ato në denarë gatisë mbetet pas, me çka praktikisht diapazoni në mes kredive në denarë dhe kredive me klauzolë valutore shënon zmadhim për herë të parë në periudhën pas krizës, pas arritjes së nivelit historikisht më të ulët gjatë vitit paraprak. Në kushte të zmadhimit të dallimit në mes kredive në denarë dhe kredive me komponentë valutore vjen në shprehje rëndësia e faktorit të kostos gjatë përzgjedhjes së valutës së financimit nga ana e familjeve.

<sup>45</sup>Normat mesatare të interesit janë të ponderuara për nivelin e pjesëmarrjes të secilit lloji të kredive në totalin e stokut të kredive të familjeve.

Grafik31

Shfrytëzuesit kreditor të rij në sektorin e "familje" dhe pjesëmarrja e kredive të miratuara e këtyre klientëve në gjithsej kreditë e reja të miratuara të sektorit



Burimi: Regjistri kreditor në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave


**Shfrytëzuesit e ri të kredive sjellin një shkallë më të lartë të riskut për mospagesë të kredisë, meqë për to nuk ekziston historiku i kreditimit.**

Numri i shfrytëzuesve të ri të kredive në sistemin bankar, vazhdoi të rritet, dhe në vitin 2016 është dyfish më i lartë se mesatarja për pesë vitet e fundit. Lëvizjet e volitshme në tregun kreditues dhe tregun e punës (ku numërohen edhe zvogëlimi i normave të interesit, lehtësimi i kushteve të kreditimit dhe lehtësimi i kriterit për mbulesë të anuitetit mujorë me të ardhurat mujore të shfrytëzuesve të kredisë, zvogëlimi i papunësisë, zmadhimi i pagës mesatare nominale etj, kontribuuan në zmadhimin e numrit të shfrytëzuesve të ri të kredive, përderisa numri i shfrytëzuesve aktiv të kredive mbeti gati i pandryshuar. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e lartë e miratimit të

kredive të reja për shfrytëzuesit aktual (rreth 80%), impono nevojën për një kujdes më të lartë në ndjekjen e huamarrjes së re të shfrytëzuesve aktual të kredive, parasëgjithash në kontekst të gjasave për shterim të kapaciteteve të tyre financiare për pagesë të borxhit të rritur.

Grafik32

Pozita financiare e familjeve, përbërja dhe norma e rritjes



Burimi: Regjistri kreditor i Bankës popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave

**Ende nuk janë shterur mundësitë për huazim të mëtejme të kreditimit të familjeve, por nuk duhet injoruar rreziqet nga huazimi tepër i lartë i familjeve që kanë nivel më të ulët të ardhurave.**

Rreth një e treta e totalit të stokut të borxhit të familjeve te bankat dhe huazimi i dedikuar për konsum është e përqendruar te kategoria e familjeve me pagë neto të barabartë ose më të ulët se paga neto mesatare për vitin 2016, por ato kanë njëkohësisht edhe shkallën më të ulët të huazimit për familje. Në kushte të lëvizjes rrenëse të nivelit të kostove të jetesës për 0.2%, dhe të rritjes reale të pagave neto mesatare për 2.3%, pjesa e mjeteve të familjeve që "shpenzohet" për pagesë të borxhit zvogëlohet, respektivisht shënon përmirësim.



Rritja më intensive e borxhit në krahasim me depozitat e familjeve rezultoi me një **përkeqësim të pozitës financiare pozitive<sup>46</sup> të sektorit në tërësi**. Rritja vjetore e depozitave të familjeve është gati dyfish më e ulët në krahasim me vitin paraprak, si rezultat i tërheqjes së depozitave nga ana e familjeve në tremujorin e dytë të vitit të shkaktuar nga faktorë vendor të natyrës joekonomike. Paralelisht me përkeqësimin e pozitës financiare të familjeve u shënuar edhe thellim i mëtejshëm i shkallës negative të ndryshimit të saj, dukuri kjo që përpos vitit paraprak u shënuar edhe në vitin 2008 gjatë krizës për shkak të rritjes jashtëzakonisht të lartë të borxhit të amvisërive (për rreth 40%). Në kushte të pritjeve për kthim të plotë të depozitave në sistemin bankar gjatë vitit 2017, si dhe për huazim kreditorë të mëtejshëm të familjeve, nuk duhet të pritët ndonjë ndryshim më i konsiderueshëm i pozitës financiare të sektorit.

## 1.2 Norma e kursimit, të ardhurat e disponueshme dhe konsumi personal i sektorit "familje"

**Në vitin 2016, të ardhurave të disponueshme<sup>47</sup> të familjeve e vazhduan trendin e ngadalësuar të vitit paraprak dhe shënuan rritje prej 1.3% ose 4969 milionë denarë** (shkallë katërfish më e ulët e rritjes në krahasim me atë të vitit paraprak). Rritja e të ardhurave gjithashtu ndërlidhet me lëvizjet e volitshme në tregun e punës, parasëgjithash rritja e punësimit dhe rritja e pagës nominale mesatare për 2.0%. Rritja e të ardhurave të përgjithshëm shënon ngadalësim për shkak të zvogëlimit të ardhurave të prodhuesve individual dhe transfereve private. Norma e rritjes së të ardhurave të përgjithshme është dukshëm më e vogël në krahasim me shkallën e rritjes së daljeve, e që kryesisht rezulton nga zmadhimi i kontributeve për paga për shkak të zmadhimit të numrit të personave të punësuar si dhe nga zmadhimi i të ardhurave nga tatimi i të ardhurave personale si rezultat i zmadhimit të ardhurave të familjeve. Të dhënat ndaj shtetit përfshijnë pjesën më të madhe të dalurave nga të ardhurat e disponueshme.


<sup>46</sup> Pozicioni financiar i ekonomive familjare është diferenca midis kërkesave të bankave (depozitave) dhe borxhit ndaj bankave (kredive). Në këtë analizë borxhi i ekonomisë familjare përjashtohet nga efektet e zhvlerësimeve të detyrueshme sipas kërkesës rregullatore

<sup>47</sup> Për shkak të mungesës së të dhënave të ardhurave të disponueshme në statistikat zyrtare, që nga viti 2007 Banka Kombëtare përgatit të ardhurat e disponueshme të familjeve në vend, e cila është përditësuar çdo vit. Për komponentët e të ardhurave të disponueshme, për të cilat nuk ka të dhëna zyrtare bëhen estimime kështu që të ardhurat e disponueshme të kalkuluar në këtë mënyrë nuk janë gjithëpërfshirëse dhe në strukturën e tyre mundet të mungojnë edhe komponentë tjerë. Të ardhurat e disponueshme paraqesin diferencën e të ardhurave (Fondet e punonjësve, të ardhurat e fermerëve, transferet sociale (pensionet, ndihma sociale, asistencës për të papunët, sëmundje), transferet private, pagesat e interesit nga bankat, të ardhurat nga dividendët, honoraret, të ardhurat nga pronësore dhe të drejtat pronësore, fitimet kapitale, të ardhurat nga fitimet nga llotaritë dhe shpërblime të tjera, të ardhurat nga kursimet e vjetra dhe kthimin, pagesat e interesit të faturave dhe shpenzimeve të punësuarve jashtë vendit) dhe dalëse (interesi Spërkatje, kontributet e paguara në Fondin Pensional, Fondin e Shëndetësisë dhe dalëse punësimit bazuar në transfertat private dhe tatimit mbi të ardhurat personale) e familjeve. Të gjitha komponentët e të ardhurave disponabël janë nominale.



Grafik33


Dinamika e të hyrave dhe të dalurave të ardhurave disponabël dhe shkalla e ndryshimit vjetorë të tyre  
Në milionë denarë në përqindje



Burimi: Përlogaritje të Bankës popullore në bazë të dhënave të dorëzuara nga ESHS, MF dhe DQLV.

Grafik34


Norma vjetore e ndryshimit të komponentëve të hyrave dhe të dalurave të ardhurave disponabël  
Në përqindje



Burimi: Përlogaritje të Bankës popullore në bazë të dhënave të dorëzuara nga ESHS, MF dhe DQLV.

Grafik35

Struktura e të hyrave dhe të dalurave (majtas) dhe kontributi i komponentëve të hyrave dhe të dalurave (djathtas) në rritjen e të ardhurave disponabël  
Në përqindje në përqindje në përqindje në përqindje




Burimi: Përlogaritje të Bankës popullore në bazë të dhënave të dorëzuara nga ESHS, MF dhe DQLV.





Grafik36

Të ardhurat disponabël, konsumi personal dhe norma e kursimit të familjeve  
Në milionë denarënë Në përqindje




Burimi: Përlllogaritje të Bankës popullore në bazë të dhënave të dorëzuara nga ESHS, MF dhe DQLV.

Pjesa e të ardhurave të disponueshme që mbetet për kursim, pas mbulimit të nevojave për konsum personal e përbën të ashtuquajturën **normë të kursimit**<sup>48</sup> të familjeve. Norma e kursimit është 0.8% dhe për të tretin vit radhazi ka vlerë pozitive, që nënkupton se të ardhurave të disponueshme janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat për konsum personal të familjeve. Dinamika e të ardhurave të disponueshme e përcakton kapacitetin për kursim të familjeve, kështu që zvogëlimi i normës së kursimit në vitin 2016 bazohet në rritjen më të shpejtë të konsumit personal në krahasim me rritjen e mungesës së të ardhurave. Në përputhshmëri me këtë, në fund të vitit 2016, u shënuar ngadalësim i rritjes së depozitave të familjeve në banka (është 2.6% kundrejt 4.3% në vitin 2015).

Grafik37

Konsumi personal nominal dhe real dhe normat e tyre vjetore të ndryshimit  
Në milionë denarënë Në përqindje



Burimi: ESHS

Në vitin 2016 konsumi i familjeve shënoi rritje solide vjetore prej 3.8% dhe kishte kontributin më të lartë në krahasim me të gjitha komponentët e konsumit të brendshëm në rritjen e përgjithshme të PBB. Rritja e konsumit personal ndërlihet me zhvendosjet e volitshme të faktorët fundamentale të konsumit. Në fakt, në vitin 2016 është shënuar rritje e mëtejme e masës së pagave dhe masës së pensioneve, por edhe i importit të mallrave për konsum të gjerë dhe tregti të vogël, ndërsa rritje solide kanë shënuar edhe kreditë konsumatore. Njëkohësisht, çmimet më të ulëta të konsumit reflektojnë pozitivisht në optimizmin e konsumit të familjeve. Edhe optimizmi i rritur i konsumit sinjalizon të pritjeve më të volitshme në kontekst të

intensifikim të konsumit personal në kushte papunësisë dhe situatës financiare<sup>49</sup>.

<sup>48</sup>Norma e kursimit të familjeve = (të ardhurat disponabël – konsumi personal) / të ardhurat disponabël.

<sup>49</sup>Sipas të dhënave nga anketat mbi besimin e konsumatorëve. Burimi: Anкета e Komisionit Evropian mbi optimizmin konsumator.


### 1.3 Aktivi financiar i sektorit "familje"

**Aktivi financiar<sup>50</sup> i sektorit "familje" edhe në vitin 2016 u rit me tempo të ngadalësuar**, me një shkallë të rritjes që është me të ulët madje edhe se ajo e shënuar në vitet 2008-2009, pra vitet e krizës. Në kushte të realizimeve solide në ekonominë vendore, kundrejt pasigurisë së shkaktuar nga situatë e brendshme politike dhe presionet spekuluese, pjesëmarrja e aktivitetit financiar në PBB u zvogëluar për herë të parë në periudhën pas krizës duke rënë në 66.0%. Pjesa më e madhe e rritjes së aktivitetit financiar

Grafik38

Kthimi mesatar i ponderuar i aktivitetit financiar dhe kontributi i komponentëve të veçantë në kthimin e përgjithshëm

Në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave, MF, MALAS, KLV dhe Bursa e Maqedonisë.

Shënim: Në përllogaritjen e rendimentit të FA nuk janë inkuorpuar investimet e familjeve në fletëobligacionet e vazhdueshme shtetërore përshkak të pjesëmarrjes së tyre të ulët (0,002%) në strukturën pronësore të fletëobligacioneve.

u shkaktua nga investimet e familjeve në polica për sigurime jetësore (41.0%) si dhe nga mjetet e investuara në fondet pensionale private (37.3%). Për të dytin vit radhazi është shënuar zvogëlim i kontributit të depozitave të familjeve, kryesisht për shkak të destabilizimit të pritjeve të tyre për shkak të problemeve të brendshme politike dhe normave më të ulëta të interesit, por edhe për shkak të rritjes së rëndësisë së komponentëve tjerë të aktivitetit financiar. Investimet e familjeve në polica për sigurim jetësorë janë komponenti me tempo më të shpejtë rritëse e aktivitetit financiar, ndryshimi absolute i së cilës është më i lartë nga ndryshimi i depozitave të familjeve. Megjithatë, edhe te policat rritja është më e vogël në krahasim me vitin paraprak. Investimet në aksione kanë shënuar rënie, që konsiston me aktivitetin e dobët në tregun e kapitalit në vend edhe pranë lëvizjeve pozitive të regjistruara në vitin 2016 dhe alternativat e më të shumta për investime të familjeve me fillimin me punë të platformës "CEE Link"<sup>51</sup>.


<sup>50</sup>Për nevojat e kësaj analize, sipas vlerësimeve të BPRM, 70% nga paratë e gatshme në qarkullim (jashtë bankave) janë të kyçura në AF të familjeve. Aksionet janë përmbledhje e aksioneve të kotizojnë në bursë në vlerë nominale, sigurimi jetësorë është i paraqitur përmes vlerës së shumës së siguruar përmes kontratës dhe anuiteteve vjetore (përfshirë këtu edhe fitimin) të policave për sigurim jetësorë.

<sup>51</sup> Platforma "CEE Link" për momentin përkrah tregti me letra me vlerë në bursën e Zagrebit, Sofjes, Beogradit dhe Lubjanës..



Grafik39

Aktivi financiar i familjeve (lartë) dhe ndryshimi vjetor i komponentëve të veçanta (poshtë)  
Në milionë denarë Në përqindje Në milion denarë Në përqindje




Burimi: Banka popullore sipas të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave dhe kursimoreve, MF, MAPAS, DQLV, ASS dhe KLV.

**Shkalla e kthimit të aktivitetit financiar të familjeve shënoi rritje prej 1.5 pikë përqindësh** si rezultat i fitimeve kapitale<sup>52</sup> të realizuara nga investimet në aksione, ndërsa në pjesë më të vogël edhe nga të ardhurat nga mjetet e investuara në fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare. Edhe pranë zvogëlimit të normave të interesit, depozitat në denarë dhe në deviza edhe më tutje vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në definimin e kthimit të totalit të aktivitetit financiar në fund të vitit. Megjithatë, në kushte të normave të zvogëluara të interesit të depozitave, një pjesë e familjeve i riorientojnë mjetet e tyre drejt formave tjera të kursimit, si investime në fonde pensionale vullnetare, polica për sigurim jetësorë ose pjesëmarrje në fonde investuese të hapura. Shikuar sipas instrumenteve të veçantë, normë më të lartë të kthimit kanë shënuar investimet në aksione, mjetet e investuara në fonde pensionale obligative dhe vullnetare<sup>53</sup> dhe pjesët në fondet e hapura investuese.

Grafik40

Shkalla vjetore e kthimit të instrumenteve të veçanta të aktivitetit financiar  
Në përqindje



Burimi: Banka popullore sipas të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave dhe kursimoreve, MF, MAPAS, KLV dhe Bursa e Maqedonisë.

<sup>53</sup>Shkalla mesatare nominale e të ardhurave nga fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare është llogaritur përmes ponderimit të shkallës së të ardhurave nga fondet e veçanta pensionale në mjetet neto të tyre..



## 2. Sektori korporativ

Gjatë vitit 2016 sektori korporativ vendor në përgjithësi marrë u dëshmuar si mjaft rezistentë ndaj efekteve negative nga mjedisi jostabël politik në vend. Vlera e shtuar e sektorit korporativ shënoi rritje, por më të ngadaltë në krahasim me vitin 2015. Treguesit e profitabilitetit kanë shënuar përmirësim, por një gjë e tillë nuk mundet të thuhet edhe për treguesit e huazimit dhe ato të efikasitetit në shfrytëzimin e mjeteve. Megjithatë, edhe më tutje ekzistojnë dallime të konsiderueshme në treguesit e funksionimit të sektorit korporativ sipas nën-segmenteve të veçanta të tij, që rezultojnë nga elementet idiosinkratike të ndërlidhura me modelin e përzgjedhur afarist të subjekteve të veçanta, strukturën e tyre organizative, cilësinë e menaxhimit dhe shkallën e riskut afarist në punën operacionale. Ruajtja e suksesit operativ të sektorit korporativ ka një rëndësi të veçantë për dinamikën e riskut kreditorë që e pranojnë bankat vendore, e përmes kësaj edhe për pozitën e tyre kapitale, dhe në përgjithësi për ruajtjen e stabilitetit financiar.

Edhe në vitin 2016 vazhdoi trendi i zmadhimit të borxhit të sektorit korporativ për shkak të rritjes së konsiderueshme të shfrytëzimit të burimeve të jashtme të financimit, në llogari të rënies së huamarrjes te bankat vendore. Andaj, në vitin 2016 është shënuar rritje e huamarrjes neto të sektorit korporativ ndaj besorësve të jashtëm dhe rënie e borxhit të tij ndaj bankave vendore. Edhe pse rritja e burimeve të jashtme të financimit të sektorit vendor korporativ kryesisht rezulton nga huazimet në mes kompanive për shkak të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, megjithatë e zmadhon rëndësinë e lëvizjeve në tregjet ndërkombëtare financiare. Sektori korporativ vendor edhe më tej ka pozitë të shkurtë neto-valutore që e thekson rolin e rëndësishëm të ekspozimit ndaj riskut valutorë për qëndrueshmërinë e borxhit dhe realizimeve të sektorit korporativ. Trendi i zvogëlimit të lartësisë së normave të interesit të kredive të miratuara nga ana e bankave vendore vazhdoi edhe në vitin 2016. Komforti kësaj u shënuar edhe ngushtim i diapazonit të kredive të miratuara për sektorin vendor korporativ, në relacion me normat bazë të interesit ndërbankar, që sinjalizon se bankat vendore inkorporojnë premium të zvogëluar për riskun kreditorë në kreditë e miratuara për ndërmarrjet vendore.




## 2.1 Realizime të sektorit korporativ

**Vlera e shtuar<sup>54</sup> e sektorit korporativ vendor<sup>55</sup> në vitin 2016 edhe pranë ambientit politik vendor jostabil, përsëri shënoi rritje të matur. Vlera e shtuar e sektorit korporativ, e shprehur në çmime rrjedhëse dhe në çmime permanente nga viti 2005, ka manifestuar rritje për 6.2% dhe 4.1% përkatësisht.**

Grafik41

Norma vjetore e ndryshimit (majtas) dhe shpërndarja e rritjes së vlerës së shtuar të sektorit korporativ sipas veprimtarive të veçanta sipas çmimeve të vitit 2005 (djathtas)

Në përqindje



Burimi: ESHS.

Shënim: Të dhënat mbi vlerën e shtuar janë të analizuar në bazë vjetore.

Gati të gjitha veprimtaritë e veçanta kanë pasur kontribut pozitiv në krijimin e rritjes vjetore të vlerës së shtuar të sektorit korporativ. Megjithatë, në krahasim me vitin 2015, rritja e shënuar është pak më e vogël, dhe vetëm veprimtaria "industri" ka shënuar shkallë reale negative të ndryshimit. Kontribut më të lartë në rritjen reale të vlerës së shtuar të sektorit korporativ ka dhënë ndërtimtaria, sipas të gjitha gjasave për shkak të zbatimit të projekteve infrastrukturore me financim publik. Kontributi i ndërtimtarisë në krijimin e vlerës së shtuar të sektorit korporativ në vitin 2016 ka shënuar edhe zhvendosjen më të madhe pozitive, në llogari të kontributit të veprimtarive tjera<sup>56</sup>.

<sup>54</sup> Në raport shfrytëzohen të dhëna paraprake për vlerën e shtuar të sektorit korporativ për vitin 2015, ndërsa për vitin 2016 shfrytëzohen të dhëna të përllogaritura të publikuara nga ana e Enti Shtetërorë Statistikorë në mars të vitit 2017.

<sup>55</sup> Sektori korporativ i përfshin shoqëritë tregtare dhe tregtarët-individë të cilët në KKV kanë regjistruar si veprimtari kryesore "industri" (ku janë të përfshira subjektet me aktivitete kryesor "xehetari dhe ekstraktim i gurit", "furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim", "tregti në sasi të mëdha dhe të vogla dhe mirëmbajtje e mjeteve motorike dhe motocikleve", "ndërtimtari", bujqësi, pylltari dhe peshkatar", "transport dhe magazinim", "informata dhe komunikim", "objekte për qëndrim dhe veprimtari shërbyese ushqimore", "veprimtari që kanë të bëjnë me patundshmeritë", "veprimtari profesionale, teknike dhe shkencore", "veprimtari administrative dhe ndihmëse shërbyese". Në sektorin korporativ nuk janë të përfshira subjektet që kanë të regjistruar si veprimtari bazë: "veprimtari financiare dhe të sigurimeve", "administrim publik dhe mbrojtje, sigurim social obligator", "arsim", "veprimtari që kanë të bëjnë me sigurim shëndetësorë dhe social", "art, argëtim dhe rekreacion", "shërbime tjera", "veprimtari të Familjeve si punëdhënës, veprimtari të Familjeve që prodhojnë mall të cilin e shfrytëzojnë për nevoja personale" dhe "veprimtari të organizatave dhe trupave eksterritoriale".

Enti Shtetërorë Statistikorë me rastin e publikimit të dhënave për lëvizjen e PBB dhe kontributin e veprimtarive të ndryshme në krijimin e saj, filloi me zbatimin e metodologjisë ECA 2010 sipas së cilës veprimtaritë tregti në sasi të mëdha dhe të vogla dhe mirëmbajtje e mjeteve motorike dhe motocikleve, "transport dhe magazinim" dhe "objekte për qëndrim dhe veprimtari shërbyese ushqimore" publikohen në mënyrë të integruar, andaj në këtë raport janë të paraqitura bashkërisht nën formulimin "tregti, transport, magazinim dhe hotelieri". Njërendit është përmirësuar përfshirja e veprimtarive në sektorin korporativ, përmes publikimit të dhënave për vlerën e shtuar të subjekteve me veprimtari bazë "veprimtari që kanë të bëjnë me patundshmeritë", "veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike" dhe "shërbime administrative dhe ndihmëse" që janë paraqitur në një kategori.


<sup>56</sup> Më shumë të dhëna për kontributin e veprimtarive të veçanta në strukturën e vlerës së shtuar të sektorit korporativ, ndryshimet e tyre absolute dhe relative dhe kontributin e tyre në ndryshimin vjetorë, edhe atë sipas çmimeve aktuale dhe sipas çmimeve të qëndrueshme të vitit 2005 mundet të sigurohen nga anekset 1 dhe 2.



**Sektori real në Republikën e Maqedonisë funksionon në kushte të hapjes relativisht të lartë, integrimin në rrjedhat ndërkombëtare tregtare dhe ndikimit irelevant mbi çmimet e inputeve dhe outputeve, si rezultat i ç'kahit rëndësi të veçantë për funksionimin sektorit korporativ vendor ka aftësia e tij për**

Grafik42

Norma vjetor e ndryshimit të vlerës së shtuar për punëtorë në sektorin korporativ dhe të kostos së punës për njësi produkti Në përqindje



Burimi: Enti Shtetërorë i Statistikave dhe përlogaritje të Bankës popullore.

Vërejtje: Përlogaritja është realizuar duke marrë për bazë numrin mesatar të punësuarve, i fituar si mesatare e frekuencave tremujore

konkurrencshmërisë së sektorit vendor korporativ është e një rëndësie të veçantë edhe për shkak të rolit të tij në lëvizjet në tregun e punës dhe në krijimin e të ardhurave të disponueshme të popullatës vendore. Kështu kontributi i sektorit korporativ në zmadhimin e numrit të punësuarve në vitin 2016 ishte rreth 40%, ndërsa pjesëmarrja e tij në numrin e përgjithshëm të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në fund të vitit 2016 është mbi 75%. Megjithatë, bruto pagat mesatare të ponderuara të punësuarve në sektorin korporativ<sup>58</sup> në vitin 2016 (ne vlerë prej 28.751 denarë), janë në nivel më të ulët na krahasim me bruto pagën mesatare të përlogarit për të gjithë të punësuarit në vend (32.821 denarë), që rezulton nga shkalla më e lartë e pagave që realizojnë personat e punësuar në sektorin financiar dhe në atë publik.

<sup>57</sup>Të dhënat mbi lëvizjen e vlerës së shtuar për punëtorë dhe kostot e punës për njësi produkti për veprimtari të veçanta janë të prezantuara në aneksin nr.3.

<sup>58</sup>Gjatë përlogaritjes si ponder është shfrytëzuar numri i të punësuarve sipas veprimtarive të veçanta që e përbëjnë sektorin korporativ. Mesatarja është e kalkuluar për bruto-pagat e paguara gjatë vitit 2016 në tërësi. Llogaritja e bruto pagës mesatare të ponderuar të punësuarve në sektorin korporativ është realizuar nga ana e BPRM, duke u bazuar në të dhënat e publikuara nga ana e Entit Shtetërorë të Statistikave për pagat mesatare sipas veprimtarive të veçanta dhe për numrin e të punësuarve sipas veprimtarive.




**Jostabiliteti politik në vitin 2016 nuk shkaktoi çrregullime të konsiderueshme në iniciativën sipërmarrëse në Republikën e Maqedonisë.** Në fakt, në vitin 2016 formimi i subjekteve të reja ekonomike shënoi një rritje të butë krahasuar me vitin paraprak 2015, ndërsa pjesëmarrja e personave juridik të posa themeluar<sup>59</sup> në numrin e përgjithshëm të personave juridik aktiv ka një trend konstant.<sup>60</sup> Nga ana tjetër si rezultat i predispozitave ligjore për veprim me subjektet të cilëve ju është verifikuar statusi joaktiv<sup>61</sup>, në vitin 2016 është shënuar zvogëlim i numrit të subjekteve me llogari të translacioneve të bllokuar. Zvogëlim vërehet edhe te dalja e subjekteve ekonomike ekzistuese nga tregu, e paraqitur përmes ndryshimeve te personat juridik ndaj të cilëve është e hapur procedurë e falimentimit. Nga këtu, erdhi deri në zvogëlim të normës së përafërt të personave juridik të falimentuar<sup>62</sup> nga 3.2% në 2.1%.

Grafik43

Rëndësia relative (majtas) dhe ndryshimi vjetorë (djathtas) i personave juridik të posathemeluar, të bankrotuar dhe të atyre me llogari të bllokuara

Në përqindje



Burimi: Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë dhe Banka popullore e Republikës së Maqedonisë për numrin e llogarive të bllokuara

<sup>59</sup>Në fund të vitit 2016, numri i përgjithshëm i personave juridik jofinanciar të regjistruar më Regjistrin qendrorë të Republikës së Maqedonisë ishte 113978 subjekte (në vitin 2015 ishin 136695 subjekte). Nga këto subjekte eksistuesenë aspektin formal juridik, llogari vjetore deri te Regjistri qendrorë kanë dorëzuar vetëm 59959 subjekte (në vitin 2015 kanë qenë 58920 subjekte), në ç'rast veprimtarive të përfshira në kategorinë e sektorit korporativ i përkasin 53.446 subjekte (52.556 subjekte ne vitin 2015).

<sup>60</sup>Ndryshimet në lëminë e lehtësimit të procedurave për regjistrim të personave juridik të realizuara në disa raste gjatë disa viteve të kaluara, kanë mundësuar që shkalla e ndryshimit të personave juridik të posathemeluar të mos shënojë ndryshime të mëdha gjatë disa viteve të fundit.


<sup>61</sup>Për persona aktiv juridik gjatë vitit konsiderohen personat e regjistruar juridik që kanë dërguar llogari vjetore deri te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. Me dispozitat e reja të Ligjit për Shoqëri Tregtare është e përfshirë procedura për përcaktim të statusit të subjektit joaktiv si dhe mundësitë për fshirje të subjekteve të tilla nga evidence e Regjistrin Qendrorë.

<sup>62</sup>Shkalla e personave juridik të falimentuar është përllogaritur si raport në mes numrit të personave juridik ndaj të cilëve ka filluar procedura e falimentimit gjatë vitit dhe numrit mesatar vjetor të subjekteve juridike aktive që kanë dërguar llogari vjetore deri te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë .

Grafik44

Rëndësia relative dhe ndryshimi i mjeteve të sektorit korporativ (majtas) dhe struktura e mjeteve dhe burimet e financimit të sektorit korporativ (djathtas)

Në përqindje




Burimi: Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë.

**Rritja e totalit të mjeteve të sektorit korporativ në vitin 2016 ishte 4.3% dhe në krahasim me vitin 2015 shënon ngadalësim, që ka shkaktuar edhe zvogëlim të pjesëmarrjes së tyre në produktin bruto të brendshëm.** Pjesa më e madhe e subjekteve të përfshira në suaza të sektorit korporativ vendor, sipas madhësisë së tregtarëve<sup>63</sup>, klasifikohen në kategorinë e subjekteve mikro dhe të vogla. Këto dy grupe participojnë me rreth 98% në numrin e përgjithshëm të subjekteve të sektorit korporativ që kanë dorëzuar llogari vjetore në Regjistrin qendrorë në vitin 2016.

Grafik45

Dekompozimi i treguesve për kthimin e kapitalit dhe rezervave (ROAE) dhe të mjeteve(ROAA)për sektorin korporativ

Në përqindje dhe herë



Burimi: Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë.

Duke pasur parasysh specifikat e personave juridik të kësaj madhësie, raportet e tyre financiare krijohen kryesisht për plotësim të obligimeve të ndryshme ligjore, përfshirë këtu edhe qëllime të tatimit, që imponon dilema mbi politikat e zbatuara të kontabilitetit dhe mbi cilësinë e raportimeve financiare te kjo kategori e subjekteve juridike.

**Në vitin 2016, nuk janë shënuar ndryshime të shprehura në strukturën e burimeve të financimit dhe të mjeteve të sektorit korporativ vendor. Më**

<sup>63</sup>Kriteret për klasifikim të subjekteve në të mëdha, të mesme dhe mikro janë të përcaktuara me nenin 470 të Ligjit mbi shoqëritë tregtare. Klasifikimi i subjekteve në bazë të veprimtarisë, madhësisë dhe rezultatit financiar të realizuar janë të prezantuara në anekset nr. 4, 5, 6, 7 dhe 8, bashkë me treguesit përkatës të funksionimit. Te anekset, treguesit që përmbajnë të dhëna nga pozicione të bilancit të suksesit dhe bilancit të gjendjes, llogariten përmes mesatarizimit të kategorive të bilancit të gjendjes për vitin aktual dhe vitin paraprak.





shumë se gjysma e vlerës kontabël të mjeteve të sektorit korporativ vendor i takon kategorisë së mjeteve jorrjedhëse<sup>64</sup>, të ndjekura nga kërkesat afatshkurta, ndërsa te burimet e financimit me gati 50% participojnë pozicionet kapitale. **Pozicionet hyrëse dhe dalëse të bilancit të agreguar të suksesit kanë shënuar rritje gati identike.** Kështu totali i të ardhurave të sektorit korporativ<sup>65</sup> ka shënuar rritje vjetore prej 6.7%, ndërsa të ardhurat nga shitjet dhe të dalat operative për 6.6%. Dinamika e tillë e pozicioneve hyrëse dhe dalëse shkaktoi rritje të fitimit neto të sektorit korporativ vendor dhe fitimin nga funksionimi i rregullt (fitimi para të dalave financiare dhe tatimit, si përaftrim i fitimit operativ) nga 15.5% në 8.8% në vitin 2016.

Pavarësisht jostabilitetit në ambientin politik vendor, sektori korporativ në vitin 2016 arriti të shënojë përmirësim të profitabilitetit, që konfirmohet përmes **ndryshimeve pozitive të treguesve të profitabilitetit.** Kështu kthimi i mjete mesatare (ROAA) dhe kthimi i kapitalit mesatar dhe rezervave (ROAE) kanë shënuar një rritje të butë në vitin 2016. Bartës kryesorë i përmirësimit të profitabilitetit ishte përmirësimi i margjinës neto të fitimit të sektorit korporativ nga 4.3% në vitin 2015 në 4.6% në vitin 2016, ndërsa efekti nga ndryshimet në qarkullimin e mjeteve dhe në të ashtuquajturin "leverixh financiar" të sektorit korporativ ishin më modeste. Përmirësimi i margjinës së fitimit neto në vitin 2016, kryesisht u shkaktua nga efekti pozitiv i kostove për financim si dhe nga tatimimi efektiv<sup>66</sup>. Kontribut modest kanë dhënë edhe ndryshimet në realizimet operative dhe afariste të sektorit korporativ vendor, të shprehura përmes ndryshimeve në margjinën e profitit operativ. Sipas kësaj, mundet të përfundohet se përmirësimi i profitabilitetit të sektorit korporativ vendor në vitin 2016 kryesisht rezulton nga efektet e vonuara nga çmimet e ulëta rrjedhëse të resurseve financiare dhe shkallës së ulët të tatimit efektiv të fitimit, sesa nga ndryshimet në leverixhin operativ ose përmirësimin e modeleve afariste të përzgjedhura nga ana e ndërmarrjeve. Edhe në vitin 2016 treguesit e profitabilitetit të sektorit korporativ vendor u karakterizuan nga dallimet në shpërndarjen e profitit në mes subjekteve si nga aspekti i madhësisë së tyre, ashtu edhe në aspekt të veprimtarisë kryesore të tyre<sup>67</sup>. Në vitin 2016 rreth 36.3% nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste në suaza të sektorit korporativ kanë paraqitur humbje (36.4% në vitin 2015).

<sup>64</sup>Në kategorinë e mjeteve jorrjedhëse përfshihen mjetet material, mjetet jomateriale, investimet në patundshmëri, mjetet financiare afatgjata dhe kërkesat afatshkurta.

<sup>65</sup>Të ardhurat e përgjithësim të sektorit korporativ i përfshijë: të ardhurat e shitjes, produktet personale të kapitalizuara, të ardhura të tjera nga operacionet ditore të ardhurat financiare, pjesa e fitimit të kompanive të lidhura, fitim neto nga operacionet jo të vazhdueshme (në rastet kur ajo ndodh) dhe efektet pozitive nga tatimet dhe obligimet e prolonguara. Pjesëmarrje më të lartë në strukturën e të ardhurave (mbi 95%) kanë të ardhurat nga shitjet.

<sup>66</sup>Efekti i kostove për financim dhe ai i tatimit fitohet si proporcion në mes fitimit neto pas tatimit dhe fitimit operativ të përafëruar, të fituara në bazë të dhënave të dorëzuara në suaza të raporteve vjetore të dorëzuara pranë Regjistrin qendrorë të Republikës së Maqedonisë.

<sup>67</sup>Treguesit për punën e ndërmarrjeve në suaza të sektorit korporativ, sipas veprimtarisë kryesore të subjekteve, sipas madhësisë së tyre, rezultatet nga funksionimi dhe sipas asaj se bankat vendore a kanë ndërtuar ekspozim kreditorë ndaj tyre, janë të paraqitura në anekset nga 4 deri 9.




Në vitin 2016 nuk janë vërejtur ndryshime të konsiderueshme në qarkullimin e kategorive të ndryshme të mjeteve, që ka ndikuar që **treguesit e efikasitetit në shfrytëzimin e mjeteve të mbeten relativisht stabël. Megjithatë, këto tregues janë në nivel relativisht të ulët**, që çon drejt përfundimit se eksitojnë mangësi të caktuara në funksionimin operativ të subjektet afariste, të cilët duhet ti kushtojnë më shumë vëmendje përmirësimit të procesit të menaxhimit me mjetet. Në vitin 2016 vërehet shkurtim i ciklit operativ neto<sup>68</sup>, por kjo rrjedh nga rritja e numrit të ditëve për pagesë të obligimeve afatshkurta. Duke pasur parasysh faktin se rreth gjysma e obligimeve afatshkurta të sektorit korporativ kanë të bëjnë me obligime ndaj furnitorëve, shkurtimi i ciklit neto-operativ përmes vazhdimit të afatit për pagesë të obligimeve ndaj furnitorëve, sinjalizon rolin e rëndësishëm të financimit të brendshëm sektorial në funksionimin e ndërmarrjeve vendore. Në analizimin e treguesve të efikasitetit në menaxhimin me kategoritë e veçanta të mjeteve, si një faktor risku që mundet të shkaktojë mjegullim të pasqyrës reale të realizimeve të ndërmarrjeve, veçohen edhe politikat e përzgjedhura kontabël të ndërmarrjeve, në veçanti në kontekst të asaj se vlerat kontabël të paraqitura a e reflektojnë realisht vlerën objektive të llojeve të ndryshme të mjeteve. Nga ky këndvështrim shikuar, një rol veçanërisht të rëndësishëm luajnë politikat për pranim dhe vlerësim të mjeteve rrjedhëse, para së gjithash të stoqeve dhe kërkesave, veçanërisht në qoftë se ekziston vjetërsim i stoqeve ose kërkesa të pa arkëtueshme, e të cilat në reflektohen në mënyrë adekuate në shprehjen e vlerave të mjeteve në fjalë.

Grafik46

Ditët e nevojshme për transformimin e zërave nga kapitalit punues neto (majtas) dhe treguesit të likuiditetit (djathtas) të sektorit korporativ

Në ditë dhe përqindje



Burimi: Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë.

Treguesit janë përlogaritur me të dhëna të datës së konkrete, me çka nuk përlogariten vlerat mesatare të kategorive të bilancit të gjendjes.

<sup>68</sup>Cikli operativ neto paraqet vlerësim të kohës mesatare të nevojshme nga pagesa e furnitorëve deri te arkëtimi i kërkesave nga blerësit, përfshirë edhe kohën e nevojshme për transformim të lëndës së parë në produkte të gatshme përmes procesit të prodhimit.




Kapitali punues neto<sup>69</sup> i sektorit korporativ vendor në vitin 2016 ka shënuar rritje prej 8.2%. Kontribut më të madh në këtë rritje kanë dhënë format e ndryshme të kërkesave afatshkurta të ndërmarrjeve, të ndjekura nga rritja e stoqeve dhe nga rritja e mjeteve monetare, ndërsa obligimet afatshkurta kanë kontribuar në drejtim të zvogëlimit të kapitalit punues neto. Këto ndryshime në kategoritë e ndryshme të mjeteve rrjedhëse dhe obligimeve rrjedhëse, kanë mundësuar që **treguesit e likuiditetit të sektorit korporativ vendor të shënojnë përmirësim të butë. Megjithatë, treguesit e likuiditetit vazhdojnë të mbeten në nivel relativisht modest**<sup>70</sup>, ndërsa ekziston edhe një shkallë e lartë e pabarazisë në shpërndarjen e likuiditetit në mes subjekteve të ndryshme që bëjnë pjesë në sektorin korporativ. Kështu, vërehet korrelacion në mes treguesve të likuiditetit dhe rezultateve nga funksionimi i subjekteve, në ç'rast ndërmarrjet që kanë paraqitur humbje nga puna disponojnë likuiditet dukshëm më të vogël. Shikuar nga këndvështrimi i madhësisë së ndërmarrjeve tregues më të ulët të likuiditetit vërehen te mikro ndërmarrjet, ndërsa ato janë kategoria dominuese për nga numri.

Grafik47

Lëvizja e treguesve të përzgjedhur për huazimin e sektorit korporativ

Në herë dhe në përqindje



Burimi: Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë

**Në vitin 2016 treguesit e huazimit të sektorit korporativ qëndruan në nivel relativisht stabël, që dëshmon se ndryshimet në obligimet e sektorit korporativ, në përgjithësi marrë, i ka ndjekur ndryshimet në pozicionin kapital të tij.** Përmirësim është vërejtur te treguesit e mbulesës së kostove të financimit me të ardhurat nga aktivitetet e rregullta<sup>71</sup>, që mundet ti përshkruhet si profitabilitetit të përmirësuar të sektorit korporativ në vitin 2016, ashtu edhe zvogëlimit të çmimit të asaj pjesë të burimeve të financimit për të cilat paguhet interes. Shikuar sipas veprimtarive të veçanta, treguesit e huazimit janë më të lartë te "ndërtimtaria" dhe te veprimtaritë që kanë të bëjnë me patundshmëritë, veprimtaritë profesionale, shkencore, teknike, administrative dhe ndihmëse shërbyese. Kjo duke marrë parasysh varësinë e madhësisë dhe dinamikës së të ardhurave të subjekteve në këto veprimtari nga lëvizjet në tregun e patundshmërive, dëshmon një ndikim të shprehur të aktiviteteve në tregun vendorë të patundshmërive mbi aftësinë e tyre kredituese dhe për pasojë edhe mbi dinamikën e riskut kreditorë të ndërmarrë nga ana e besorëve të tyre, përfshirë këtu edhe bankat vendore. Tregues më

<sup>69</sup>Kapitali neto punues paraqet dallimin mes mjeteve rrjedhëse dhe obligimeve rrjedhëse (afatshkurta) të ndërmarrjeve.

<sup>70</sup>Si nivel i pashkruar, "rule of thumb" ) që konsiderohet si i kënaqshëm

<sup>71</sup>Fitimi nga aktivitetet e rregullta është përlogaritur si dallim në mes të hyrave dhe të dalurave nga puna e rregullt e sektorit korporativ vendor.

të ulët të huazimit vërehen te veprimtaria “bujqësi, pylltari dhe peshkatari”. Tregues dukshëm më të lartë të huazimit kanë subjektet që kanë raportuar humbje nga funksionimi si dhe mikro-ndërmarrjet.

**Analiza e treguesve të funksionimit të sektorit korporativ, sipas asaj se subjektet e sektorit korporativ a kanë obligime ndaj bankave vendore, tregon se dallime më të shprehura vërehen te treguesit e huazimit<sup>72</sup>.** Këto subjekte të sektorit korporativ që kanë huazuar te bankat vendore kanë tregues më të lartë të huazimit në krahasim me subjektet që nuk kanë marrë hua te bankat vendore. Krahas kësaj, subjektet që kanë obligime ndaj bankave vendore kanë edhe profitabilitet më të lartë, që deri diku mundet të sqarohet përmes efektit të ashtuquajtur të leverixhit financiar, që korrespondon me shfrytëzimin e financimit përmes borxhit. Dallimet e vërejtura në profitabilitetin e subjekteve në varësi nga ajo se bankat vendore a kanë ekspozim ndaj tyre, përveç prezencës së borxhit në strukturën e financimit, pjesërisht mundet të sqarohen edhe përmes dallimeve në kontekst të efikasitetit në shfrytëzimin e mjeteve. Në fakt, qarkullimi i të gjitha kategorive të mjeteve është pakëz më u lartë te subjektet që kanë obligime ndaj bankave vendore. Nga ana tjetër, te treguesit e likuiditetit nuk vërehen dallime më të shprehura në varësi nga ajo se a shfrytëzojnë financim nga bankat vendore.

---

<sup>72</sup>Për më tepër detaje rreth treguesve për subjektet që janë pjesë e sektorit korporativ që kanë obligime ndaj bankave vjetore konsulto të dhënat e paraqitura në anekset 9 dhe 10.



### Krahasim i realizimeve të kapaciteteve të reja prodhuese në pronësi të huaj të orientuara drejt eksportit me tërësinë e sektorit korporativ në Republikën e Maqedonisë

Gjatë disa viteve të fundit, trendi i realizimeve të volitshme në sektorin eksportues dhe kontributi pozitiv i importit të mallrave në krijimin e prodhimitarisë bruto të brendshme, si dhe në mbajtjen e deficitit në llogarinë rrjedhëse në nivel të matur, në masë të madhe rrjedhon nga funksionimi i kapaciteteve të reja prodhuese në pronësi të huaj, kryesisht në zonat zhvillimore teknike-teknologjike. Për ilustrim, në katër vitet e fundit, kontribut më të lartë në rritjen vjetore të eksportit nga Republika e Maqedonisë kishte eksporti i makinave dhe mjeteve transportuese, që në masë dërmuese ka të bëjë saktësisht me funksionimin e kapaciteteve në fjalë. Me qëllim të shqyrtimit të rëndësisë së kapaciteteve të reja prodhuese të orientuara drejt eksportit në realizimet e tërë sektorit korporativ në Republikën e Maqedonisë, është realizuar një analizë krahasimore e realizimeve të agreguara të tyre dhe realizimeve të pjesës tjetër të sektorit korporativ. Për këtë qëllim janë identifikuar 19 subjekte që sipas karakteristikave të tyre mundet të veçohen si kapacitete të reja prodhuese në pronësi të huaj të orientuara drejt eksportit.

Këto ndërmarrje kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në tërësinë e sektorit korporativ, edhe atë si në rezultatet e realizuara nga funksionimi ashtu edhe në kategoritë e ndryshme bilancore. Për ilustrim ndonëse bëhet fjalë për vetëm 19 nga gjithsej 53446 subjekte që i përkasin sektorit korporativ e që kanë dorëzuar llogari vjetore, pjesëmarrja e këtyre ndërmarrje në totalin e mjeteve në fund të vitit 2016 është 4.5%, në të ardhurat nga shitjet është 9.7% ndërsa në fitimin pas tatimit 15.3%. Një pjesë e subjekte në fjalë janë pjesë e kompanive me veprimtari ndërkombëtare, që vetvetiu sipas të gjitha gjasave nënkupton edhe cilësi më të lartë në menaxhimin e tyre, orientim më të mirë në funksionim dhe qasje të lehtësuara në tregje për shitje të produkteve, e në pajtueshmëri me këtë edhe norma më të ulëta të riskut operativ në funksionimin ditorë të tyre.

Kapacitetet e reja të orientuara drejt eksportit kanë shënuar rritje vjetore më dinamike në vitin 2016 në krahasim me rritjen e sektorit korporativ vendor në tërësi, por edhe në krahasim me rritjen e pjesës tjetër të sektorit korporativ duke mos i përfshirë këto kapacitete. I vetmi pozicion bilancor rritja e të cilit në vitin 2016 nuk kishte dallime më të shprehura në krahasim me subjektet tjera të sektorit korporativ vendor, është borxhit interes-sjellës i ndërmarrjeve (kryesisht kreditë). Ekziston mundësia që një pjesë e dallimeve në rritje, e në veçanti ato që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të mjeteve të paraqiten edhe për shkak të asaj se një pjesë e këtyre ndërmarrje të reja ende nuk e kanë përfunduar procesin e planifikuar investues.

Tabela 2

Norma e rritjes së pozicioneve të caktuara bilancore për kapacitetet e reja prodhuese të orientuara drejt eksportit dhe për pjesën tjetër të sektorit korporativ, në %.

Zërat	Kapacitetet e reja prodhuese të orientuara kah eksporti	Gjithsej sektori korporativ	Sektori korporativ, pa kapacitetet e reja eksportuese
Fitimi pas tatimit	38.9	15.5	12.1
Të hyra nga shitja	18.6	6.6	5.5
Gjithsej mjetet	26.3	8.2	7.4
Mjetet rrjedhëse	27.1	10.2	9.1
Mjetet joqarkulluese	14.5	6.4	6.3
Detyrimet rrjedhëse	13.9	9.4	9.3
Borxhi me interes	9.9	8.7	8.7

Burimi: Përlllogaritje interne të Bankës popullore në bazë të dhënave nga Regjistri qendrorë i Republikës së Maqedonisë.

Krahasimi i treguesve të funksionimit të kapaciteteve të reja prodhuese të orientuara drejt eksportit me treguesit e subjekteve tjera që janë pjesë e sektorit korporativ tregon se këto subjekte



shënojnë realizime më të mira në të gjitha aspektet e funksionimit të tyre<sup>73</sup>. Kapacitetet e reja prodhuese të orientuara drejt eksportit kanë profitabilitet dukshëm më të lartë, kanë qarkullim më të shpejtë të stoqeve dhe kërkesave, tregues më të lartë të likuiditetit dhe kanë huazime më të ulëta dhe ngarkesë më të vogël me norma interesi. Sipas kësaj, dallimet në treguesit e funksionimit të subjekteve në fjalë krahasuar me pjesën tjetër të sektorit korporativ në Republikën e Maqedonisë, në një mënyrë i sqarojnë edhe dallimet në suksesin në realizimin e qëllimeve afariste, funksionalitetin e modelit afarist të përzgjedhur dhe cilësinë në proceset menaxhuese.

Këto subjekte të reja të orientuara drejt eksportit kanë shkallë relativisht të ulët të huazimit të bankat vendore e cila në fakt më 32.12.2016 ishte 236 milionë denarë dhe paraqet vetëm 0.8% nga totali i obligimeve të tyre, respektivisht vetëm 2.6% nga totali i borxhit interes-sjellës të tyre. Edhe po të merret parasysh financimi jashtë bilancor që e shfrytëzojnë këto ndërmarrje nga bankat vendore (garancione, akreditive etj), dhe e cila më 31.12.2016 zë shumën prej 302 milionë denarë, përsëri obligimet ( totale dhe potenciale) të këtyre ndërmarrje ndaj bankave vendore mbeten në nivel të ulët. Nga këtu, dallimet në huazimet e këtyre subjekte dhe pjesës tjetër të sektorit korporativ, sipas të gjitha gjasave kanë të bëjnë me faktin se këto entitete janë pjesë të kompanive ndërkombëtare dhe përmes tyre kanë mundësi për qasje në tregjet ndërkombëtare financiare (përfshirë këtu edhe huazim në mes kompanie) dhe në këtë mënyrë të sigurojnë financa në kushte më të volitshme në krahasim me opsionet për financim që u qëndrojnë në disponim në Republikën e Maqedonisë.

Tabela 3

Tregues financiar të përzgjedhur për kapacitete e reja prodhuese të orientuara drejt eksportit dhe pjesën tjetër të sektorit korporativ

Zërat	Kapacitetet e reja prodhuese të orientuara kah eksporti	Gjithsej sektori korporativ	Sektori korporativ, pa kapacitetet e reja eksportuese
Kthimi i mjeteve (ROAA)	13.5%	3.7%	3.3%
Kthimi i kapitalit dhe rezervave (ROAE)	24.3%	7.3%	6.5%
Marzhi neto i fitimit	7.8%	4.8%	4.5%
Likuiditeti rrjedhës	2.1	1.3	1.2
Likuiditeti i shpejt (i momentit)	1.5	0.9	0.9
Qarkullimi i stoqeve (herë)	7.3	5.7	5.6
Qarkullimi i kërkesave(herë)	4.6	3.1	3.0
Ditët e lidhjes së stoqeve	50	64	65
Ditët e arkëtimit të kërkesave	79	116	120
Ditët për shlyerjen e detyrimeve afatshkurtra	80	170	179
Treguesi mjete / kapital (herë)	1.78	1.99	2.00
Treguesi borxh / kapital (herë)	0.78	0.99	1.00
Treguesi ngarkesës afatgjate me borxh	15.5%	21.3%	21.6%
Borxhi me interes / Kapital (herë)	0.23	0.42	0.43
Treguesi për mbulimin e shpenzimeve të interesit me fitimin operativ (herë)	21.0	5.7	5.1

<sup>73</sup> Te disa nga këto subjekte, efekt të caktuar mbi përmirësimin e treguesve të funksionimit kanë patur edhe format e ndryshme të ndihmës shtetërore.




## 2.2 Huazimi i sektorit korporativ

Në vitin 2016, totali i borxhit<sup>74</sup> të sektorit korporativ vendor ka shënuar rritje prej 9.2% që është njëkohësisht edhe shkalla më e lartë e shënuar e rritjes që nga vitit 2008. Megjithatë, pjesëmarrja e tij në PBB në fund të vitit 2016 qëndroi në nivel gati të njëjtë me vitin paraprak. Bartësi kryesorë i rritjes së huazimit të sektorit korporativ, njëlloj si në disa vitet paraprake, ishte komponenti e jashtme e borxhit, e cila në fakt determinoi 88% të rritjes vjetore të totalit të borxhit. Për dallim nga rritja e përsheptuar e borxhit ndaj besorëve jorezident, huazimi i sektorit korporativ te bankat vendore u rrit me një dinamikë dukshëm më të ulët në krahasim me vitet paraprake. Rritja e përsheptuar e huazimit të jashtëm të sektorit korporativ vendor rezulton me zmadhim të ndjeshmërisë së tij ndaj ndryshimeve në kushtet dhe çmimin e financimit në tregjet financiare ndërkombëtare, por njëkohësisht sinjalizon se bankat vendore e kanë më të vështirë të ruajnë pozitën e tyre konkurruese për kreditim të atyre ndërmarrje vendore që kanë mundësi të sigurojnë financim të jashtëm. Segmentet tjera të sistemit financiar vendor kanë ndikim jo të konsiderueshëm në sigurimin e financave për sektorin korporativ vendor.

### Grafik48

Struktura dhe pjesëmarrja relative në PBB e borxhit të sektorit korporativ (majtas) dhe ndryshimi absolut dhe relative (djathtas) sipas llojit të borxhit

Në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave dhe Enti Shtetërorë i Statistikave

\*Vërejtje: Të dhënat mbi borxhin e jashtëm të sektorit korporativ dhe PBB për vitin 2015 janë të dhëna paraprake ndërsa ato për PBB për vitin 2016 janë të dhëna të përafëruara.

**Neto huazimi<sup>75</sup> i sektorit korporativ ka shënuar rritje vjetore më të vogël (5.2%) në krahasim me rritjen e realizuar në vitin paraprak (8%), që kryesisht mundet ti përshkruhet rënies së huazimit neto ndaj bankave vendore. Në**

<sup>74</sup>Për qëllimet e kësaj analize, huaja e përgjithshme e sektorit të korporatave përfshin: borxhin në kredi, interesat dhe llogaritë e arkëtueshme të tjera të bankave, gjithsej detyrime të sektorit të korporatave ndaj jashtë (jo-rezidentët), vlera e kontratave aktive leasing-ut dhe borxhit i bazuar në kontratat aktive me shoqëritë financiare.


<sup>75</sup>Huazimi neto i sektorit korporativ vendor fitohet si dallim mes kërkesave dhe borxhit të sektorit korporativ nga dhe drejt bankave vendore

**përputhshmëri me këtë, erdhi deri te zvogëlimi i pjesëmarrjes së tij në PBB për 1.2 pikë përqindësh në bazë vjetore me çka në fund të vitit 2016 arriti nivelin prej 35.2%.** Zvogëlimi i huazimit neto të sektorit korporativ vendor ndaj bankave vendore në një pjesë rezulton nga ndryshimet në dinamikën e borxhit të sektorit korporativ ndaj bankave vendore (ngadalësim i rritjes për 4 pikë përqindësh, nga 6.6% në vitin 2015 në 2.6% në vitin 2016), por pjesërisht rrjedhon edhe nga fakti që në vitin 2016 rritja e totalit të depozitave të ndërmarrjeve në sistemin bankar vendor, mbeti në nivel të ngjashëm si në vitin 2015 (12.7% në vitin 2016 kundrejt 13.3% në vitin 2015).

Grafik49

Komponentët e huazimit neto të sektorit korporativ (majtas) dhe norma të ndryshimit dhe raport i huazimit neto me PBB (djathtas)

Në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave dhe Enti Shtetërorë i Statistikave

\*Vërejtje: Të dhënat mbi borxhin e jashtëm të sektorit korporativ dhe PBB për vitin 2015 janë të dhëna paraprake ndërsa ato për PBB për vitin 2016 janë të dhëna të përafëruara. Gjatë llogaritjes së huazimit neto të sektorit korporativ është shpërfillur obligimi i bankave për shlyerje të kërkesave që janë plotësisht të rezervuara më gjatë se dy vite.

Huazimi neto i sektorit korporativ ndaj jorezidentëve ishte bartësi kryesorë i rritjes së totalit të huazimit neto, duke shënuar shkallë të ngjashme të rritjes si në vitin paraprak dhe duke zmadhuar pjesëmarrjen e tij në PBB për 0.8 pikë përqindësh. Shkalla e pandryshuar e rritjes së huazimit neto ndaj jorezidentëve është përcaktuar nga dinamika e ngjashme e rritjes së borxhit të sektorit korporativ vendor ndaj jashtë (për 14.5%) dhe të kërkesave ndaj jorezidentëve (për 16.5%).

Struktura e kërkesave dhe obligimeve të sektorit korporativ nga dhe ndaj joresidentëve nuk ka shënuar ndryshime të konsiderueshme në vitin 2016. Kreditë tregtare afatshkurta të miratuara, kanë pjesëmarrjen më të lartë bë kërkesat nga joresidentët, ndërsa në strukturën e obligimeve dominojnë obligimet në bazë të borxheve<sup>76</sup>, kryesisht në mes kompanive, të ndjekura nga obligimet në bazë të kredive tregtare<sup>77</sup> të cilat janë pjesëmarrje gati dyfish më të vogël. Rritja vjetore e obligimeve të sektorit korporativ ndaj joresidentëve në vitin 2016 ishte e përcaktuar në masë të njëjtë edhe nga rritja e obligimeve në bazë të borxheve të pranuar dhe nga rritja e obligimeve të bazë të kredive tregtare afatshkurta.

<sup>76</sup> Borxhi përfshin marrëdhëniet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve (pretendimet ose pasiveve) që paraqiten si rezultat i huamarrjes të drejtpërdrejtë (para) në bazë të një marrëveshje kredie apo borxhi, duke përfshirë edhe borxhet në mes kompanive

<sup>77</sup> Kreditë tregtare (komerciale) janë marrëdhëniet e banorëve me jorezidentët (pretendimet ose pasiveve) që rrjedhin nga kredia direkt nga furnizuesi (furnizuesit) për blerësit (marrësit) për transaksionet në mallra dhe shërbime, si dhe pagesave paradhënie për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve ose për punë






**Ndryshimet në karakteristikat strukture të borxhit të sektorit korporativ vendor në vitin 2016**, nga njëra anë rrjedhon nga rritja më e lartë e huazimit ndaj besorësve jorezidentë në krahasim me rritjen modeste të huazimit ndaj bankave vendore, por nga ana tjetër janë të shkaktuara edhe nga çregjistrimet e detyrueshme nga ana e bankave vendore të ekspozimit që për më shumë se dy vite ka qenë plotësisht i mbuluar me korigjim të veçantë të vlerës ose rezervë të veçantë<sup>78</sup>. Këto ndryshime rezultuan me zvogëlim të pjesëmarrjes së huazimit të maturuar dhe jofunksional nga 7% në vitin 2015 në 4.3% në fund të vitit 2016. Shikuar sipas strukturës së maturimit,

Grafik50

Struktura e kërkesave dhe obligimeve të sektorit korporativ vendor ndaj jorezidentëve, sipas instrumentit



Burimi: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave dhe Enti Shtetërorëi Statistikave

\*Vërejtje: Të dhënat mbi borxhin e jashtëm të sektorit korporativ dhe PBB për vitin 2015 janë të dhëna paraprake ndërsa ato për PBB për vitin 2016 janë të dhëna të përafëruara

ndonëse shkalla relative e rritjes së borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë në vitin 2016 ishte e barabartë, megjithatë ende borxhi afatgjatë ka pjesëmarrje gati të dyfishtë në krahasim me borxhin afatshkurtër. Në rastin konkret mbi 80% i rritjes së përgjithshme të borxhit afatgjatë të sektorit korporativ i përshkruhet rritjes së borxhit ndaj jorezidentëve. Në përputhshmëri me këtë, në strukturën valutore të huazimit në vitin 2016, erdhi deri në rritje relativisht të lartë të huazimit në devizë. Por, duke pasur parasysh se vazhdoi trendi i zvogëlimit të borxhit të ndërmarrjeve vendore në denarë me klauzolë valutore, pjesëmarrja e huazimit të përgjithshëm me klauzolë valutore (valutore dhe në denarë më klauzolë valutore) në fund të vitit 2016 mbeti në nivel të ngjashëm si në vitin 2015. Huazimi në denarë, për dallim nga dy vitet paraprake kur shëmoi rritje të shpejtë, gjatë vitit 2016 shënoi stagnacion, duke arritur një rritje modeste prej 0.5%.

<sup>78</sup>Komfor vendimit për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për menaxhim të rrezikut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 223/15), u vendos obligim i bankave në periudhën 01.01.2016 - 30.6.2016 të fillojnë me shlyerjen e kërkesave të rezervuara për më gjatë se dy vite Оваа обврска продолжува и понатаму за нефункционалните побарувања коишто ќе го исполнат наведениот критериум.



Tabela 4

Struktura dhe ndryshimet e komponentëve të veçanta të borxhit të sektorit korporativ vendor

Lloji i ngarkesës -borxhi		Struktura (bo %)			Ndryshimi absolut (në milionë Denarë)			Ndryshimi relativ (në %)		
		2014	2015	2016	2014	2015	2016	2014	2015	2016
Valuta	Borxhi denarik	21.2	22.7	20.9	11,238	11,804	431	18.5	16.4	0.5
	Borxhi valutor	70.5	70.2	70.3	16,606	19,879	24,019	7.5	8.3	9.3
	Borxhi denarik me klauzolë valutore	8.3	7.0	6.1	-2,820	-2,292	-1,294	-9.1	-8.1	-5.0
	Borxhi i shlyer nga banakt vendore në pajtueshmëri me detyrimet rregullatore	-	-	2.7	-	-	10,807	-	-	-
Aftëzimi	Borxhi afatshkurtër	35.4	32.7	33.0	13,437	595	12,037	12.6	0.5	10.0
	Borxhi afatgjatë	57.4	60.3	60.0	9,028	27,244	19,462	4.9	14.0	10.0
	Borxhi i ngelur (të maturuar dhe jofunksional)	7.2	7.0	4.3	2,559	1,551	-8,344	11.8	6.4	-34.4
	Borxhi i shlyer nga banakt vendore në pajtueshmëri me detyrimet rregullatore	-	-	2.7	-	-	10,807	-	-	-
Lloji i normës së interesit	Borxhi me normë interesi fiks	22.0	24.4	28.0	12,084	5,680	16,583	22.4	8.6	23.1
	Borxhi me normë interesi të ndryshueshëm (variabil)	32.9	29.5	25.6	-956	7,053	-5,946	-1.2	8.8	-6.8
	Borxhi me normë interesi të përshtatshëm	41.8	42.0	38.7	8,449	12,331	-1,072	8.2	11.1	-0.9
	Të tjera - borxhi pa interes ka jorezidentët	3.3	4.0	4.4	1,773	2,087	2,101	22.2	21.4	17.7
	Borxhi i shlyer nga banakt vendore në pajtueshmëri me detyrimet rregullatore	-	-	3.2	-	-	10,185	-	-	-

Burimi: Banka popullore për borxhin e sektorit korporativ ndaj bankave dhe jorezidentëve, Ministria e Financave për borxhin e sektorit korporativ për lizing dhe ndaj shoqërive financiare.

Shënim: Në strukturën e maturimit, pjesë e huas së mbetur (të maturuar dhe jofunksionale), është llogaritur vetëm sipas borxhit ndaj bankave, për shkak të mungesës së të dhënave mbi borxhin jofunksional ndaj bestorëve tjerë. Te struktura e borxhit sipas normës së interesit, është marrë parasysh vetëm borxhi në bazë të kryegjësë për kreditë ndaj sistemit bankar dhe jorezidentëve. Me pozicioni për huazimin nga bankat vendore është paraqitur ajo pjesë e huazimit të sektorit korporativ vendor të cilin bankat e kanë çregjistruar në vitin 2016, në përputhshmëri me obligimin rregulator për çregjistrim të ekspozimit që më shumë se dy vite është plotësisht i mbuluar me korrigjim të vlerës dhe/ose rezervë.

**Në strukturën e borxhit të sektorit korporativ, shikuar nga këndvështrimi i llojit të normës së interesit që kalkulohet, dominojnë obligimet me normë interesi lartësia e së cilës mundet të ndryshohet, qoftë nën ndikimin e lëvizjeve në treg të normës referuese të interesit (te norma e ndryshueshme respektivisht variable e interesit), qoftë nën ndikim të vendimeve individuale dhe të njëanshme të bankave vendore (te norma e përshtatshme e interesit). Sipas kësaj, rol të rëndësishëm për borxhin e sektorit korporativ ka ekspozimi i tij ndaj riskut nga lëvizjet e pavolitshme të normave të interesit, që në veçanti fillon në peshë duke pasur parasysh përfundimin e periudhës së politikave më të lira monetare në nivel global<sup>79</sup>. Në vitin 2016, shkallë më e lartë e rritjes prej 23.1% vërehet te huazimi me normë fikse të interesit, e cila përcakton rreth tre të katërtat e rritjes së totalit të huazimit dhe e cila në masë më të madhe (rreth 86%) rezulton nga relacionet huazuese të ndërmarrjeve vendore me kreditorë jorezident, ndërsa borxhi pa normë interesi ( e që ka të bëjë me kreditë pa interes të miratuara nga personat amë të jashtëm) gjithashtu ka shënuar normë dyshifrore të rritjes në vitin 2016 dhe participon me 4.4% në totalin e borxhit.**

<sup>79</sup>FED Amerikan që nga dhjetori i vitit 2015 filloi me zmadhimin e normave të interesit, ndërsa më 16.03.2017 për të dytën herë në tre muaj e zmadhoi normën referuese të interesit nga 0.75% në 1%. Gjithashtu në tremujorin e dytë të vitit 2017 Banka Qendrore Evropiane e hodhi poshtë mundësinë për zvogëlim të mëtejme të lartësisë së normave të interesit në kompetencë të saj.




**Ndjeshmëria e riskut valutore vjen në shprehje është përmes pozitës valutore neto (negative) të shkurtë<sup>80</sup> në sektorin korporativ vendor,** që dëshmon se sektori korporativ ka masë më të madhe të obligimeve se mjete me komponentë valutore. Në fund të vitit 2016, pozita valutore negative u thellua për 3.5% në bazë vjetore. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e pozitës neto negative të sektorit korporativ në produktin e brendshëm bruto shënoi një zvogëlim të imët (për 1.5 pikë përqindësh), por raporti i saj me kapitalin dhe rezervat e sektorit korporativ ka mbetur e pandryshuar në relacion me vitin paraprak. Këto lëvizje tregojnë se ekspozimi i sektorit korporativ ndaj riskut valutore dhe në përputhshmëri me këtë edhe ndjeshmëria e realizimeve të tij ndaj lëvizjeve në tregun ndërkombëtarë devizor në vitin 2016 qëndroi në nivel të ngjashëm si në vitet paraprake. Zbatimi i strategjisë së kursit devizor nominal “de facto” të fiksuar të denarit në relacion me euron kontribuon në kufizimin e risqeve për realizimet e sektorit korporativ dhe për nivelin e huazimit të tij, që do të kishin rrjedhur nga fluktuimet eventuale ndërvalutore në treg.

Grafik51

Dinamika (majtas) dhe rëndësia relative dhe ndryshimi (djathtas) i pozitës neto devizore të sektorit korporativ

Në milionë denarë (majtas) dhe në përqindje (djathtas)



Burimi: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë dhe Enti Shtetëror i Statistikave për PBB

**Rezultatet e sondazhit për aktivitetin kreditues të bankave të realizuar nga ana e Bankës popullore<sup>81</sup>,** tregojnë se gjatë vitit 2016, sipas bankave kërkesa për kredi nga ana e sektorit korporativ vendor kryesisht kë mbetur e pandryshuar. Përfundim bën tremujori i dytë i vitit 2016, kur bankat kanë vlerësuar një zvogëlim të kërkesës për kredi nga ana e ndërmarrjeve vendore, që korrespondon me pasigurinë në mjedisin vendor dhe lëvizjet e pavolitshme në tregun vendor të depoziteve në këtë periudhë të vitit.

<sup>80</sup> Pozicioni neto valutore llogaritet si diferencë midis aktiveve dhe pasiveve me komponentë valutore e sektorit të korporatave. Nëse diferenca është pozitive, ose asetet janë më të mëdha se detyrimet, kjo është një pozicion të gjatë neto i këmbimit valutore, dhe anasjelltas, nëse pasivet me komponenta valutore janë më të mëdha se sa pasuritë, kjo është një pozicion neto valutore i shkurtër. Si asetet me përbërës valutore janë marrë depozita me komponentë valutore, pretendimet totale në jorezidentët, duke përfshirë fondet në llogaritë jashtë vendit dhe investimet jashtë vendit. Detyrimet me komponentë valutore përbëhen nga: kreditë me komponentë valutore ndaj bankave vendase dhe detyrimeve totale ndaj jorezidentëve. Për gjendja e investimeve jashtë vendit që nga 31.12.2016, është shfrytëzuar e dhënë për gjendjen që nga 31.12.2015, pasi të dhënat për vitin 2016 do të vihet në dispozicion në gjysmën e dytë të vitit 2017.


<sup>81</sup> Sondazhet janë kryer në baza tremujore dhe, ndër të tjera, në to bankat i japin sugjerimet e tyre për kreditimin e ndërmarrjeve vendase. Për qëllimet e kësaj pjese të Raportit të Stabilitetit Financiar, rezultatet e këtyre sondazheve janë analizuar si rezultat mesatar të katër anketave tremujore në lidhje me çdo vit kalendarik. Rezultatet e detajuara të anketave individuale për aktivitetin kreditor janë në dispozicion në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Shikuar sipas faktorëve të veçantë <sup>82</sup> që ndikojnë në kërkesës për kredi, bankat kanë vlerësuar se gjatë vitit 2016, ndikim më të madhe në ndryshimin e kërkesës për kredi nga sektori korporativ është shënuar te nevoja për rristrukturim të borxhit të sektorit korporativ dhe te nevoja për investime në stoqe dhe në kapital rrjedhës. Këto faktorë ndikojnë në drejtim të rritjes së kërkesës për kredi, edhe pse krahasuar me disa vitet e fundit ka vazhduar trendi i zvogëlimit të efekteve të tyre. Faktorët tjerë të veçantë, sipas bankave, nuk kanë ndikime të veçanta në kërkesën për kredinë vitin 2016, përkatësisht kryesisht janë vlerësuar si faktorë me ndikim të pandryshuar.

**Grafik52**

Rezultate nga sondazhet për aktivitetin kreditues të bankave: vlerësim i kërkesave për kredi nga ana e ndërmarrjeve (lartë majtas), vlerësim i faktorëve që ndikojnë në kërkesën për kredi (lartë djathtas), оцена vlerësim i kushteve për kreditim të ndërmarrjeve (poshtë majtas) dhe vlerësim i faktorëve që ndikojnë në kushtet e kreditimit (poshtë djathtas)

Në përqindje



Burimi: Banka popullore në bazë të dhënave për aktivitetin kreditues të bankave

\*Shënim: Përqindja e bankave është e ponderuar me pjesëmarrjen e secilës bankë individuale në sasinë e përgjithshme të kredive për ndërmarrjet në datat përkatëse. Vlerësimi i faktorëve është i paraqitur si përqindje mesatare e bankave që kanë vlerësuar se faktori përkatës ndikon në mosndryshimin e kërkesës në të gjitha anketat gjatë vitit përkatës. Përqindja neto paraqet dallim në mes bankave që kanë raportuar kërkesë të rritur për kredi dhe atyre që kanë raportuar rënie të kërkesës për kredi nga ana e ndërmarrjeve, respektivisht në mes bankave që kanë raportuar lehtësim dhe ashpërsim të kriterëve për kreditim të ndërmarrjeve.

<sup>82</sup>Si faktorë ndikimi i të cilëve në kërkesën për kredi nga ana e sektorit të korporatave është vlerësuar nga ana e bankave theksohen: investimet në pasuri fikse, investimet në inventar dhe kapital të punës, rristrukturimet e borxhit, financimi i brendshëm, hua nga bankat e tjera dhe lëshimi i letrave me vlerë..



Në kontekst të kushteve për kreditim të sektorit korporativ, në vitin 2016 bankat kryesisht e kanë theksuar mosndryshueshmërinë e tyre. Përrjashtim bënë norma e interesit të kredive, ku bankat për të katërtin vit në radhë mesatarisht janë deklaruar në drejtim të lehtësimit të këtij kushti për kreditim.


Krahas kësaj, në rritje është edhe pjesa e bankave që kanë deklaruar një lehtësim të provizioneve dhe kompensimeve të ndërlidhura me kreditë krahasuar me vitin paraprak, edhe pse efekti mesatar i lehtësimit të këtij kushti është më modest në krahasim me lehtësimin e normave të interesit të kredive. Sipas përgjigjeve të dhëna nga ana e bankave, si faktorë që ndikojnë në ndryshimin e kushteve të kreditimit veçohen presionet nga konkurrenca<sup>83</sup> dhe kostot e financimit dhe kufizimet në bilancet e tyre të gjendjeve<sup>84</sup>, ndërsa qëndrimet e bankave rreth risqeve të ndërlidhura me kredimarisit<sup>85</sup> edhe pse në periudhën e vitit 2016 janë për një nijancë më të mira në krahasim me vitin 2015, përsëri ende ndikojnë në drejtim të ashpërsimit të kushteve për kreditim të sektorit korporativ.

**Normat e ulëta të interesit dhe politika monetare më e relaksuar, kanë kontribuar për një vazhdim të trendit të zvogëlimit të normave të interesit që bankat i arkëtojnë nga kreditë e miratuara për sektorin korporativ vendor.** Jostabiliteti i tregut vendor të depozitave në gjysmën e parë të vitit 2016 nuk ka ndikuar në lëvizjen e normave të interesit të kredive të bankave, meqë pritjet ekonomike shpejtë janë stabilizuar pas reagimit të politikës monetare dhe zmadhimit të normës së interesit të bonot e thesarit (nga dhjetori i vitit 2016 filloi normalizimi gradual i normës së interesit të bonove të thesarit).

Grafik53

Normat mesatare të interesit të totalit të kredive të bankave vendore miratuar për sektorin korporativ dhe diapazoni i normave mesatare të interesit mbi normat mesatare ndër-bankare të interesit (djathtas)

Në pikë përqindje



Burimi: Regjistri kreditor i bankës popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave dhe përlooaritje të Bankës popullore.

<sup>83</sup> Në këtë grup janë të përfshira konkurrenca nga bankat tjera, konkurrenca nga sektori jobankar dhe konkurrenca nga financimi në treg.

<sup>84</sup> Në këtë grup janë të përfshira pozita kapitale e bankës, qasja e bankës ndaj financimit në treg dhe likuiditeti i bankës.

<sup>85</sup> Në këtë grup janë të përfshira pritjet për aktivitetin e gjithmbarshëm ekonomik, pritjet për perspektivën e degëve të veçanta dhe ndërmarrjeve të veçanta dhe rreziqet e ndërlidhura me arkëtimin e sigurimit të kredive.



Zvogëlimi i normave mesatare të interesit u ndoq edhe me një **ngushtim të diapazoneve të normave të interesit të kredive të miratuara për sektorin korporativ vendor kundrejt normave bazë ndër-bankare të interesit që sinjalizon zvogëlim të primit për risk kreditor që bankat e inkorporojnë në normat e tyre të interesit.** Diapazoni, dhe me këtë edhe primi implicit për riskun kreditorë, është në nivel më të lartë të kreditë me komponentë valutore, krahasuar me kreditë në denarë, me çka ato janë relativisht më atraktiv për bankat në kontekst të kompensimit të pritur për riskun kreditorë të ndërmarrë, veçanërisht në kushte të shfrytëzimit të klauzolave për përshtatje të njëanshme të lartësisë së normave të interesit, të cilat praktikisht bankave u krijojnë mundësi për vlerësim shtesë të riskut të ndërmarrë pas analizës fillestare kreditore gjatë miratimit të kredive. Zvogëlimi i normave mesatare të interesit për kreditë e miratuara në vitin 2016 është vërejtur te të gjithë veprimtaritë, edhe atë pavarësisht valutës, që kontribuoi për një ngushtim të diapazonit të normave ndër-bankare të interesit dhe rënie të primeve implicite për risk kreditorë<sup>86</sup>.

---

<sup>86</sup>Për më shumë të dhëna mbi normat mesatare të interesit të kredive të miratuara nga ana e bankave vendore për sektorin korporativ vendor sipas veprimtarive të veçanta si dhe për diapazonin e tyre në relacion me normat bazë ndër-bankare të interesit shqyrtoni të dhënat e paraqitura në aneksin nr.11



### III. SEKTORI FINANCIAR

#### 1. Struktura, shkalla e përqendrimit dhe përfitimit të sektorit financiar në Republikën e Maqedonisë

Në vitin 2016, totali i aktivitetit të sektorit financiar rritej ngadalë, dhe rritja ishte kryesisht nga sistemi bankar dhe fondet e detyrueshme të pensioneve. Bankat zënë pjesën më të madhe të sistemit financiar dhe janë një faktor i rëndësishëm për stabilitetin e segmenteve të tjera institucionale, të cilat mbajnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve të tyre në formën e depozitave te bankat. Për stabilitetin financiar janë të rëndësishme edhe fondet e pensioneve dhe kompanitë e sigurimeve, të cilat kanë potencial të madh për rritje të mëtejshme, edhe pse në vitet e fundit janë duke punuar në kushte të pafavorshme të tregut për investime dhe shfrytëzimin e aseteve të klientëve të tyre, për shkak të rendimenteve shumë të ulëta. Fondet e pensioneve janë të rëndësishme në aspektin e rolit të tyre si investitorë institucionale, por stabiliteti i tyre është veçanërisht i rëndësishëm për stabilitetin e përgjithshëm financiar për shkak të "kursimeve pensionale" të ekonomive familjare ke ata. Në sektorin e sigurimeve, është shënuar një rritje e vazhdueshme të aktiviteteve, veçanërisht në segmentin e sigurimit të jetës, por edhe në përmirësimin e rregullativës dhe mbikëqyrjes, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Fondet e investimeve ngadalë po imponohen si një alternativë domethënëse për investimet, kryesisht për investitorët më të vegjël, edhe në kushte të normës së ulët të interesit ato janë një nga segmentet me rritje më të shpejtë të sistemit financiar. Në tre vitet e fundit, numri dhe asetet e kompanive financiare, si segment "më i ri" i sektorit financiar është në rritje, por pa ndryshime të rëndësishme në rëndësinë relative për sistemin financiar. Hyrja e përsheptuar në treg e kompanive financiare që miratojnë kredi në sasi të vogla, por me kosto shumë të larta për konsumatorët e këtyre produkteve, në formën e interesit ose tarifave dhe kompensimeve të ngjashme, imponon një nevojë për vëmendje më të madhe të këtyre kompanive nga institucionet kompetente dhe forcimit e mbikëqyrjes mbi ta.

Tabela 5

Struktura e totalit të aktiveve në sektorin financiar të Republikës së Maqedonisë

Lloji i institucionit financiar	Gjithsej mjetet (milionë denarë)		Struktura në %		Ndryshimi 31.12.2016/31.12.2015		Numri i institucioneve	
	2015	2016	2015	2016	Ndryshimi absolut	Në përqindje	2015	2016
<b>Institucionet depozituese dhe financiare</b>	<b>426,313</b>	<b>447,282</b>	<b>86.4</b>	<b>85.2</b>	<b>20,969</b>	<b>4.9</b>	<b>18</b>	<b>18</b>
Bankat	423,668	444,680	85.8	84.7	21,013	5.0	15	15
Kursimoret	2,646	2,602	0.5	0.5	-44	-1.7	3	3
<b>Institucionet financiare jodepozituese</b>	<b>67,278</b>	<b>77,438</b>	<b>13.6</b>	<b>14.8</b>	<b>10,161</b>	<b>15.1</b>	<b>108</b>	<b>112</b>
Shoqëritë e sigurimeve	17,562	18,480	3.6	3.5	918	5.2	15	15
Shoqëritë brokere të sigurimit	689	842	0.1	0.2	153	22.2	32	33
Shoqëri për prëfaqësim në sigurime	89	116	0.0	0.02	27	30.3	13	14
Shoqëritë e lizingut	3,408	3,287	0.7	0.6	-121	-3.5	8	6
Fondet pensionale*	40,802	49,074	8.3	9.4	8,272	20.3	4	4
- Fondet pensionale të detyrueshëm	40,065	48,076	8.1	9.2	8,011	20.0	2	2
- Fondet pensionale vullnetare	737	998	0.1	0.2	261	35.4	2	2
Shoqëri për udhëheqje të fondeve pensionale	773	834	0.2	0.2	61	7.9	2	2
Shtëpitë brokere	153	116	0.0	0.0	-37	-24.2	6	5
Fondet investuese*	2,882	3,624	0.6	0.7	742	25.7	13	13
Shoqëri për udhëheqje me fondet investuese	49	69	0.0	0.0	20	40.8	5	5
Shoqëri për udhëheqje me fondet private	n.p.	n.p.	n.p.	n.p.	n.p.	n.p.	n.p.	n.p.
Shoqëritë financiare	871	996	0.2	0.2	125	14.4	10	15
<b>Gjithsej</b>	<b>493,591</b>	<b>524,720</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>31,129</b>	<b>6.3</b>	<b>126</b>	<b>130</b>

Burimi: Për çdo segment institucional, autoriteti mbikëqyrës kompetent (BPRM, KLV, MAPAS, AMS dhe Ministria e Financave).


\* Shumat i referohen totalit të aktiveve në baza bruto.

Shënim: Në bazë të rregullores, fondet private dhe kompanitë e menaxhimit të kapitalit privat nuk kanë detyrim të ofrojnë të dhëna për vlerën e aseteve të tyre dhe neto-aseteve.

Grafik54

Pjesëmarrja e aktiveve të sektorit financiar në PBB


Në përqindje



Burimi: Për çdo segment institucional, autoriteti mbikëqyrës kompetent (BPRM, KLV, MAPAS, AMS dhe Ministria e Financave)

Grafik55

Totali i fondeve të sektorit financiar në raport me PBB-në, sipashteteve në përqindje



Burimi: Raporti i BQE-së mbi Strukturat Financiare 2016 (ECB Report on Financial Structures 2016) dhe faqet e internetit të bankave qendrore për shtetet e veçanta.

Shënim: Të dhënat për Maqedoninë, Shqipërinë, Estoninë, Serbinë dhe Irlandën janë për dhjetor 2016, dhe për shtetet e tjera të analizuar për dhjetor 2015.

Bashkimit Evropian, niveli i ndërmjetësimit financiar në sektorin financiar vendas është ndër më të ulët.

**Vëllimi i aktiviteteve të shtëpive të kursimit, kompanive të lisingut dhe shtëpive brokere ka shënuar një rënie shumëvjeçare (në vitin 2016 është zvogëluar edhe numri i kompanive të lisingut dhe i shtëpive brokere).**

**Rritja e aseteve të sektorit financiar në Republikën e Maqedonisë u ngadalësua** në krahasim me vitin e kaluar<sup>87</sup>, kryesisht për shkak të rritjes së ngadaltë në aktivet e sistemit bankar<sup>88</sup>, por edhe të fondeve të detyrueshme pensionale dhe kompanive të sigurimit. Rënia në aktivet e shtëpive të kursimit, kompanive të lisingut dhe shtëpive brokere vazhdoi edhe në vitin 2016. Nga ana tjetër, asetet e kompanive financiare u rritën me një ritëm të përsheptuar në krahasim me një vit më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të tyre.

**Bankat e kanë ruajtur pozitën dominuese në sistemin financiar dhe rolin e tyre si segment më i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit financiar**, pavarësisht nga ulja minimale (1.1 pikë përqindje) e pjesëmarrjes në totalin e aktiveve të sistemit financiar, për shkak të rritjes së pjesëmarrjes së fondeve pensionale.

**Rritja vjetore e ngadalësuar e aseteve totale të sistemit financiar në vitin 2016 shkaktoi një rënie të caktuar (për 1.7 pikë përqindje) në rëndësinë e saj për ekonominë e vendit.** Totali i aktiveve të sistemit financiar përfshijnë 86.4% të prodhimit të brendshëm bruto<sup>89</sup> dhe në krahasim me vendet e rajonit dhe të

<sup>87</sup> Rritja e aktivës së sistemit financiar ishte 7.1% në vitin 2015, krahasuar me 6.3% në vitin 2016.

<sup>88</sup> Termi "sistem bankar" i referohet vetëm bankave, ndërsa termi "institucione depozituese" gjithashtu i mbulon shtëpitë e kurseve.

<sup>89</sup> Të dhënat e PBB-së për vitin 2016 janë të dhëna të vlerësuara.






Përqendrimi në segmentet e veçanta të sistemit financiar, i monitoruar përmes vlerës së indeksit Herfindahl është në kufij të pranueshmërisë dhe kryesisht është në rënie. Në segmente të caktuara të sistemit financiar ka një nivel të lartë të përqendrimit, që vjen për shkak të numrit të vogël të institucioneve, të cilat, nga ana tjetër, lëvizin nga dy (kompanitë që menaxhojnë fondet pensionale) në gjashtë<sup>90</sup> (kompanitë e lizingut).

**Në strukturën e pronësisë së bankave, kompanive të sigurimit dhe kompanitë për menaxhimin e fondeve të pensioneve dhe investimeve mbizotërojnë aksionarët e huaj, ndërkohë që kursimoret<sup>91</sup> janë i vetmi segment i sektorit financiar që është në pronësi të tërësishme nga subjektet vendase.**

#### Grafik56

Indeksi Herfindahl (lart) dhe treguesi CR5 (poshtë) për totalin e aktiveve të segmenteve të veçanta të sistemit financiar  
Në pikë indeksi (lart) dhe në përqindje (poshtë)



Burimi: Për çdo segment institucional, autoriteti mbikëqyrës kompetent (BPRM, KLV, MAPAS, AMS dhe Ministria e Financave).

**Në vitin 2016, në një mjedis të normave të interesit historikisht të ulëta dhe në kushte të rritjes ekonomike të ngadaltë dhe paqëndrueshmërisë politike të vendit, shumica e segmenteve të analizuar<sup>92</sup> të sistemit financiar kanë treguar rezultate pozitive financiare dhe kanë arritur norma solide të kthimit të aktivitetit mesatare dhe kapitalit dhe rezervave mesatare.** Sipas segmenteve të ndryshme, në vitin 2016 më së shumti është duke u përmirësuar profitabiliteti<sup>93</sup> dhe forcimi i efikasitetit operacional të bankave, në drejtim të rritjes më të lartë në të ardhurat nga interesi neto, krahasuar me rritjen e shpenzimeve operative, kryesisht shpenzimet e të

<sup>90</sup>Në segmentin e kompanive financiare ekzistojnë një numër i madh i institucioneve (15), kompanive të sigurimeve-brokerimit (33) dhe agjencive për përfaqësim në sigurime (14). Këto institucione nuk llogarisin treguesit e përqendrimit, për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion për shumën e totalit të aktiveve për çdo kompani.

<sup>91</sup> Në pajtueshmëri me rregullativën, pronar të kursimoreve mund të jenë vetëm shtetas të RM.

<sup>92</sup>Për të cilat ka të dhëna.

<sup>93</sup>Fitimi i sistemit bankar në fund të vitit 2016 arriti në 6.3 miliardë denarë, që paraqet një rritje prej 36.3% krahasuar me fundin e vitit të kaluar.



punësuarve). Por, bankat përballen me një sfidë në drejtim të ruajtjes së mëturjes në nivelin të përfitimit, duke pasur parasysh hapësirën gjithnjë e më të vogël për "menaxhimin" e përfitimit për shkak të normave të ulëta të interesit historikisht dhe për arsye të qëllimit të braktisjes graduale të përdorimit të normave të adaptueshme të interesit, që në afat të mesëm do të krijojë një nevojë për ndryshimin në ecurinë e tyre në tregun e kredive dhe depozitave dhe në fushën e menaxhimit të rreziqeve. Përmirësimi i treguesve të rentabilitetit dhe efikasitetit operativ krahasuar me vitin 2015 është vërejtur edhe në kompanitë e menaxhimit me fonde pensionale<sup>94</sup>.

Tabela 6

### Struktura e pronësisë e institucioneve financiare individuale në përqindje

Pronësia	Bankat	Kursimoret	Shoqëritë e sig	Shoqëritë brok	Shoqëritë e lizingut	Shoqëri për udhëheqje të fondeve pensionale	Shoqëri për udhëheqje të fondeve investuese	Shoqëritë financiare
<b>Pronarët vendor</b>	<b>24.6</b>	<b>100.0</b>	<b>7.8</b>	<b>86.7</b>	<b>79.8</b>	<b>49.0</b>	<b>28.5</b>	<b>69.6</b>
Persona juridik jofinanciar	8.9	90.3	0.8	52.4	1.3	0.0	0.0	32.3
Bankat	0.2	0.0	0.0	0.0	0.7	49.0	20.3	0.0
Shoqëritë e sigurimeve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet financiare tjera	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4.4	0.0
Personat fizik	9.2	9.7	6.6	34.3	77.7	0.0	3.8	37.3
Sektori publik	5.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<b>Pronarët e huaj</b>	<b>75.0</b>	<b>0.0</b>	<b>92.2</b>	<b>13.3</b>	<b>20.2</b>	<b>51.0</b>	<b>71.5</b>	<b>30.4</b>
Personat fizik	2.4	0.0	0.1	8.2	0.0	0.0	0.3	4.0
Persona juridik jofinanciar	14.2	0.0	0.0	0.0	7.2	0.0	9.9	0.0
Bankat	51.7	0.0	0.0	2.6	12.4	0.0	0.0	0.0
Institucionet financiare	6.8	0.0	92.1	2.5	0.6	51.0	61.3	26.4
<b>Status të padefinuar</b>	<b>0.3</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Për çdo segment institucional, autoriteti mbikëqyrës kompetent (BPRM, KLV, MAPAS, AMS dhe Ministria e Financave).

Shënim: Pjesa e kapitalit vendas dhe të huaj në strukturën e pronësisë i referohet kapitalit aksionar (kapital bazë) të institucioneve financiare individuale.

Reduktimi i normave të kthimit të kompanive të sigurimeve në vitin 2016 është pothuajse tërësisht për shkak të rënies së fitimit të realizuar të shoqërive të sigurimit të jetës. Përkundër kësaj, efikasiteti operacional i kompanive të sigurimeve u përmirësua në krahasim me vitin e kaluar. Raporti i shpenzimeve shënoi rënie në krahasim me vitin 2015, për shkak të rritjes më të shpejtë në premiumin neto të fituara (7.4%) në krahasim me rritjen e shpenzimeve<sup>95</sup> të sigurimit (4%). Përmirësimi i efikasitetit operacional të kompanive të sigurimeve gjithashtu perceptohet nëpërmjet zvogëlimit të raportit të dëmeve<sup>96</sup>, si rezultat i rritjes së lartë të premive kundrejt rritjes së dëmeve. Nga ana tjetër, raporti i borxhit<sup>97</sup> të kompanive të sigurimeve shënoi rritje për 0.4 pikë përqindjeje.

<sup>94</sup> Në përputhje me modelin e biznesit, pjesëmarrje më e madhe në të ardhurat totale nga operacionet e rregullta të kompanive kanë të ardhurat nga kompenzimet për menaxhimin e fondeve, të cilat në krahasim me vitin 2015 shënuan rritje për gati 15%. Në strukturën e shpenzimeve operative mbizotërojnë shpenzimet e të punësuarve dhe shpenzimet për kontributet e paguara të Agjencisë për mbikëqyrjen e sigurimeve pensionale të financuara nga kapitali (MAPAS). Kompanitë janë të detyruara të paguajnë një kompenzim për "MAPAS" prej 0.8% të totalit të kontributeve të paguara në muaj në fondet e menaxhuara nga kompanitë.

<sup>95</sup> Shpenzimet për zbatimin e sigurimit përfshijnë: shpenzimet për punonjësit, shpenzimet administrative, komisionet e paguara dhe shpenzimet e tjera për kryerjen e sigurimit.

<sup>96</sup> Koeficienti i dëmeve llogaritet si raporti midis dëmeve neto të vitit dhe primit neto të shkruar (polisuar).

<sup>97</sup> Koeficienti i borxhit llogaritet si një raport mes totalit të detyrimeve dhe totalit të aktiveve të shoqërive të sigurimit.



Tabela 7

Treguesit e profitabilitetit të institucioneve financiare individuale në përqindje

Lloji i institucionit financiar	Norma e kthimit të aktivitetit mesatar (ROAA)		Norma e kthimit të kapitalit mesatar (ROAE)		Shpenzimet operative / Gjithsej të hyrat e rregullta (Cost-to-income)	
	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Bankat	0,8%	1,5%	7,4%	13,6%	55,5%	49,8%
Kursimoret	1,9%	1,6%	4,5%	3,5%	80,6%	83,3%
Shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale	13,9%	19,1%	19,4%	20,1%	64,1%	65,9%
Shoqëritë për menaxhim me fondet investive	27,2%	30,6%	30,3%	32,0%	66,4%	63,8%
Shoqëritë për sigurime*	3,0%	2,6%	9,1%	7,9%	55,8%	54,5%
Shoqëritë e lizingut	-1,3%	1,7%	-8,0%	9,9%	105,5%	83,5%
Shtëpitë brokere	35,1%	-32,5%	86,9%	-36,35	n.p.	n.p.
Shoqëritë financiare	1,2%	-0,2%	2,7%	-0,4%	90,7%	94,8%

Burimi: Për çdo segment institucional, autoriteti mbikëqyrës kompetent (BPRM, KLV, MAPAS, AMS dhe Ministria e Financave).

\* Treguesi i kostove operative/të ardhurave totale të rregullta për kompanitë e sigurimeve është një koeficient i kostove, i cili llogaritet si raport midis kostove neto të kryerjes së sigurimit dhe premiumit neto të fituar.

**Rreziku strategjik është mjaft i rëndësishëm për kompanitë e lizingut, shtëpitë e kursimeve dhe shtëpitë brokere, të cilat i kanë zvogëluar aktivitetet e tyre për disa vite me radhë.** Në kushtet e reduktimit të mëtejshëm të fushëveprimit të aktiviteteve të shtëpitë e kursimeve, rentabiliteti i tyre në vitin 2016 është zvogëluar, si rezultat i zvogëlimit të të ardhurave neto nga interesat, në të cilat bazohet pothuajse tërësisht operacionet fitimprurëse të këtyre institucioneve. Efikasiteti operacional i shtëpive të kursimeve, gjithashtu tregon një përkeqësim të vazhdueshëm në periudhën e kaluar, kryesisht për shkak të reduktimit të të ardhurave të rregullta nga operacionet (për 8.4%) në krahasim me uljen e shpenzimeve operative (4.6%). Efikasiteti i dobët operacional i shtëpive të kursimit është kryesisht pasojë e fushës së kufizuar të aktiviteteve, që njëkohësisht e kufizon shumën e të ardhurave neto të realizuara nga interesi.

Fitimi i realizuar i kompanive të lizingut në vitin 2016 (krahasuar me humbjen për vitin 2015) ndikoi drejtpërdrejt në përmirësimin e treguesve të përfitimit dhe efikasitetit të këtij segmenti të sistemit financiar. Përmirësimi është gjithashtu i dukshëm edhe në treguesit e efikasitetit operacional. Përfitimi i përmirësuar i këtyre shoqërive është pasojë e zvogëlimit të shpenzimeve operative<sup>98</sup> krahasuar me vitin 2015.

Në vitin 2016, shtëpitë brokere dhe shoqëritë financiare kishin një rezultat negativ financiar. Humbja e lartë në mesin e shtëpive brokere është pothuajse tërësisht e përqendruar në një nga pesë shtëpitë brokere, përderisa operacionet jofitimprurëse të kompanive financiare tërësisht janë një rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve për korrigjimin e vlerës së mjeteve të prekshme dhe të paprekshme, si dhe korrigjimin e vlerës së kërkesave aktive të bilancit, që tregon një rritje në nivelin e rrezikut të portofolit të kredive të këtyre institucioneve. Efikasiteti i përkeqësuar operativ është për shkak të rritjes më të lartë të shpenzimeve për të punësuarit (33.6%), që lidhet me fillimin me punë të disa institucioneve të reja financiare gjatë vitit 2016.

<sup>98</sup>Një reduktim i ndjeshëm i kostove operative në vitin 2016 vjen nga reduktimi i shpenzimeve nga aktivitetet e tjera (për 93%) të kompanive për leasing.


## 2. Lidhja ndër-sektoriale, kanalet e ngjitjes dhe ndikimi i tyre në stabilitetin financiar

Sistemi financiar karakterizohet nga një strukturë relativisht e thjeshtë dhe një ndërvarësi e vogël dhe lidhje e aktiviteteve të segmenteve individuale. Me përjashtim të interesit në rritje për të kombinuar produktet dhe shërbimet e sigurimit dhe bankare (të ashtuquajturat banko-sigurime) vëllimi i të cilave, është akoma i vogël, nuk ka pasurim më të rëndësishëm të gamës së instrumenteve dhe shërbimeve që do të rriste lidhjen e ndërsjellë të segmenteve institucionale. Prandaj, mundësia e përhapjes së rreziqeve nga një në një tjetër segment institucionale është minimale, duke kufizuar kështu rrezikun e çrregullimit të stabilitetit financiar në vend.

Bankat janë lidhja kryesore me segmentet e tjera financiare dhe kanë një ndikim të rëndësishëm në lëvizjet e sistemit financiar. Depozitat e institucioneve të tjera financiare janë pothuajse të papërfillshme për bazën e depozitave të sistemit bankar, por janë veçanërisht të rëndësishme për disa institucione financiare, sepse ata janë një nga alternativat më të mëdha të investimit të institucioneve të tilla. Nga ana tjetër, në mesin e disa prej bankave më të vogla, depozitat nga institucionet e tjera financiare janë një burim i rëndësishëm financimi për aktivitetet e tyre. Duke pasur parasysh se sistemi bankar është i koncentruar dhe kursimet sektorit jofinanciar, si dhe mjetet e mbajtura për qëllime të transaksioneve, konfirmojnë rëndësinë e stabilitetit të bankave për ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm financiar në vend.

Grafik57

Pjesëmarrja e depozitave të institucioneve financiare jo-depozitare në aktivet e sistemit bankar (majtas) dhe depozitat sipas bankave individuale (djathtas)  
Në përqindje



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Depozitat e investuara<sup>99</sup> në institucionet financiare jo-depozitare të bankave** kanë regjistruar një rritje vjetore prej 14%, me çka në fund të vitit 2016 arritën në 12,583 milionë denarë. Pjesëmarrja e tyre në totalin e bazës së depozitave dhe totalit të aktiveve të sistemit bankar është vetëm 3.9% dhe 2.8%, respektivisht. Tërheqja e mundshme e depozitave nga institucionet financiare jo-depozitare nuk do të ndikonte në likuiditetin dhe stabilitetin e sistemit bankar gjithsejtë. Megjithatë, pjesëmarrja e depozitave të investuara në institucionet financiare jo-depozitare në totalin e depozitave sipas bankat individuale lëviz në interval prej 1.0% deri në 36.5%, e cila sugjeron se

<sup>99</sup>Si depozita konsiderohen edhe llogaritë e transaksioneve të segmenteve të tjera institucionale me bankat.




rrjedhat e papritura të depozitave të institucioneve të tjera financiare mund të çojë në një paqëndrueshmëri të likuiditetit në disa nga bankat (parasëgjithash bankat më të vogla).

Grafik58

Pjesëmarrja e depozitavete bankat sipas institucioneve financiare jo-depozituesenë totalin e aktiveve të tyre

Në përqindje




Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Shënim: Nuk ka të dhëna të disponueshme për shumën e depozitave të kompanive financiare të investuara në banka për vitin 2014 dhe 2015.

Grafik59

Struktura e investimeve të bankave në instrumente kapitali, në filiale dhe kompani bashkëpunëtorë, sipas llojit të personit juridik

Në përqindje



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Në përputhje me natyrën e segmenteve të veçanta të sistemit financiar, por edhe të mundësive/limiteve rregullatore, dhe madje edhe aftësive për të investuar në tregjet ndërkombëtare, depozitat e investuara në banka kanë një pjesë të konsiderueshme në aktivet e disa institucioneve financiare (kompani brokere, fondet e investimeve dhe kompanitë e sigurimeve). Ky është gjithashtu edhe kanali më i rëndësishëm për **rrjedhën e rreziqeve ndërmjet bankave dhe institucioneve financiare jobankare**. Në anën tjetër, kreditë që u dhanë nga bankat për institucionet financiare jobankare kanë një pjesëmarrje minimale prej 0.1% në totalin e kredive të bankave (sipas bankave individuale kjo përqindje është e vogël dhe lëviz nga 0.1% deri në 2%). Ndërlidhja e bankave nëpërmjet kredive që aprovohen reciprokisht është gjithashtu e vogël, pasi që këto kredi marrin pjesë me 3% në totalin e aktiveve të sistemit bankar (sipas bankave individuale, kjo përqindje lëviz, nga 0% deri në 85.2%, gjegjësisht nga 0% deri në 1.3%, nëse përjashtohet nga analiza BMPZH SHA Shkup). Nëse merren në konsideratë detyrimet ndërmjet bankave (në bazë të kredive të aprovuara dhe depozitave të pranuara), pjesëmarrja e tyre në gjithsej detyrimet të sistemit bankar është 8.1% (sipas bankave individuale, kjo përqindje lëviz nga 0% deri në 83%, gjegjësisht nga 0% deri në 19.6% nëse nga analiza përjashtohet BMPZH SHA Shkup). Praktikisht, ekspozimi më i lartë ndaj rrezikut të infektimit (nga bankat e tjera) është i pranishëm në "Bankën e Maqedonisë për përkrahje të zhvillimit" SHA Shkup, aktiviteti kryesor i të cilit është vendosja e kredive të marra nga institucionet financiare ndërkombëtare nëpërmjet bankave vendase.

**Rreziku i rrjedhës së rreziqeve për shkak të lidhjes kapitale të disa segmenteve të sistemit financiar është i vogël.** Investimet e bankave në instrumente kapitali, në filiale dhe kompani bashkëpunëtorë, përbëjnë vetëm 0.3% të totalit të aktiveve të sistemit bankar. Pjesa më e madhe (82%) e këtyre investimeve janë në subjektet financiare vendase, nga të cilat si më të rëndësishme ndahen investimet kapitale në kompanitë e menaxhimit të pensioneve dhe fondet e investimeve dhe investimet në

institucione të tjera financiare të brendshme (siç janë Bursa e Maqedonisë, DQLV, KIBS, "Casis"). Megjithatë, dy banka kanë një pjesë të konsiderueshme në kapitalin e kompanive të menaxhimit të fondeve pensionale. Lidhja në mes të këtyre dy segmenteve të sektorit financiar është e rëndësishme për shkak se dy banka janë dhe kujdestare të fondeve pensionale në vend, por kryesisht në aspektin e nivelit të rrezikut të reputacionit, duke pasur parasysh se në bazë të legjislacionit, prona e fondeve pensionale është e pavarur nga asetet e bankave kujdestare të pronave të fondeve. Kjo lidhje midis dy segmenteve më të mëdha të sistemit financiar është me rëndësi të jashtëzakonshme për sigurinë financiare të popullatës dhe për stabilitetin e përgjithshëm financiar.

**Në vitin 2016, vetëm tre banka kanë aplikuar banko-sigurimin, kështu që bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe kompanive të sigurimeve në bazë të një kontrate për përfaqësim në sigurime është i vogël.** Primet e polisave bruto të mbledhura nëpërmjet bankave në vitin 2016 përfaqësojnë vetëm 1.4% të totalit të primeve të shoqërive të sigurimit. Për bankat, ekspozimi i marrë nga polisa e sigurimit të jetës është ende në shumën të parëndësishme (1.3% e ekspozimit të përgjithshëm të kredisë ose 5.7% e ekspozimit ndaj personave fizikë, duke mos marrë parasysh ekspozimin e bazuar në kartelat e kreditit dhe llogarive rrjedhëse). Gjithashtu, vetëm 1.8% e kredive të miratuara nga bankat<sup>100</sup> tek subjektet jofinanciare janë të siguruar me një kompani sigurimi (nga realizimi i rrezikut të kredisë). Edhe një kanal tjetër potencial për lidhjen midis sektorit të sigurimeve dhe atij bankar është dëmi i mundshëm për ofrimin e kredive, të mbrojtura me polisa të sigurimit të pasurisë (më 31.12.2016, 27.3% e ekspozimit kreditor të bankave ndaj ekonomive familjare kanë sigurim, që janë të mbrojtur edhe më tej me polisa të sigurimit të pasurisë).

### 3. Institucionet depozitare

#### 3.1 Bankat<sup>101</sup>

**Në vitin 2016, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, aktivitetet e sistemit bankar vendas u ndikuan fort nga situata e paqëndrueshme politike në vend, të shoqëruara nga spekulimet në lidhje me stabilitetin e kursit të denarit, të bankave vendase dhe të depozitave tek ta. Kjo çoi në një shkatërrim të besimit të publikut (sidomos në mesin e ekonomive familjare) dhe tërheqjen e depozitave dhe rritjen e kërkesës për valutë të huaj në prill dhe maj të vitit 2016. Lëvizjet e disfavorshme në tregun e këmbimit valutor dhe depozitimit imponuan një ndërhyrje të Bankës popullore për të qetësuar situatat në tregun e këmbimit valutor, si dhe për të rritur normën e interesit për bonot e thesarit dhe normën të rezervës së detyrueshme për detyrimet e bankave në denarë me klauzolë në valutë të huaj. Gjithashtu, janë riaktivizuar edhe ankandet e depozitave në valutë të huaj me BPRM, dhe atë me kushte më të favorshme të kontratës (normës së interesit), në mënyrë që për bankat të bëhen më me leverdi të mbajnë asetet likuide në valutë të huaj në vend se jashtë vendit. Masat e marra nga Banka popullore, si dhe menaxhimi i duhur i bankave me likuiditetin, të cilat pandërprerë kanë kryer të gjitha kërkesat për pagesën e depozitave, i dhanë efekte e pritura pozitive në gjysmën e dytë të vitit. Kështu, pritjet e subjekteve ekonomike gradualisht u stabilizuan dhe gradualisht u**

<sup>100</sup> Gjashtë banka.

<sup>101</sup> Në bazë të rregullt tremujore, Banka Popullore përgatit raporte për rreziqet në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë, ku mund të gjenden më shumë detaje mbi gjendjen, aktivitetet dhe ekspozimin e sistemit bankar ndaj rreziqeve të caktuara. Raportet publikohen në faqen e internetit, në seksionin "Publikime" ose në seksionin "Mbikëqyrja dhe Rregullimi Bankar".



<sup>162</sup>Termi i normave të interesit llogaritet mbi bazën e normave të tanishme spot përmes parimeve matematikore që pasqyrojnë lartësinë e normave me të cilat nuk ka hapësirë për arbitrazh dhe që lidhen me një periudhë të pritshme në të ardhmen. Formula e përgjithshme për llogaritjen e normave të nënkuptuara të afateve është:

$$F_{m_1, m_2} = \left( \frac{(1 + \text{spot za } m_2)^{m_2}}{(1 + \text{spot za } m_1)^{m_1}} \right)^{\frac{1}{m_2 - m_1}} - 1, \text{ ku } m_1 \text{ paraqet numrin e muajve në të ardhmen kur llogaritet norma e papërcaktuar e përfundimit (treguar në aksin horizontal të } \mathbf{Error! Reference source not found.}, \text{ ndërsa } m_2 \text{ - maturimi në muajt në të cilin lidhet norma e nënkuptuar (tre, gjashtë muaj e nëntë muaj). Kurba e spot hyrjeve duhet të inkorporojë në të, të gjitha informacionet e disponueshme aktuale, ekonomike ose politike, nga burimet e brendshme ose të jashtme, për të pasqyruar konsensusin e pjesëmarrësve të tregut (për normat e interesit ndërbankar - konsensusi midis bankave). Këto informacione aktuale, në fakt, përfshihen në llogaritjen e normave të ardhshme dhe në marrjen e kurbës së ardhshme të hyrjeve.$$

<sup>163</sup>Për një periudhë prej tre, gjashtë ose nëntë muajsh, për të cilat lidhen kthesat e hyrjeve përkatëse të ardhshme, do të ketë informacione dhe ngjarje të reja që do të ndryshojnë perceptimet e pjesëmarrësve të tregut dhe të cilat nuk mund të njihen në llogaritjen e normave të interesit përpara.

Grafik89

SPOT(lartë në të majtë) dhe kurba e drejtpërdrejtë (lartë në të djathtë) e normës së interesit ndërbankar në tregun e depozitave - SKIBOR dhe lëvizja e normave të interesit të nënkuptuar - normat e ardhshme për SKIBOR 3 muajore (poshtë në të majtë) dhe normat swap implicite për SKIBOR me shlyerje tremujore të pagesave me interes (poshtë drejtë) Në përqindje



Burimi: Llogaritjet e brendshme të BPRM.

Shënim: Normat implicite përpara për tre muaj SKIBOR (ang. forward rate agreement(FRA)- një marrëveshje në mes të dy palëve që duan të mbrohen nga lëvizjet e ardhshme në normat e interesit (blerësit për t'u mbrojtur nga mundësiti e rritjes, dhe shitësi nga reduktimi i mundshëm në normat e interesit në të ardhmen) paraqet një marrëveshje përpara në normat e interesit SKIBOR kur njëra palë paguan një normë interesi fikse dhe merr një normë interesi të ndryshueshme (dmth. ka një pozicion të gjatë të SKIBOR) dhe pala tjetër e marrëveshjes merr normën e interesit fikse dhe paguan një normë interesi të ndryshueshme (dmth ka një pozitë të shkurtër në SKIBOR).FRA është përcaktuar si FRA (X x Y), ku X dhe Y janë numri i shenjave të muajve, ku X nënkupton për sa kohë (në muaj) skadon marrëveshja dhe Y-X përfaqëson llojin e pjekurisë së SKIBOR (në muaj) të cilin e paraqet SKIBOR-i në fjalë (për shembull: FRA (9x12) do të thotë FRA e SKIBOR për tre muaj (marrë si 12-9), i cili zgjidhet për 9 muaj (X = 9)).Llogaritja e normave të interesit të ardhshëm është në përputhje me aplikimin e numrit kalendarik të ditëve të muajit dhe 360 ditëve të supozuara në një vit (ang. actual/360), i cili përdoret për të llogaritur SKIBOR (për thjeshtësi llogaritjet marrin çdo muaj 30 ditë dmth. Actual = 30). Kthesat e drejtpërdrejta të përpamë fillojnë me normat spot për secilin pjekuri të përshtatshme, pas së cilës shtohen normat e nënkuptuara implicite për secilin maturim. Normat e këmbimit të nënkuptuar për SKIBOR janë norma që mund të përfundojnë, pa arbitrazh, nëpërmjet shkëmbimeve të normave të interesit midis dy palëve kontraktuese, me një datë të ardhshme të dorëzimit të swap-it dhe shlyerjes periodike të pagesave të interesit. Një palë kontraktuese do të paguajë një normë fikse - një normë shkëmbimi të përlogaritur, lëvizja e të cilës është paraqitur në grafik dhe pala tjetër do të paguajë SKIBOR si normë interesi variabël referente në të cilën është bërë transaksioni swap.




## 8.2 Tregu primar

Në tregun primar në Republikën e Maqedonisë instrumentet themelore ekonomike që lëshohen janë letra me vlerë afatshkurta të Bankës popullore (bonot e thesarit - të disponueshme vetëm për bankat) dhe letrat me vlerë shtetërore të cilat janë të disponueshme për publikun e gjerë investues (bonot shtetërore dhe obligacionet shtetërore të vazhdueshme dhe të strukturuar). Sektori privat nuk shpreh interesim për shfrytëzimin e tregut financiar për financim personal, për këtë shkak lëshimi i obligacioneve dhe letrave me vlerë joshtetërore janë shumë të rralla dhe incidentale. Më 2016, bankat vendase dhe fondet pensionale janë investitorët kryesorë në letrat me vlerë shtetërore të lëshuara. Nga këtu, lëvizjet e tregut primar kanë domethënie të madhe për realizimin e këtyre segmenteve institucionale të sistemit financiar. Gjatë vitit 2016, marrëdhëniet në mes të shumës së ofruar dhe asaj të kërkuar të instrumenteve të tregut primar, në përgjithësi, ishte i baraspeshuar. Luhatje diçka më të theksuar në lidhje me lëvizjen e ofertës dhe kërkesës të instrumenteve të tregut primar kishte në tremujorin e katërt të vitit 2016, kur oferta e letrave me vlerë shtetërore ishte zvogëluar, duke marrë parasysh Eurobondin e lëshuar më parë në tregjet ndërkombëtare.

Grafik90

Pjesëmarrje në shumën e realizuar të instrumenteve individuale në tregun primar në PBB

Në përqindje



Burimi: BPRM

depozitit dhe tregut valutor<sup>165</sup>. Për këtë shkak, shumta e ofruar na bonot e thesarit , gjatë vitit 2016 ishte më e ulët për 8,8 % në krahasim me vitin 2015, si dhe kërkesa mesatare mujore e bankave ishte më e ulët për 26,4%.

Krahas intervenimeve të përmendura të bankës popullore<sup>164</sup> në tregun valutor dhe rritjen e normës së interesit të bonove të thesarit, për 0,75 pikë përqindje (nga 3,25% në 4,0%), banka popullore e uli edhe shumën e ofruar të bonove të thesarit nga 25.500 në 22.000 milionë dinarë, duke kontribuar kështu në kompensimin e likuidimit të zvogëluar të bankave në atë periudhë. Me stabilizim e pritshmërisë së subjekteve ekonomike dhe rritjen e depozitave në sistemin bankar, në muajin dhjetor 2016 dhe në janar 2017, Banka popullore realizoi tre ulje të njëpasnjëshme të normës së interesit prej 0,25 pikë përqindje, kështu që lartësia e sajë u rikthye përsëri në 3,25 %, ashtu siç ishte para ngjarjeve të prillit dhe turbulencave të


<sup>164</sup>Më shumë detaje për politikën monetare dhe masave të mara të politikës monetare në Raportin vjetor të BPRM, në pjesën për instrumentet monetare.

<sup>165</sup>Ndryshimet në lartësi të normës së interesit të bonove të thesarit u ndoqën dhe me rritje të disahershme në lartësi të shumës të ofruar në bonot e thesarit , dhe atë: në dhjetor 2016 merritjen prej 22.000 milion denarë në 23.000 milion denarë, në janar 2017, prej 23.000 milion denarë në 25.000 milion denarë, kurse në mars 2017 me rritje në 30.000 milion denarë.



## Grafik91

Raporti në mes të ofertës dhe kërkesës së instrumenteve të caktuara në tregun primar, në muaj  
Në përqindje



Burimi: BPRM.

interval prej 1.5% deri më 2,6%, në varësi nga maturimi dhe komponenti valutë i bonove shtetërore të ofruara.

Shteti është më aktiv (deri më tash dhe i vetmi) lëshues i letrave me vlerë afatgjate, përmes lëshimit të obligacioneve shtetërore. Shuma e re e lëshuar gjatë vitit 2016 është më e ulët në krahasim me vitin paraprak. Kështu që, vlera totale e emisioneve të letrat me vlerë afatgjate të realizuara gjatë vitit 2016 është 10,958 milionë denarë, që është më pak për 1.057 milionë denarë, ose për 8.8%, krahasuar me vitin paraprak. Letrat me vlerë afatgjate të lëshuara pothuajse në tërësi janë obligacione shtetërore të vazhdueshme, me afate të ndryshme ( prej dy, dhjetë, dhe pesëmbëdhjetë vjet), kurse tradicionalisht, ishin lëshuar dhe obligacione për denacionalizim<sup>167</sup>. Shuma totale e lëshuar të obligacioneve shtetërore gjatë vitit 2016 , paraqet 4.2% nga borxhi i përgjithshëm shtetëror më 31.12.2016, gjegjësisht 11,55 nga borxhi i brendshëm i qeverisë qendrore<sup>168</sup>.

Në vitin 2016, lëvizje më të dukshme në tregun primar kishte në segmentin e lëshimit të letrave me vlerë pronësore (1.111 milionë denarë, përkundër 120 milionë denarë në vitin 2015), kryesisht të lëshuara nga bankat. Megjithatë, shuma e letrave me vlerë pronësore të lëshuara në vitin 2016 është e ulët dhe paraqet vetëm 0.2% nga PBB. Në vitin 2016 nuk kishte emisione të reja të obligacioneve korporative dhe lëshim i aksioneve me anë të ofertës publike<sup>169</sup>.

<sup>166</sup>Totali i lëshuar i bonove shtetërore pothuaj se në tërësi ishin në valutë vendore (93.6%).

<sup>167</sup>Obligacionet për denacionalizim janë letra me vlerë që janë të regjistruara në emër, janë nominuar në euro dhe janë të bartshme pa kufi. Obligacioneve i përlogaritet norma e interesit në lartësi prej 2% në vit, kurse vlera nominale dhe norma e interesit paguhen në periudhë prej 10 vjetësh. Obligacionet për denacionalizim nga emisioni pesëmbëdhjetë janë lëshuar 20.06.2016, në shumë totale prej 12 milion euro në kundërvlerë të denarit.

<sup>168</sup>Në borxhin total shtetëror është vendosur borxhi i qeverisë qendrore, fondet publike dhe komunat, kurse nuk është përfshirë borxhi i bankës popullore. Burimi i të dhënave për borxhin total dhe borxhin e brendshëm të qeverisë qendrore është Ministria e financave.


<sup>169</sup>Në vitin 2016, ishte organizuar ofertë publike të obligacioneve korporative nga "Stopanska banka" SHA Manastir, e cila përfundoi pa sukses.



Grafik92

Lartësia e normës së interesit në tregun primar të bono thesari shtetërore e definuar nga lëshuesi, në denarë (majtas) dhe me klauzol valutore (djathtas)

Në përqindje



Burimi: BPRM

### 8.3 Tregtia sekondare me letra me vlerë (tregu përmes sportelit)

**Aktiviteti tregtar i subjekteve ekonomike në tregun sekondar të letrave me vlerë (tregu përmes sportelit) është i motivuar kryesisht nga nevoja për menaxhimin e likuidimit të tyre, megjithëse shënoi rritje në vitin 2016 (pothuajse dyfish u rrit në krahasim me vitin paraprak), megjithatë është me sasi relativisht modeste (1.7% nga PBB).** Lëvizjet pozitive në vitin 2016 në pjesën më të madhe dalin nga tregtia e rritur me bonot e thesarit, ndërsa më i moderuar është kontributi i tregtisë me regjistrat shtetëror, kryesisht gjysmën e parë të vitit. Kjo është për shkak të faktit që në ankandet e bonove të thesarit bankat marrin pjesë me shumica të përcaktuara maksimale (në bazë të pjesëmarrjes në pasivitetin e denarit në sistemin bankar), më vonë gjatë periudhës së plotësimit të rezervës të detyrueshme financohet përmes shitjesh definitive të bonove të thesarit të bankave tjera. Megjithatë, pavarësisht rritjes së pjesëmarrjes në shumën e tregtuar të letrave me vlerë afatshkurtër në tregjet përmes sportelit në PBB (nga 0.8% në vitin 2015 në 1.5% në vitin 2016), ky raport edhe më tej është në nivel shumë të ulët, që tregon një aktivitet ende të ulët në tregun sekondar. Në kundërshtim me lëvizjet ngritëse të tregut sekondar të letrave me vlerë afatshkurta, në vitin 2016, tregtia sekondare e letrave me vlerë afatgjate (obligacionet shtetërore) ka rënë. Gjithashtu, qarkullimi i realizuar të repo-transaksioneve në mes bankave është më shumë se katër herë më i vogël në raport me vitin paraprak. Bankat nuk kishin interes për shfrytëzimin e mjeteve përmes tregut të depozitave të siguruara (repro-tregut)<sup>170</sup>, kështu që në vitin 2016, rol kryesorë në këtë treg e kishin transaksionet në mes bankave dhe bankës popullore, të cilat në vitin 2016, për shkak të zhvillimeve në tremujorin e dytë të vitit, është gati dy herë më i madh në krahasim me vitin paraprak. Dhe krahas lëvizjeve pozitive të aktivitetit të tregut, ky segment i tregut ende karakterizohet me likuidim të pamjaftueshëm, në krahasim me potencialin e tij, që në përgjithësi i detyrohet likuidimit të lartë në sistemin bankar, si dhe dhënia e prioritetit instrumenteve tjera gjatë menaxhimit të likuidimit.

<sup>170</sup>prej vendosjes të repro-tregut në Republikën e Maqedonisë në vitin 2005, ky segment i tregut u karakterizua me aktivitet veçanërisht të ulët. Deri vitin 2012 transaksionet ishin përshtatur në intervenime monetare të Bankës popullore me bankat, që atëherë filloi të realizohen dhe repro-transaksione në mes bankave.


## 8.4 Tregtia sekondare të segmenteve të institucionalizuara

Në vitin 2016, krahas lëvizjes lartë të qarkullimit, tregtimi sekondar në tregun maqedonas të kapitalit në nivel të ulët. Ky segment i tregut ende karakterizohet me ofertën modeste të alternativave të investimit dhe likuidim të ulët, evidente është edhe interesimi i dobët i publikut më të gjerë investues në vend, si dhe mungesa e investitorëve të huaj institucional. Në kushte të influencës të fuqishme të faktorëve të natyrës joekonomike në vend, qarkullimi i tregut sekondar i kapitalit i realizuar nga tregtimi klasik (Aksionet dhe obligacionet)<sup>171</sup> megjithatë u rrit dhe arriti 2.332 milionë denarë, që është rritje për 251 milionë denarë, ose për 12.0%, në krahasim me vitin paraprak. Arsye për këtë është rritja e tregtisë me aksione, ndërsa qarkullimi vjetor i obligacioneve shënoi rrënje. **Megjithatë, kuptimi i tregtisë sekondare me letra me vlerë afatgjata në sistemin total financiar, i matur përmes pjesëmarrjes së qarkullimit të tregtisë klasike në bursë si % e PBB, edhe më tej është shumë e ulët dhe paraqet 0.4%.** Qarkullimi i rritur i bursës kishte ndikimin e duhur edhe ndaj lëvizjeve të indekseve të bursës<sup>172</sup>. Kështu që, në fund të vitit 2016, indeksi i bursës maqedonase MBI-10<sup>173</sup> arriti vlerë prej 2.134,91 pikë të indeksit, që paraqet rritje prej 16.5%, në krahasim me nivelin në fund të vitit paraprak.

### Grafik93

Shuma e tregtuar të letrave me vlerë në treg përmes sportelit (majtas) dhe pjesëmarrja në PBB (djathtas)

Në milionë denarë (majtas) dhe në përqindje (djathtas)



Burimi: BPRM

Gjatë kësaj, indeksi i bursës MBI-10 gjatë vitit 2016 nuk tregoi ndryshim më të madh dhe përgjithësisht lëvizte në kuadër të vlerës së saj mesatare. Neto-blerësit e vetëm të letrave me vlerë, dhe me këtë dhe investitori kryesor afatgjatë në tregun e kapitalit në Republikën e Maqedonisë, edhe më tej janë personat juridik<sup>174</sup>.

<sup>171</sup>Qarkullimi i kryer gjatë tregtisë klasike nuk i përfshin blok-transaksionet, qarkullimin e realizuar në ankande publike të berzës, si dhe ofertat publike të letrave me vlerë.

<sup>172</sup>Metodologjia për përlogaritjen të indekseve të veçuara dhe informatat për strukturën e tyre janë në dispozicion në internet faqen të "Berzës maqedonase" SHA Shkup- [www.mse.mk](http://www.mse.mk)


<sup>173</sup>më 15.12.2016 ishte kryer revizion i rregullt të indeksit IBM -10, ku prej 3.1.2017 në indeks hynë: "Alkaloid" SHA Shkup, "Stopasnska banka" SHA Shkup, "Granit" SHA Shkup, "Komerzialna banka" SHA Shkup, "Makpetroll" SHA Shkup, "Stopanska banka" SHA Manastir, "Makedonski Telekom" SHA Shkup, "Makedonia turs" SHA Shkup, "Nlb banka" SHA Shkup dhe "Ohridska banka" SHA Shkup.

<sup>174</sup>Më shumë detaje për vëllim dhe ndryshimet vjetore të qarkullimit të berzës gjatë tregtisë klasike, pjesëmarrja e tij në prodhimin e brendshëm bruto. Struktura e qarkullimit total në berz sipas llojit të investitorit, si dhe për treguesit për koncentrimin e tregut sekondar të kapitalit në Republikën e Maqedonisë mund të shihen në aneksin nr. 41 ka ky raport.



Grafik94


Kapitalizimi i tregut të shoqërive të listuara në tregun oficial në bursë (majtas) dhe pjesëmarrjes së saj (djathtas)  
Në milionë denarë dhe përqindje



Burimi: internet faqja e Bursës maqedonase dhe përllogaritjet të BPRM  
Shënim: Në kapitalizimin total të tregut janë përfshirë aksionet të listuara në tregun oficial, aksionet në tregun të shoqërive aksionare me obligime të veçanta për informim dhe obligacionet të listuara në tregun oficial.

Grafik95

Treguesit për xhiro të letrave me vlerë gjatë tretimit klasik  
Në përqindje



Burimi: internet faqja e Berzës maqedonase dhe përllogaritjet të BPRM

Shënim: Забелешка: Devijimet më të mëdha të indeksit të qarkullimit të obligacioneve të listuara në tregun zyrtar nga mesatarja e lëvizjes dymbëdhjetë mujore lidhen me muajt kur janë lëshuar obligacionet për denacionalizimin e emisioneve individuale.


Në vitin 2016, minimalisht u rrit pjesëmarrja në kapitalizimin e tregut të letrave me vlerë të listuara në tregun oficial në bursën maqedonase në PBB. Kapitalizimi i tregut të aksioneve të shoqërive të cilat listohen në bursën e maqedonisë në 31.12.2016 paraqiste 112.314 milionë denarë, që është më shumë për 12.955 milionë denarë, ose për 13,0%, në raport me periudhën e njëjtë nga viti paraprak. Kapitalizimi i tregut të obligacioneve u zvogëluar në bazë vjetore (për 9,1%), kryesisht për arsye të faktit që obligacionet për denacionalizim janë obligacione amortizuese (k.q. në baza të rregullta vjetore arrin për pagesë 10% nga kryegjëja e tyre). Projekti për lidhje regjionale të bursën e Maqedonisë me bursat tjera nga regjioni, në afat të gjatë duhet të siguroj ndikim pozitiv ndaj likuidimit dhe vëllimit të tregtimit dhe të siguroj më shumë mundësi për investime për investitorët vendor jashtë vendit.

Gjatë vitit 2016, vlera e treguesve të xhiros të aksioneve të listuara dhe obligacioneve në tregun oficial të bursës, përgjithësisht kanë lëvizur në kuadër të mesatares lëvizëse të tyre dymbëdhjetë mujore. Megjithatë, vlera e këtyre treguesve është në nivel relativisht të ulët, me çka vërtetohet likuidimi i kufizuar në tregun sekondar maqedonas të kapitalit (e cila nga ana e vet e pamundëson shitjen e lehtë dhe të shpejt të

letrave me vlerë), si dhe mbijetesën e disa shtëpive të brokerimit në treg,<sup>175</sup> gjatë mungesës të alternativave tërheqëse investuese të mjaftueshme.

#### Grafik96

Mesatarja vjetore të përhapjes në mes të blerjes së fundit dhe shitjes (djathtas) dhe normës së qarkullimit (djathtas) të aksioneve të cilat janë pjesë e indeksit IBM -10, të obligacioneve të cilat listohen në tregun oficial dhe të aksioneve të lëshuara nga bankat të cilat listohen në tregun oficial në % nga çmimi i fundit



Burimi: Internet faqja e Bursës së Maqedonisë dhe përlogaritjet të BPRM  
 Shënim: Proceset e veçanta vjetore të përhapjes në mes të blerjes së fundit dhe çmimit të shitjes fitohen mesatare të ponderuara për IBM -10 (si peshë shfrytëzohet pjesëmarrja në qarkullim e secilit aksion në veçanti në qarkullimin total me aksione), mesatarja e ponderuar për të gjithë obligacionet (si peshë shfrytëzohet pjesëmarrja në qarkullim e secilit obligacion në veçanti në qarkullimin total të obligacioneve) dhe mesatarja e ponderuar për të gjitha aksionet të lëshuara nga bankat (si peshë shfrytëzohet pjesëmarrja e në qarkullim i të secilit aksion në veçanti në qarkullimin total me aksione), për datat për të cilat ka listime adekuate.

<sup>175</sup>Gjatë vitit 2016 numri i shtëpivetë brokerimit u zvogëlua për një shtëpi të brokerimit. Në vitin 201, shtëpitë e brokerve treguan humbje në shumë prej 27 milion denar, që është pothuajse tre herë më shumë në raport me humbjen e realizuar në vitin 2015 (10 milion denar). Mjetet totale të shtëpive të brokerimit vazhduan të zvogëlohen (në fund të vitit 2016 arritën në 116 milion denar), kurse më e vogël është shuma e kapitalit dhe rezervat të shtëpive e brokerimit (për 35 milion denar, në nivel vjetor). Qarkullimet totale të realizuara u zvogëlua për 18 milion denar, në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin 2015.





## 8.5 Tregu valutor

Në vitin 2016, qarkullimi total i tregut valutor <sup>176</sup> paraqet 77% nga PBB, me të cilën, me çfarë ky segment i tregut financiar mbeti shumë i rëndësishëm për ekonominë në përgjithësi. Qarkullimi i realizuar i tregut devizor në vitin 2016, në shumë prej 7.615 milionë denarë<sup>177</sup>, është më i lartë për 4.1% (përkatësisht për 300.1 milionë denarë) nga qarkullimi në vitin paraprak. Lëvizjet e tregut devizor në Republikën e Maqedonisë në vitin 2015 ishin nën ndikimin e një seri sfidash të imponuara nga mjedisi. Reagimi i publikut, para se gjithash të personave fizik, me rritjen e pasigurisë e lidhur me situatën politike në vend, shkaktoi shtypje si në tregun valutor ashtu dhe në tregun e këmbimit (i reflektuar përmes këmbimit të depozitave të denarit në kartëmonedha të huaja, rritja e kërkesave të parave në valutë të huaj nga personat fizik dhe ngjashëm). Me qëllim rruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit në relacion me euron<sup>178</sup>, në prill dhe maj të vitit 2016 Banka popullore intervenoi në tregun valutor me shitjen e valutave të huaja dhe i siguroj bankat me likuidimin e nevojshëm devizor në shumë prej 129.1 milionë euro, që paraqet 5.3% i shumës mesatare të rezervave valutore gjatë vitit 2016. Në gjysmën e dytë të vitit e zvogëloi pasigurinë tek subjektet ekonomike, me çfarë erdh deri tek intervenimet në kahje të blerjes të valutave të huaja, që e tejkaloi shumën e shitjeve të realizuara në gjysmën e parë të vitit. Me këtë, pavarësisht shprehjes të efektit të pamjaftueshëm të situatës politike dhe shtypjeve në tregun valutor, intervenimi i bankës popullore në tregun valutor në vitin 2016 sollën blerjen neto të valutave të huaja në shumë prej 16,7 milionë euro (0.7% nga rezervat mesatare valutore gjatë vitit), që paraqet tregues të karakterit të kufizuar të këtyre lëvizjeve dhe vërtetim që nuk bazohen për bazën ekonomike, por kryesisht paraqet reagim psikologjik të subjekteve ekonomike. Reagimi i bankës popullore në drejtim të stabilizimit të pritshmërive dhe fuqizimin e besueshmërisë tek subjektet ekonomike e konfirmon angazhimin e ardhshëm për zbatimin e strategjisë së zgjedhur monetare për targetimin e kursit stabil nominal monetar të denarit me euron.

Strategjia e zgjedhur monetare të ruajtjes të kursit të këmbimit të qëndrueshëm, ndikoi dhe në drejtim të rangut relativisht të ulët në mes të kursit të blerjes dhe të shitjes në tregun monetar dhe në tregun këmbimor vendas për euron. Në kundërshtim me atë, në lidhje me valutat tjera të rëndësishme të përmasave të mëdha të dukshmeqë sinjalizon likuidim më modest (për tregun valutor) dhe/ose disponueshmëri (për tregun e këmbimit) të valutave tjera. Shtrirja mesatare e tregut (pa para në dorë) valutor është më e ulët nga shtrirja mesatare e tregut të këmbimit (për efektivitet) në interval nga 1.1 deri 2.0 pikë përqindje, në varshmëri nga valuta, që në fakt është indikator dallues shtesë që e inkorporojnë bankat në çmimin e valutave për mbulimin e harxhimeve për manipulimin me para të gatshme.

<sup>176</sup>Në qarkullimin total të tregut valutor janë përfshirë transaksionet e bankave me ndërmarrjet dhe personat fizik dhe transaksionet në mes bankave, duke përfshirë dhe neto –intervenimet të bankës popullore me bankat mbështetëse.


<sup>177</sup>Në këtë shumë të qarkullimit të tregut valutor janë përfshirë transaksionet e bankave me ndërmarrjet dhe personat fizik dhe transaksionet në mes bankave, nuk janë përfshirë neto-intervenimet të bankës popullore me bankën mbështetëse.

<sup>178</sup>Në vitin 2016, kursi nominal devizor i denarit në raport me euron në mesatare paraqet 61,59 denar për një euro (vetëm 0.01denar më pak nga viti paraprak). Njëkohësisht, për një dollar amerikan nevojiteshin vetëm 0,19 denar më shumë, ndërsa për një funte britanike nevojiteshin 1,36 denarë më pak dhe për një frank zviceran nevojiteshin 9,39 denar më pak, në raport me vitin 2015.

Grafik97

Qarkullimi total dhe pjesëmarrje në qarkullim të tregut valutor të bankës popullore në PBB (majtas) dhe neto-intevenimeve të tregut valutor të bankës popullore dhe pjesëmarrja e tyre në PBB (djathtas)

Në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: BPRM.

Shënim: meneto-intervenimet në tregun valutor nga BPRM, janë përfshirë transaksionet të BPRM me bankat-mbështetëse.

Grafik98

Harkunë mës kursit të blerjes dhe shitjes në tregun e këmbimit dhe në tregun valutor të bankave në Republikës së Maqedonisë

Në pikë bazike



Burimi: BPRM.

Shënim: Përlogaritja e përmasave në kursit të blerjes dhe shitjes në tregun e këmbimit dhe në tregun valutor përfshin të dhënat të shpallura publikisht të të gjithë bankave në Republikën e Maqedonisë, në përjashtim të bankës maqedonase për mbështetje të zhvillimit, ndërsa në tregun valutor, vetëm bankave mbështetëse.



## **SHTOJCAT**

## Shtojca nr. 1 Anketa mbi përceptimin e bankave për rreziqet në veprimtarinë e tyre

Anketa e kryer nga BPRM, mbi perceptimet e bankave për rreziqet në veprimtarinë e tyre, ka për qëllim njohjen e perceptimeve të bankave si institucione kryesore në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë, për burimet kryesore të rreziqeve me të cilat ballafaqohen në veprimtarinë e tyre, gjegjësisht rreziqet që aktualisht vlerësohen si të rëndësishme dhe aktuale.


Anketa përfshinë pesë grupe rreziqesh edhe atë rreziqet që dalin nga: mjedisi makroekonomik, tregjet financiare, sektori bankar, strategjia e bankës ose grupi bankar dhe ndryshimet në kuadrin rregullator. Përveç kësaj, përmes anketës kërkohej nga bankat që sipas rëndësisë së tyre t'i radhisin në mënyrë adekuate rreziqet me të cilat janë ballafaquar në vitin 2016, si dhe të shprehin pritshmëritë e tyre për vitin e ardhshëm kalendarik. Niveli i rëndësisë së secilës prej pesë grupeve të rreziqeve u vlerësua nga bankat në intervalin prej 1 deri në 5 (1 do të thotë se ky grup rreziqesh ka pak rëndësi për bankën, përderisa 5 do të thotë se ky grup i rreziqeve për momentin është jashtëzakonisht i rëndësishëm për bankën), ndërkohë që pritshmëritë janë shprehur përmes një vlerësimi cilësor sa i përket drejtimit të rreziqeve (ritje „+1“, ulje „-1“ ose e pandryshuar „0“).

Në vijim sjellim rezultatet e përmbledhura nga anketa e realizuar në fund të vitit 2016.

### I. Si rreziqe me rëndësi dhe ndikim më të madh në veprimtarinë e tyre, bankat theksojnë rreziqet që dalin nga mjedisi makroekonomik.

Grafik99

Rangimi i nivelit (majtas) dhe pritshmëritë (djathtas) mbi rreziqet që dalin nga mjedisi makroekonomik



\*Si ponder për llogaritjen e vlerësimit mesatar të ponderuar merret pjesëmarrja e aktivës së bankave në totalin e aktivës në niveltë sistemit bankar.

Edhe këtë vit, në krye të rreziqeve të natyrës makroekonomike bankat theksuan krizën e brendshme politike, e cila sipas tyre shkaktoi pasiguri në mesin e agjentëve ekonomikë dhe çoi në presione në tregun valutor, e që u neutralizua vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2016. Rreziku më i rëndësishëm nga mjedisi i jashtëm është rikuperimi i ngadalshëm i ekonomisë globale, i plotësuar nga rreziqet e shkaktuara nga vendimi i Britanisë së Madhe për të dalë nga BE. E gjithë kjo, sipas bankave, kontribuoi në një rritje ekonomike vjetore më modeste.




Po ashtu, tendenca e shpejtë rritëse e borxhit publik dhe qëndrueshmëria e tij u theksua nga shumica e bankave si një rrezik shumë i rëndësishëm që doli nga mjedisi makroekonomik, në kushtet e ekspozimit të lartë të sektorit bankar në shtet, përmes shumës së konsiderueshme të plasmaneve në letrat me vlerë shtetërore.

Kështu që, pritshmëritë e bankave (gjatë anketës së kryer në fund të vitit 2015) për të rritur rëndësinë e rreziqeve nga grupi i rreziqeve makroekonomike u realizuan në vitin e ardhshëm, respektivisht në vitin 2016. Për vitin 2017, bankat presin përsëri një rritje në rëndësinë e këtij grupi rreziqesh, por me një ritëm më të ngadaltë krahasuar me pritshmëritë e vitit 2016. Kjo, sipas bankave, para se gjithash do të varet nga arritja e stabilitetit politik në Republikën e Maqedonisë, gjë që do të ndikonte pozitivisht në ekonominë e vendit. Në përgjithësi, bankat presin që rreziqet që dalin nga mjedisi makroekonomik të vazhdojnë edhe më tej të jenë jashtëzakonisht të rëndësishëm, si nga aspekti i brendshëm ashtu edhe nga ai i jashtëm.

## II. Si grup të dytë të rreziqeve sipas rëndësisë, bankat vlerësuan rreziqe që dalin nga sektori bankar.

Grafik100

Rangimi i nivelit (majtas) dhe pritshmëritë (djathtas) mbi rreziqet që dalin nga sektori bankar




\*Si ponder për llogaritjen e vlerësimit mesatar të ponderuar merret pjesëmarrja e aktivitet të bankave në totalin e aktivitet në nivel të sistemit bankar.

Nga ky grup i rreziqeve, bankat, posaçërisht ato me pjesëmarrje më të lartë të tregut, zakonisht e dallojnë konkurrencën e ndërsjellë si një rrezik të rëndësishëm. Megjithatë, sa i përket vitit 2016, bankat treguan se u ofrojnë klientëve kushte të ngjashme për produktet që ato ofrojnë, që do të thotë se ky grup i rreziqeve mbetet në nivel të qëndrueshëm dhe nuk duhet të ketë ndikim më të madh në veprimet e tyre në të ardhmen. Bankat me pjesëmarrje më të madhe të tregut e vlerësojnë rrezikun që vjen nga sektori bankar si rritje të moderuar, për shkak të presioneve që, sipas tyre, dalin nga konkurrenca në pjesën e çmimit të produkteve të ofruara. Bankat, posaçërisht bankat e mëdha presin një rënie në rëndësinë e këtij grupi të rreziqeve përgjatë vitit 2017.

### III. Grupi i tretë i rreziqeve sipas rëndësisë për veprimtarinë e bankave janë rreziqet që rrjedhin nga ndryshimet në kuadrin rregullator.

Grafik101

Rangimi i nivelit (majtas) dhe pritshmëritë (djathtas) mbi rreziqet që dalin nga ndryshimet në kuadrin rregullator




\*Si peshë (matës) për llogaritjen e vlerësimit mesatar të ponderuar merret pjesëmarrja e aktivës së bankave në totalin e aktivës në nivel të sistemit bankar.

Niveli i këtij rreziku në vitin 2016, sipas bankave është pak më i ulët se vlerësimet për vitin 2015. Por, bankat presin rritje të rreziqeve nga ndryshimet në kuadrin rregullator në vitin 2017. Mes tjerash, bankat thirren në rregulloren e re sa i përket përputhshmërisë me standardet e Basel 3, në rregulloren evropiane në pjesën e planeve për rimëkëmbje bankare, si dhe në rregulloren e shpallur mbi zbatimin e SNRF 9, si ndryshime në mjedisin rregullator që mund të shkaktojnë rreziqe në rritje gjatë zbatimit të tyre dhe efektet mbi kapitalin dhe rezervat.

### IV. Në pozicionin e katërt, sipas rëndësisë që kanë në veprimtarinë bankare, rangohen rreziqet që rrjedhin nga zhvillimet në tregjet financiare.

Grafik102

Rangimi i nivelit (majtas) dhe pritshmëritë (djathtas) mbi rreziqet që dalin nga tregjet financiare



\*Si peshë (matës) për llogaritjen e vlerësimit mesatar të ponderuar merret pjesëmarrja e aktivës së bankave në totalin e aktivës në nivel të sistemit bankar.

Bankat e vlerësuan grupin e rreziqeve nga tregjet financiare si më pak të rëndësishëm, rëndësia e të cilëve u zvogëluar në krahasim me vitin 2015, kurse gjatë vitit 2017 pritet që të reduktohet edhe më tej rëndësia e këtij grupi rreziqesh. Rëndësia më e vogël e këtij grupi rreziqesh në raport me grupet e mëhershme është pasqyrë e strukturës së thjeshtë të sistemit financiar maqedonas dhe tregut financiar disi më pak të zhvilluar, që



reflektohet edhe përmes orientimit mbizotërues të bankave ndaj veprimtarive bankare klasike (grumbullimi i depozitave, dhënia e kredive).


Rreziqet nga tregjet financiare në vitin 2016, bankat kryesisht i lidhin me krizën në muajin prill dhe presionet në tregun devizor, të cilat u shkaktuan nga faktorë joekonomikë. Po ashtu, bankat theksuan rrezikun nga ndryshimi normave të interesit në tregjet financiare ndërkombëtare, që sipas bankave varen nga politika monetare e BQE dhe FED-it.

Sa i përket pritshmërive për periudhën e ardhshme, bankat presin që rëndësia e rrezikut nga ndryshimi i normës së interesit të rritet, duke pasur parasysh ndryshimet e shpallura në ligjin për marrëdhëniet obligative, të cilat do të përcaktojnë qartë llojet e normave të interesit (fikse dhe të ndryshueshme), mënyrën dhe kushtet për ndryshimin e tyre, që në fakt do të thotë pamundësi për përdorim të mëtejshëm të të ashtuquajturës normat e rregullueshme të interesit.

## V. Si rreziqe me më pak rëndësi, bankat vlerësuan rreziqet që rrjedhin nga strategjia e bankës ose grupi bankar.

Grafik103

Rangimi i nivelit (majtas) dhe pritshmëritë (djathtas) mbi rreziqet që dalin nga strategjia e bankës ose grupi bankar



\*Si ponder për llogaritjen e vlerësimit mesatar të ponderuar merret pjesëmarrja e aktivitet të bankave në totalin e aktivitet në nivel të sistemit bankar.

Bankat deklaruan se në vitin 2016 drejtuan aktivitetet e tyre drejt përmirësimit të kapitalizimit dhe rritjes së profitabilitetit, prezantimit të produkteve të reja, rritjes së numrit të klientëve etj. Sipas bankave, strategjitë e tyre të biznesit u treguan të përshtatshme në vitin 2016, prandaj ky grup i rreziqeve sipas rëndësisë së tij është vlerësuar me vlerësimin më të ulët, ku me ç'rast udhëheqin bankat më të mëdha. Për dallim prej tyre, bankat me pjesëmarrje më të ulët të tregut konsiderojnë se ky grup rreziqesh është më i rëndësishëm. Në raport me pritshmëritë, në nivel të sistemit bankar, mesatarisht nuk pritet ndryshim lidhur me rëndësinë e këtij grupi të rreziqeve në vitin 2017, ndonëse bankat më të mëdha shprehën pritshmëritë për rritjen e rëndësisë së këtij grupi të rreziqeve në periudhën e ardhshme. Zakonisht, në anketë parashtrohen disa pyetje shtesë për temat që konsiderohen aktuale dhe të rëndësishme.

Kështu që, sa i përket lëvizjeve në tregun e banesave, shumica e bankave nuk pritnin që në afat të mesëm çmimet e banesave dukshëm të ndryshojnë, që do të thotë se ndikimi i tyre në veprimtarinë e bankave do të mbetet i qëndrueshëm. Një pjesë e vogël e bankave pritnin që në afat më të gjatë, rritja e ofertës për banesa mund të kishte ndikim në çmimet e banesave, rrjedhimisht edhe në kërkesën për kredi për strehim dhe në kërkesat për lartësinë e kolateralit për kreditë hipotekare.



Sa i përket tregut të kapitalit në Maqedoni, bankat pritnin lëvizje të caktuar dhe rritje të qarkullimit në vitin 2017, por kjo nuk do të ndikonte dukshëm në veprimtarinë e tyre, edhe pse ata pritnin që subjektet të drejtonin një pjesë të aktiveve likuide drejt tregut të kapitalit. Lidhja rajonale e bursave dhe specifikimi i mëtejshëm i rregullimit të tregut të kapitalit për të qenë në përputhje me rregulloren evropiane mund të ndikonte pozitivisht në rritjen e ofertës dhe kërkesës së letrave me vlerë, më shumë mundësi për investitorët e vendit tonë për të blerë letra me vlerë me të cilat do të tregtohet nëpërmjet platformës rajonale dhe do të duhej të arrihet stabilizimi i çmimeve të letrave me vlerë pa luhatje të mëdha. Pothuajse të gjitha bankat nuk pritnin që këto ndryshime të ndikonin ndjeshëm në veprimtarinë e tyre as edhe në periudhë afatmesme.

Sa i përket efekteve të fillimit të zbatimit të standardit të ri ndërkombëtar të raportimit Financiar IFRS 9, shumica e bankave ende nuk mund të vlerësojnë me saktësi ndikimin e zbatimit të këtij standardi në veprimtarinë e tyre. Megjithatë, ata tregojnë se inkorporimi i tij (standardi) lidhet me kostot e caktuara, para se gjithash për shkak të nevojës për zgjidhje të reja softuerike për të llogaritur dëmtimin. Bankat gjithashtu nxjerrin ne pah pasigurinë sa i përket efekteve nga kërkesat e standardit për përcaktimin dhe ndarjen e të ashtuquajturës parashikimet e pritshme për humbjet e kredisë për tërë jetëgjatësinë për kategori të caktuara të instrumenteve financiare, ku ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë me matjen fillestare.




## Shtojca nr. 2 Testimi i stresit të sistemit bankar të Republikës së Maqedonisë duke zbatuar skenarin e analizës dhe matricën e infeksionit

Për të testuar qëndrueshmërinë e sistemit bankar maqedonas në lloje të ndryshme të ekstremitetit, por goditje të mundshme, Banka popullore kryen teste tremujore të ndjeshmërisë dhe një herë në vit zbaton të ashtuquajturin skenar për analizë të sistemit bankar, i cili supozon lëvizje të pafavorshme në mjedisin makroekonomik. Gjithashtu, skenari i analizës përfshin përpunimin e të ashtuquajturës matricë e infeksionit, me qëllim të shqyrtimit të efekteve nga mbingarkesa, rrjedhimisht problemet eventuale nga njëra bankë në tjetrën, si dhe nga sistemi bankar tek kompanitë e sigurimeve dhe fondet e detyrueshme pensionale. Korniza për zbatimin e testeve të stresit<sup>179</sup> të Bankës popullore, në një formë të thjeshtëzuar, është paraqitur në figurën e mëposhtme.

Figura 1

Paraqitja e thjeshtëzuar e kornizës për testimin e stresit të Bankës popullore



Burimi: Përgatitur nga punonjësit e Bankës popullore.

Në fillim të vitit 2017, rreth nevojës për testimin e stresit të sistemit bankar, duke zbatuar skenarin për analizë u përpunuan **dy skenarë stresi makroekonomik të pafavorshëm**. Të dy skenarët e stresit mbulojnë një horizont kohor prej dy vitesh (2017 dhe 2018).

**Skenari i parë i stresit makroekonomik** supozon një devijim të pafavorshëm të treguesëve bazë makroekonomik nga niveli i arritur në vitin paraprak, në lartësinë e një

<sup>179</sup>Më shumë detaje rreth testeve të stresit të aplikuara nga Banka popullore e Republikës së Maqedonisë mund të gjenden në faqen e internetit në vijim: [http://www.nbrm.mk/WBStorage/Files/WebBuilder\\_FSR\\_2015\\_ENG\\_Annex1.pdf](http://www.nbrm.mk/WBStorage/Files/WebBuilder_FSR_2015_ENG_Annex1.pdf). Më shumë detaje rreth testeve individuale të ndjeshmërisë dhe rezultateve të këtyre testeve mund të gjenden në raportet për rreziqet në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë, të cilat përgatiten në baza të rregullta tremujore. Raportet janë në dispozicion në faqet vijuesetë internetit:


<http://www.nbrm.mk/?ItemID=D38D33E964D84D45B2E6EFBCB996848B> <http://www.nbrm.mk/?ItemID=6421C6EE3906F448B7E7A8E978BA933A>.

devijimi standard, në secilën prej dy viteve (2017 dhe vitin 2018) të përfshira në testin e stresit (në tekstin e mëtejshëm: skenari hipotetik i stresit). **Skenari i dytë i pafavorshëm makroekonomik** është një skenar historik dhe supozon pasqyrimin e lëvizjeve të treguesve të analizuar makroekonomik realizuar në periudhën e kaluar (në tekstin e mëtejshëm: skenari historik i stresit) në periudhën e ardhshme dyvjeçare (2017 dhe vitin 2018). Më saktë, brenda këtij skenari është bërë një rishikim i ndryshimeve të treguesve makroekonomike të realizuara në vitin 2001 dhe 2002 për periudhën e ardhshme dyvjeçare „kur paqëndrueshmëria politike e sigurisë në vend pati efekte të rëndësishme negative në ecurinë e ekonomisë së vendit”.

### Grafik104

Krahasimi mes lëvizjeve të parashikuara të treguesve bazë makroekonomikë nën skenarin bazë makroekonomik (parashikimet makroekonomike të BPRM-së nga cikli i projeksionit të prillit) skenari hipotetik i stresit dhe skenari historik i stresit

Në përqindje




Burimi: Llogaritjet e Bankës popullore.



Grafik105

Pjesëmarrja jofunksionale në kreditë e përgjithshme ndaj subjekteve jofinanciare (majtas) dhe norma e kthimit të aktivitetit mesatar dhe pjesëmarrja e tregut të bankave sipas rezultatit të realizuar financiar (djathtas)



Burimi: Llogaritjet e Bankës popullore.

**Rezultatet nga testimi i stresit të kryera në formën e një skenari për analizë tregojnë një qëndrueshmëri të kënaqshme të sistemit bankar total ndaj lëvizjeve të pafavorshme në mjedisin makroekonomik. Analiza nga pikëpamja individuale tregon një cenueshmëri të caktuar të bankave individuale, të skenarëve të supozuar makroekonomikë të pafavorshëm, dhe nevojën për rikapitalizim gjatë realizimit eventual të këtyre skenarëve.** Gjatë zbatimit të skenarit për analizë, kreditë jofunksionale të subjekteve jofinanciare u rritën për 25% brenda skenarit të stresit historik, ose rreth 30% në skenarin hipotetik. Në disa vite, sistemi bankar shënoi humbje, shuma maksimale e të cilave arriti 0.9% të aktiveve mesatare (siç nuk është vërejtur në shtatëmbëdhjetë vitet e fundit ose edhe më shumë). Rënia e mjeteve vetanake të sistemit bankar përfundimisht do të arrinte në 6.9 miliardë denarë (ose 14.5%). Edhe përkundër lëvizjeve të tilla të pafavorshme, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar u ul në një nivel jo më të ulët se 12.8%. Analizuar nga banka individuale, në rastin më ekstrem, trembëdhjetë banka me një pjesëmarrje të përgjithshme të tregut në aktivin e sistemit bankar prej 80% do të përballëshin me një humbje në veprimtarinë e tyre, dhe tek njëra prej tyre (me një pjesëmarrje në treg prej 2.2%), treguesit e aftësisë paguese bien nën nivelet minimale të përcaktuara ligjërisht<sup>180</sup>. Rikapitalizimi i domosdoshëm i bankës, për treguesit e aftësisë paguese që të kthehen përsëri në nivelet minimale, në një rast ekstrem, do të arrinte në 437 milionë denarë (0.1% nga PBB-ja, për vitin 2016).

Megjithatë, përderisa merret në konsideratë obligimi i bankave për të ruajtur një shtresë mbrojtëse të kapitalit të vet në shumën prej 2.5% nga aktiva e ponderuar sipas rreziqeve (duke filluar nga 31.03.2017), si dhe një shtresë mbrojtëse të kapitalit për bankat e përcaktuara si sistematikisht të rëndësishme<sup>181</sup>, atëherë, në një rast ekstrem, katër

<sup>180</sup>8% për normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, 6% për kapitalin themelor dhe 4.5% për normën e kapitalit të rregulltthemelor(anglisht. Common Equity Tier 1 ratio).


<sup>181</sup>Bankat e përcaktuara si të rëndësishme për sistemin (deri më 31.12.2016) kanë detyrim të alokojnë shtresën mbrojtëse të nevojshme të kapitalit për bankat me rëndësi për sistemin dhenë tërësi më 31.03.2018. Megjithatë, gjysmën e kësaj kërkesë kapitale, bankat janë të detyruara ta alokojnë përfundimisht më 30.09.2017.

banka(me një pjesëmarrje në treg prej 16.8%) do të ishin nën nivelin e kërkuar minimal të treguesve të aftësisë paguese. Në këtë rast, nevoja e rikapitalizimit të bankave është dy here më e lartë dhe arrin në 879 milionë denarë (që është përsëri rreth 0.1% nga PBB-ja, për vitin 2016). Prandaj, nën skenarin më ekstrem të supozimeve, një bankë do të kishte problem me aftësinë paguese (treguesit e saj të aftësisë paguese janë më të ulëta se nivelet minimale të rregulluara dhe madje bien nën zero), dhe tre banka nuk do të kishin sasi të mjaftueshme të kapitalit të rregullt themelor për t'i alokuar shtresat mbrojtëse të kapitalit, ku me ç'rast do të aktivizohej kufizimi i shumës së fitimit që këto banka mund t'ua ndajnë aksionerëve të tyre në formë të dividendit, rrjedhimisht sipas politikës së shpërndarjes së fitimit.

Grafik106

Treguesi i aftësisë paguese\* në nivel të sistemit bankar (majtas) dhe struktura e rënies së përqindjes totale të mjeteve vetanake (djathtas)

Në përqindje



Burimi: Llogaritjet e Bankës popullore.

\*Llogaritjet e treguesve të aftësisë paguese (përfshirë edhe nivelin e arritur për vitin 2016) dhe rënien totale të përqindjes së mjeteve vetanake në përputhje me kërkesat e Bazelit 3. Aktualisht, bankat në Republikën e Maqedonisë nuk kanë në dispozicion instrumente që i plotësojnë kushtet që duhet të përfshihen në kapitalin themelor shtesë. Prandaj, norma e kapitalit të rregullt dhe norma e kapitalit themelor janë të barabarta. Në testin e stresit supozohet që bankat nuk janë në gjendje të kryejnë një rritje të mjeteve vetanake, përveç përmes mbajtjes së fitimeve të realizuara, që nënkupton që kapitali themelor shtesë nuk është i pranishëm në mjetet vetanake të bankave në vitin 2017 dhe 2018.

**Të katër bankat me rezultate disi më të dobëta nga test stresi nuk kanë sasi të larta të detyrimeve ndaj bankave të tjera<sup>182</sup>. Prandaj, nuk pritet të arrihet deri në një realizim domethënës të rrezikut të infektimit,** gjegjësisht tejkallim i problemeve nga këto tek bankat e tjera në sistem, përmes kanalit që udhëheq përmes kërkesave/detyrimeve ndërbankare. Në të kundërt, tre kompani sigurimi kanë sasi të konsiderueshme të depozitave të investuara në banka me rezultate disi më të dobëta nga testi i stresit, pjesëmarrja e të cilave në totalin e aktivës të këtyre kompanive të sigurimit është mes 20-23%. Dy fondet e detyrueshme pensionale gjithashtu kanë depozita të plasura në këto banka, por pjesëmarrja e tyre në mjetet e përgjithshme neto të fondeve është e vogël (1.9% në njërin, gjegjësisht 3.4% në fondin tjetër pensional).

<sup>182</sup>Detyrimet e këtyre bankave ndaj bankave të tjera në sistem, individualisht, nuk kalojnë 2.5% e totalit të aktivës të bankave të tjera.




Grafik107

Zvogëlimi i mjeteve likuide gjatë simulimit për goditjet e kombinuara të likuiditetit (majtas) dhe kontributi i goditjeve individuale të kombinuara në zvogëlimin e mjeteve likuide gjatë simulimit për një goditje të kombinuar të likuiditetit (djathtas)

Në përqindje

si përqindje e zvogëlimit të mjeteve likuide



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga ana e bankave.

**Për të testuar qëndrueshmërinë e bankave dhe sistemin bankar të goditjeve të likuiditetit, gjithashtu u zhvilluan disa simulime të testeve të stresit, me të cilët presupozohet një kombinim i daljeve të shumë llojeve të burimeve të financimit<sup>183</sup> jashtë bankave (të prezantuara në grafikët e mësipërme).**

<sup>183</sup>Më shumë detaje rreth rezultateve nga këto simulime mund të gjenden në raportin mbi rreziqet në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, f. 49 - 51(<http://www.nbrm.mk/?ItemID=1C26A2647E2F41479638709DDF21F0E0>).



### Shtojca nr. 3 Rreziqet në pjesën e hapësirës digjitale, krimi kibernetik

Ndonëse sot në botë nuk ekziston një përkufizim global i pranuar i krimit kibernetik dhe përkufizimet varen nga qëllimi i përdorimit të këtij termi, më së shpeshti ky lloj i krimit lidhet me një numër të kufizuar aktiviteteve që synojnë të rrezikojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit<sup>184</sup>. Qëllimi i këtyre aktiviteteve (sulmet) më së shpeshti është i lidhur me vjedhjen e informacionit për të fituar avantazh konkurrues, përvetësim të mjeteve financiare, vjedhje të pronësisë intelektuale, vjedhje të identitetit, shkelje të reputacionit të kompanive, mosfunksionim të sistemeve për ofrim të shërbimeve, etj. Siguria e hapësirës digjitale përfshin aktivitete për të mbrojtur kompanitë dhe individët nga sulmet e qëllimshme, thyerje të sistemeve dhe incidente, si dhe pasojat nga të njëjtat. Kjo në praktikë u referohet atyre llojeve të sulmeve, thyerje të sistemeve ose incidenteve që janë të sofistikuara, të qëllimshme dhe të vështira për të zbuluar, menaxhuar dhe kontrolluar. Përveç kësaj, fokusi i sigurisë në hapësirën digjitale është i orientuar drejt të ashtuquajturës kërcënime të avancuara të vazhdueshme<sup>185</sup>, luftë digjitale<sup>186</sup> dhe ndikimi i tyre mbi kompanitë dhe individët.

Pjesëmarrja e krimit kompjuterik në krimin e përgjithshëm ekonomik shënoi rritje të vazhdueshme edhe atë, nga një përqind në vitin 2009 në 23% në vitin 2011, duke tejkaluar format tjera të krimit (psh. larjen e parave osespionazhin)<sup>187</sup>. Sipas Qendrës për studime strategjike dhe ndërkombëtare, me seli në Uashington (SHBA), dëmet e përgjithshme të shkaktuara në ekonominë globale vlerësohen në 375-575 miliardë dollarë<sup>188</sup>. Sipas një sondazhi të kryer nga „Juniper Research“<sup>189</sup>, numri i thyrjeve (dëmeve) në sistemet deri në vitin 2019 pritet të tejkalojë 16.000 me një humbje potenciale prej 2.100 miliardë dollarësh.

Si arsye kryesore për rritjen e këtij lloji të krimit konsiderohen:

- Rritja eksponenciale e numrit të pajisjeve dhe individëve që janë vazhdimisht të qasur në internet<sup>190</sup>;
- Rritja e varësisë nga jetesa e përgjithshme sociale e teknologjisë së informacionit: shitjet online, bankat dhe financat, udhëtimet dhe logjistika, infrastruktura;
- Numri në rritje i individëve dhe kompanive të ekspozuara ndaj këtij rreziku në një shpërndarje të pabarabartë të njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë së informacionit<sup>191</sup>;
- Një fushë e gjerë e qëllimeve potenciale për sulm, me përdorimin e mjeteve dhe teknologjisë relativisht të lirë dhe të përballeshme;

Edhe pse gjendja në sektorin financiar (sidomos në sektorin bankar) është disi më e mirë krahasuar me fushat tjera<sup>192</sup>, ekziston shqetësim se qasja e mëparshme në fushën e sigurisë së informacionit mund të jetë e pamjaftueshme. Në vend të pyetjes nëse një institucion financiar do të jetë subjekt i një sulmi, gjithnjë e më shumë mendohet mbi atë

<sup>184</sup> United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC) - Comprehensive Study on Cybercrime (2013)

<sup>185</sup> Në anglisht. APT – Advanced Persistent Threats

<sup>186</sup> Ndryshe nga periudha deri në vitin 2010, ku sulmet zakonisht janë kryer nga hakerët individualë, ky lloj i sulmit kryhet nga grupe individësh shumë të motivuar dhe të trajnuar mirë, me përkrahje të konsiderueshme financiare e mbështetur nga qendra të caktuara të pushtetit, qeverive ose shteteve.

<sup>187</sup> PricewaterhouseCoopers, Global State of Information Security Survey, 2011

<sup>188</sup> Center for Strategic and International Studies (CSIS): Net Losses: Estimating the Global Cost of Cybercrime (2014)

<sup>189</sup> Juniper Research: Cybercrime and the Internet of Threats 2017

<sup>190</sup> Në vitin 2011, 30% e popullsisë botërore pati qasje të gjerë në internet. Supozohet se në vitin 2017 ky numër do të kalojë 70 përqind. Deri në vitin 2020, numri i pajisjeve të lidhura me internet (IoT-Internet of Things) parashikohet të tejkalojë numrin e njerëzve në një raport 6:1.

<sup>191</sup> Sipas raportit vjetor të kompanisë „Cisco“ për vitin 2017 (Annual cybersecurity report), 72% nga kompanitë shfrytëzojnë ndihmën e furnitorëve të jashtëm në 20% deri 80% nga pjesa e sigurisë (besueshmërisë).

<sup>192</sup> Kjo para se gjithash është rrjedhojë e kërkesave të rrepta rregullative, numrit të kufizuar të shërbimeve të ofruara në internet, qasjes konservatore në punë, etj.



se kur një institucion do të jetë subjekt i sulmit, nëse është mjaft i mbrojtur dhe cilat do të jenë pasojat e mundshme. Paralelisht me përsosjen e sulmeve nga hapësira digjitale dhe me rritjen e intensitetit të tyre, nevojitet një qasje e përparuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga sulmet, që përfshin përfshirjen e kërcënimeve bashkëkohore gjatë vlerësimit të rrezikut, aplikimin e mekanizmave mbrojtës në më shumë nivele për infrastrukturën kritike, monitorimin e vazhdueshëm të trendeve në pjesën e kërcënimeve potenciale dhe sulmeve, si dhe ndarjen e këtij informacioni me institucionet dhe kompanitë përkatëse.

Disa organizata me aktivitete parësore në fushën e mbrojtjes së informacionit dhe sistemeve të informacionit, si dhe disa organe rregullatore, kanë dalë tashmë me standarde për të përmirësuar mbrojtjen në këtë fushë<sup>193</sup>. Duke ndjekur aktivitetet e organeve rregullatore financiare në fushën e sigurisë digjitale, e duke pasur parasysh edhe numrin e shtuar të sulmeve në lëmin e afërt, banka popullore përgatiti një mjet vetëvlerësimi për rrezikun e pandarë ku janë të ekspozuara bankat dhe aplikimin e një shkalle të përshtatshme të gatishmërisë<sup>194</sup>. Vetëvlerësimi i rrezikut të brendshëm merr në konsideratë madhësinë, kompleksitetin dhe llojin e aktiviteteve që kryejnë bankat, kanalet përmes të cilave ofrohen shërbimet, karakteristikat organizative, kërcënimet e jashtme dhe produktet online, pa mos u marrë në konsideratë kontrollet ekzistuese të zbatuara për të zvogëluar rreziqet. Bazuar në vetëvlerësimin dhe vlerësimin e efikasitetit të kontrolleve të kryera, bankat duhet të përcaktojnë shkallën e gatishmërisë që ata duhet të arrijnë për trajtimin e rreziqeve të identifikuar. Shkalla e gatishmërisë kategorizohet në tre nivele (primare, sekondare dhe e avancuar) për pesë fusha të ndryshme: menaxhim të rrezikut nga sulmet në hapësirën digjitale; mbledhje, përpunim dhe analizimit të kërcënimeve përkatëse të nxjerra nga burime të sakta dhe të verifikuara<sup>195</sup>; kontrollet për mbrojtjen e hapësirës digjitale; menaxhimin të ndërvarësisë; dhe menaxhimin të incidenteve në hapësirën digjitale. Organet e bankës janë përgjegjëse për arritjen e nivelit të kërkuar të gatishmërisë në çdo fushë të veçantë, në varësi të vlerësimeve të natyrshme të nivelit të rrezikut, nëpërmjet planeve të veprimit me afate zbatimi. Rekomandimi i bankës popullore është që bankat të përdorin një nivel parësor ose të mesëm të gatishmërisë. Banka popullore ka të drejtë të rekomandojë edhe arritjen e një niveli më të lartë të gatishmërisë në një periudhë të caktuar kohore, nëse e vlerëson si të nevojshme.

Konkluzionet e përgjithshme nga procesi i vetëvlerësimit janë se tre banka kanë një nivel të ulët, përderisa dymbëdhjetë tjera të mbetura kanë një nivel të moderuar të rrezikut të pandarë. Rrjedhimisht, sipas instrumentit të vetëvlerësimit të rrezikut, tre nga bankat duhet të arrijnë një nivel bazë të gatishmërisë, ndërsa pjesa tjetër e bankave të mbetura do të duhet të zgjedhin ndërmjet nivelit parësor dhe atij të mesëm të gatishmërisë. Në përputhje me planet e veprimit të hartuara nga bankat, të gjitha bankat do të përfundojnë me zbatimin e nivelit bazë të gatishmërisë deri në fund të vitit 2017. Nga pesë bankat që kanë marrë vendim për të aplikuar nivel të mesëm të gatishmërisë, tek këto dy banka këto aktivitete duhet të përfundojnë deri në fund të 2017 dhe tek tre të tjerat deri në fund të vitit 2019.

<sup>193</sup> NIST- Framework for Improving Critical Infrastructure Cybersecurity; BIS - Guidance on cyber resilience for financial market infrastructures; FFIEC – Cybersecurity awareness program & Cybersecurity Assessment Tool; European commission - Cybersecurity Strategy of the European Union, ECB – Opinion on a proposal for a directive of the European Parliament and of the Council concerning measures to ensure a high common level of network and information security across the Union, etj.

<sup>194</sup> Mjeti bazohet në mjetin e vlerësimit të sigurisë kibernetike të agjencisë rregullatore të SHBA've – FFIEC.

<sup>195</sup> Threat intelligence



## Shtojca nr. 4 Monedhat digjitale dhe rreziqet që lidhen me to

Risitë digjitale në financa, të njohura edhe si "fintek" (FinTech), po tërheqin shumë vëmendje në industrinë financiare. Monedhat digjitale, e veçanërisht ato që përdorin një mekanizëm të ndërtuar të decentralizuar të pagesave bazuar në përdorimin e të ashtuquajturës teknologjia e bonove të shpërndara<sup>196</sup> (në anglisht. distributed ledger) janë risitë të cilët mund të kenë një gamë të gjerë ndikimesh në aspekte të ndryshme të funksionimit të institucioneve financiare individuale, funksionimin e tregjeve financiare dhe përgjithësisht të ekonomisë së përgjithshme. Kështu që, nga njëra anë, potencialisht mund të shkaktojnë përçarje të modeleve dhe sistemeve ekzistuese të biznesit, por nga ana tjetër është e mundur të lehtësojnë krijimin e ndërveprimeve të reja ekonomike dhe lidhjeve duke përmirësuar funksionimin e disa aspekteve të industrisë financiare globale, mbi të gjitha, sferën e infrastrukturës financiare dhe tregjeve financiare.

Përdorimi i monedhave digjitale (ose ende mund të gjenden si monedha virtuale ose krypto monedha) konsiderohet si metodë alternative për pagesë.<sup>197</sup> Bëhet fjalë për një kategori ende të parregulluar, e krijuar privatisht nga mjetet (digjitale) e përdorura nga të gjithë anëtarët e skemës së veçantë të një monedhe digjitale të veçantë. Ato kanë disa karakteristika monetare (përdoren si mjet elektronik për pagesë, por nuk paraqesin të ashtuquajturat para elektronike), por nuk janë të lidhura e as lëshohen si monedha sovraane (të ashtuquajtura fiat), dhe kështu nuk paraqesin detyrim për asnjë entitet, as edhe vlera e tyre është e garantuar, dmth e mbuluar nga ndonjë autoritet (pushtet) ose me ndonjë mjet tjetër (p.sh. me ar ose rezerva). Gjithashtu, monedhat digjitale nuk kanë vlerë reale<sup>198</sup> dhe kështu vlera e tyre rrjedh nga pritjet / besimet që mund të shkëmbehen për mallra dhe shërbime ose për një sasi të caktuar të monedhës sovraane në një moment të caktuar, që përcakton ofertën dhe kërkesën e monedhës<sup>199</sup>. Siç u përmend edhe më lart, përdorimi i tyre bazohet në teknologjinë e bonove të shpërndara, që paraqet një teknologji të re dhe innovative, që ndër të tjera mundëson zgjidhjen e decentralizuar dhe të largët të transaksioneve me monedha digjitale, pa ndërmjetës, pa nevojën për një entitet të centralizuar të besuar që bën zgjidhjen përfundimtare dhe pa ekzistencën e një institucioni apo personi i cili vepron në të gjithë sistemin e funksionimit të monedhës digjitale konkrete<sup>200</sup>. Krijuesit e skemave të monedhës digjitale theksojnë shpejtësinë dhe thjeshtësinë e transaksioneve me monedhat digjitale, shpenzimet e ulëta, anonimitetin

<sup>196</sup> Teknologjia e bazuar në të ashtuquajturin libër digjital i distribuuar e publik, gjegjësisht teknologjia e bonove të shpërndara paraqet një mënyrë relativisht të re, e decentralizuar, e transformimit të proceseve të pagesave, të kliringut dhe barazimit, përfshirë transferimin e mjeteve dhe mënyrat e bërjes së kliringut dhe barazimit të transaksioneve të letrave me vlerë (përfshirë dhe instrumentet derivative) dhe mallrat. Më konkretisht, bëhet fjalë për teknologjinë e cila kombinon më shumë komponentë, pra, rrjeti (networking), i cili siguron tejkalimin e problemit të shpenzimit të dyfishtë për të njëjtën sasi parash, ku çdo kompjuter funksionon si një server për të tjerët, pa pasur nevojë për të ashtuquajturin server qendror, ruajtjen e të dhënave të shpërndara dhe kriptografisë, që potencialisht mund të ndryshojë metodën e regjistrimit, ruajtjes dhe transferimit të mjeteve digjitale. Kjo teknologji e re konsiderohet se mund të reduktoj madje edhe të eliminoj joefikasitetin operacional dhe financiar, si dhe fërkimet tjera që ekzistojnë aktualisht gjatë zbatimit të metodave të ruajtjes, regjistrimit (evidentimit) dhe transferimit të mjeteve digjitale përmes tregjeve financiare. Burimi: Mills, David, Kathy Wang, Brendan Malone, Anjana Ravi, Jeff Marquardt, Clinton Chen, Anton Badev, Timothy Brezinski, Linda Fahy, Kimberley Liao, Vanessa Kargenian, Max Ellithorpe, Wendy Ng, and Maria Baird (2016). "Distributed ledger technology in payments, clearing, and settlement," Finance and Economics Discussion Series 2016095. Washington: Board of Governors of the Federal Reserve System, <https://doi.org/10.17016/FEDS.2016.095>.

<sup>197</sup> Burimi: Vondráčková, Aneta (2016). "Regulation of Virtual Currency in the European Union". Prague Law Working Paper Series. Charles University Law Faculty, [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2896911](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2896911).

<sup>198</sup> Më saktë, nuk ekzistojnë ato karakteristika themelore, siç është rasti me monedhat sovraane, në bazë të së cilave përcaktohet vlera e tyre e vërtetë.

<sup>199</sup> Burimi: Committee on Payments and Market Infrastructures, Bank for International Settlements (2015). "Digital currencies", <http://www.bis.org/cpmi/publ/d137.pdf>.

<sup>200</sup> Me fjalë të tjera, ndërlihdet nevoja për një bankë qendrore, veçanërisht në fushën e emetimit, krijimit të monedhave dhe barazimit të transaksioneve me ta.





relativ(ose më shumë pseudo-unanimitetin)<sup>201</sup>, mungesa e rrezikut të inflacionit e lidhur me to, siguria teknike dhe mungesa e procedurave burokratike si përparësi të rëndësishme gjatë pagesave me monedhat digjitale. Megjithatë, bankat qendrore, rregullatorët dhe mbikëqyrësit tregojnë për ekzistencën e rreziqeve të caktuara dhe paralajmërojnë për mungesën e rregullores për këtë sferë relativisht të re të shërbimeve financiare dhe rrjedhimisht mungesën e çfarëdo qoftë mbrojtjeje rregullatore për shfrytëzuesit e monedhave digjitale, gjatë humbjeve eventuale, të bazuara ose të pabazuara nga trajtimi i tyre (praktikisht, nuk ka asnjë mbrojtje ligjore për përdoruesit e monedhave digjitale, gjatë pjesëmarrjes së tyre në skema të tilla). "Krijimi" i monedhave digjitale nuk ndikohet nga masat monetare të bankave qendrore, as nuk vlen për ta sistemi i sigurimit të depozitave dhe mjeteve të logarive të transkacioneve me të cilët zakonisht mbulohe mjetet në institucionet depozituese, nuk është formuar as edhe një fond për dëmshpërblim eventuale të investitorëve në këto monedha (siç zakonisht ekzistojnë për të kompenzuar investitorët në letrat me vlerë), as nuk ekziston fond garantues për shlyerjen e detyrimeve mes anëtarëve të skemave të monedhave digjitale, në rast të një mungese eventuale të mjeteve, siç është rasti, për shembull, me depozitat e letrave me vlerë.

Aktualisht, në nivel global ekzistojnë një numër i madh i monedhave digjitale<sup>202</sup> me karakteristikat e tyre specifike. Karakteri i hapur i numrit më të madh të skemave - sistemet e monedhave digjitale, lehtësojnë bërjen e një kopje të softuerit në të cilin bazohen (zhargon, kjo procedurë ende quhet "pirun"). Në të vërtetë, me disa modifikime, përmirësimet në protokollet e sistemeve ekzistuese të monedhave digjitale mundësuan lëshimin e një monedhe digjitale të veçantë, të re (të rjetit), duke bërë që numri i valutave digjitale të rritet vazhdimisht. Bitkoini ndoshta është monedha digjitale më e njohur dhe e përhapur, që lidh fillimet e monedhave digjitale në përgjithësi. Në tetor të vitit 2008, autori me emrin Satoshi Nakamoto propozoi një sistem të decentralizuar të pagesave për shlyerjen e transaksioneve me mjete digjitale<sup>203</sup>, që tejkalon problemin e ashtuquajtur shpenzime të dyfishta për të njëjtën sasi mjetesh<sup>204</sup>, bazat e të cilit i shpjegoi në një dokument të titulluar "Bitcoin: një sistem i decentralizuar i pagesave elektronike"<sup>205</sup>.

<sup>201</sup>Skemat e monedhës digjitale ofrojnë anonimitet për përdoruesit e tyre, megjithatë nëse dhe sa do të zgjasë varet nga vetë përdoruesit, nga niveli i sofistikimit të teknologjisë që përdorin skemat e monedhës digjitale (nëse dhe sa lehtë mund të jenë të ekspozuar ndaj sulmeve të hakerëve, të cilat janë mjaft të mundshme për shkak të karakterit të hapur të skemave), si dhe nga përfshirja e palëve të treta - ofruesit e shërbimeve për klientët e tyre në fushën e monedhave digjitale.

<sup>202</sup>Përfaqësuesit më të rëndësishëm janë bitkoini, lajtikoini, prajmkoini, goldkoini, nejmikoini dhe pipikoini (Vondráčková, 2016).

<sup>203</sup>"Blokçain" ose zinxhir kriptografik nga blloqet është shembull i teknologjisë së bonove të shpërndara (e përdorur gjatë transaksioneve me bitkoinët dhe me disa monedha tjera digjitale), që përfaqëson bazë të të dhënave të decentralizuara, të shpërndara me një listë vazhdimisht në rritje të bonove (blloqeve) të ndërlidhura mes veti me të ashtëquajturin zinxhirë kohor (anglisht timestamping chain), me të cilën garantohet një mënyrë e sigurt e ruajtjes së bllokut digjital (e përbërë nga të bonot digjitale apo nga dokumentet për transaksionet me bitkoin), përfshirë dhe kohën e krijimit dhe ndryshimit të çdo blloku dhe bonit (as edhe pronari i bonit digjital nuk është në gjendje të bëjë ndryshime, nese boni nje herë është regjistruar, gjegjësisht i shtohet "zinxhirit të bonove", që shkon në favor të sigurisë dhe besueshmërisë më të madhe të kësaj baze të dhënash.

Burimi: Szczepanski, Marcin (2014). "Bitcoin: Market, economics and regulation", [http://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=LDM\\_BRI\(2014\)140793](http://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=LDM_BRI(2014)140793).

<sup>204</sup>Siç tregon edhe vetë emri, është një rrezik që të shpenzosh të njëjtën sasi parash (për shembull mund edhe bitkoin) në disa transaksione të ndryshme. Për këtë arsye, është kreu i logjikshme, me përjashtim të një personi, i cili me siguri do të merr shumën e plotë të mjeteve, të gjithë personat e tjerë, pjesëmarrës në transaksione (përtë cilët është bërë shpenzimi i së njëjtës sasi mjetesh) do mbeten pa pagesën e rënë dakord. Në sistemet e centralizuara të pagesave ekziston entitet i centralizuar që e bën ekzaminimin e nevojshëm se si nuk pësoi realizimi i më shume transaksioneve me përdorimin e sasisë së njëjtë të mjeteve. Në sistemet e decentralizuara të pagesave, një entitet i tillë nuk ekziston, dhe për këtë arsye shpenzimi i dyfishtë i të njëjtës sasi mjetesh është shumë e mundshme. Megjithatë, përmes aplikimit të teknologjisë së bonove të shpërndara (zinxhiri kriptografik nga blloqet - për shembull bllokçein) arriti të tejkaloj këtë problem.

<sup>205</sup> Nakamoto, Satoshi. (2008). "Bitcoin: A Peer-to-Peer Electronic Cash System", bitcoin.org. <https://bitcoin.org/bitcoin.pdf>.



Bitkoini parë u "gërmua"<sup>206</sup> në janar të vitit 2009, kur u realizua edhe transaksioni i parë i pagesës me Bitkoin dhe në të njëjtën kohë u bë i qasshëm edhe softueri i cili duhej të jetë në dispozicion për të qenë pjesë e skemës (rrjetit) Bitkoin<sup>207</sup>. Vijnë disa vite me interes shumë të vogël për Bitkoinin, dhe përgjithësisht për monedhat digjitale, për të arritur në një rritje të rëndësishme në vëllimin e tregtimit<sup>208</sup> me këtë monedhë digjitale nga fundi i vitit 2012 dhe rrjedhimisht një rritje në çmimin e saj dhe kapitalizimin e tregut. Siç pritej, vitet e fundit Bitkoini kishte pjesën më të madhe, edhe pse në rënie të vazhdueshme sa i përket pjesëmarrjes në treg mes monedhave digjitale. Në qershor të vitit 2017, në qarkullim ishin 16.4 milionë Bitkoin, me një kapitalizim tregu total prej rreth 48 miliardë dollarë amerikanë dhe pjesëmarrje tregu prej rreth 45% në kapitalizimin e përgjithshëm të monedhave digjitale<sup>209</sup> (burimi: <https://coinmarketcap.com/currencies/views/all/>). Disa autorë kohën e paraqitjes së Bitkoinit e lidhin (në prag të krizës financiare globale) me uljen e besimit në monedhat sovraane, kurse rritja më e rëndësishme e tregtisë me monedhat digjitale (nga fundi i vitit 2012 e tutje) lidhet me "kërkimin e fitimit" të investitorëve, në kushtet e normave të interesit historikisht të ulëta (Vondráčková, 2016). Një arsye tjetër e vërtetë e rritjes së atraktivitetit të monedhave digjitale, në vitet e fundit, lidhet me anonimitetin relativ të pjesëmarrësve në skemën e monedhës digjitale (BIS, 2015). Në dy vitet e fundit (nga 2015) u shfaq një monedhë digjitale e re, e quajtur etereum (ethereum), që u shndërrua në një konkurrent të rëndësishëm të bitkoinit. Etereumi konsiderohet si një version më i avancuar i Bitkoinit, i cili zotëron gjuhën e vet të shkrimit, që përsëri mundëson krijimin e kontratave komplekse smart<sup>210</sup>, aplikacioneve autonome të decentralizuara, madje edhe monedhave të tjera digjitale. Lëshimi i tij fillestar dhe zhvillimi është financuar me Bitkoin, të siguruara përmes procedurës së ashtuquajtur ofertë fillestare për monedhë (në anglisht. initial coin offering - ICO), përmes së cilës etereumi i ardhshëm (në atë kohë ende jo ekzistues) u shkëmbye (para shitjes) për

<sup>206</sup> Bllloqet janë të lidhura brenda një zinxhiri kriptografik të bllloqeve (që përdor bitkoinin) përmes procesit të ashtuquajtur "minierë" ose "gërmim". Me qëllim që të ruhet integriteti i zinxhirit kriptografik nga bllloqet, secili blllok i ri i fituar përmes "gërmimit" konfirmon integritetin e bllloqeve të mëparshme. Kështu që, secili blllok patjetër të plotësojë disa kërkesa që duhet t'i bashkëngjiten zinxhirit kriptografik të bllloqeve (është e nevojshme zgjidhja e algoritmeve komplekse matematikore). Bëhet fjalë për operacione komplekse dhe të kushtueshme që kërkojnë përdorimin e kompjuterëve të fuqishëm, më saktë pajisje, me harxhim të konsiderueshëm të energjisë elektrike. Me zgjidhjen eventuale të enigmës komplekse të dhënë matematikore "minieri" merr një numër të caktuar të bitkoinëve (numri i bitkoinëve, të marrë si shpërblim përgjysmohet çdo katër vjet, kurse në fillim merren 50 bitkoin) dhe zinxhiri kriptografik i bllloqeve përditësohet për të cilin janë të njoftuar të gjitha entitetet që janë pjesë e skemës (rrjetit) të bitkoinëve. Zgjidhja e detyrave matematikore është zakonisht një e ashtuquajtur si numri kriptografik i rastit (kodi) që duhet të plotësojë disa kushte të ndërlikuara për të siguruar lidhjen digjitale të një bllloki me tjetrin dhe në të njëjtën kohë është jashtëzakonisht e vështirë për t'u hakuar dhe falsifikuar, që mos shkelet integriteti i zinxhirit kriptografik i bllloqeve dhe në përgjithësi besueshmëria e skemës së përgjithshme të përdorimit të monedhave digjitale (në rastin konkret të bitkoinit). Burimi: Szczepanski, 2014.

<sup>207</sup> Burimi: Centre for the Edge, Deloitte, Australia. "Bitcoin, Blockchain & distributed ledgers: Caught between promise and reality", <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/au/Images/infographics/au-deloitte-technology-bitcoin-blockchain-distributed-ledgers-180416.pdf>.

<sup>208</sup> Tregtarët me monedha digjitale posedojnë të ashtuquajturat kuletat digjitale, që në thelb përfaqësojnë adresa (për shembull: 1EDcAwz23CdxRVQmDvUJLU8ynB3sdeMSk). Që të mund tregtarët të trajtojnë portofolin (kuletën) e tyre përdorin dy lloje të çelësave (kode) - privat (kodin personal, që të mund të hapin portofolin) dhe publik, që jep vendndodhjen e saktë, gjegjësisht adresën e portofolios (çelësi publik shpesh herë ndryshohet). Tregtia me monedha digjitale bëhet nëpërmjet platformave tregtare. Tregtarët më së pari dërgojnë një kërkesë në rrjetin e monedhës digjitale për tregtim me një numër të caktuar bitkoinësh, kurse transaksionet (më saktë grupi i transaksioneve, i njohur gjithashtu si një blllok në rastin e zinxhirit kriptografik të bllloqeve) duhet patjetër të konfirmohen nga "minatorët", për të cilët u diskutua më sipër. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe të ashtuquajturat portet e pagesave, përmes të cilave është e mundur shkëmbimi i monedhave digjitale me ato sovraane (Vondráčková, 2016). Shembull i një porti pagese është BitPay.

<sup>209</sup> Për shkak të ndryshimit të theksuar në çmimin e bitkoinit dhe monedhave të tjera digjitale, kapitalizimi i tyre në treg mund të pësojë ndryshime të rëndësishme, madje edhe në baza ditore.

<sup>210</sup> Kontratat smart, janë protokolle kompjuterike që lehtësojnë, verifikojnë dhe zbatojnë, përmbushin (negociojnë) ekzekutimin e një kontrate të caktuar, bëjnë klauzola kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht vetë-ekzekutues dhe / ose vetë-përmbushës. Për këtë arsye, kontratat smart konsiderohen më të sigurta dhe më të lira (me kosto më të ulët) krahasuar me negociatat tradicionale.



Bitkoin. Ofertat fillestare të monedhave u bënë mjaft të popullarizuara, sepse shmangnin mënyrën konvencionale të sigurimit të mjeteve, a janë mjaft të ngjashme me ofertat fillestare të letrave me vlerë (në vend të letrave me vlerë ose kapitalit, pronarët e monedhave digjitale ende joekzistuese thuhet se posedojnë të ashtuquajturat tokene virtuale). Në këtë mënyrë, sigurohet vetëfinancimi i skemave të monedhës digjitale, me çka arrihet një shkallë e lartë e vetë qëndrueshmërisë së këtyre sistemeve.

### ***Sfidat e pritshme për bankat, bankat qendrore dhe organet rregullatore***

Është e vështirë të supozohet se çfarë do të ishte roli dhe funksionimi i bankave qendrore dhe ndërmjetësve financiarë (dhe veçanërisht bankave), në një botë ku është mjaft e përhapur përdorimi i monedhave digjitale dhe teknologjia që ata përdorin. Mund të pritët që bankat të përballen me sfida domethënëse, një proces shumë i mundshëm i shpërbërjes dhe ndryshimeve të rëndësishme në mekanizmat e pagesës, kursimit dhe qasjes në kredi. Zëvendësimi eventual i monedhave sovraane me monedhat digjitale mund të çojë në një reduktim të detyrimeve pa interes të bankave qendrore, të cilat me siguri do të kishin reaguar duke i zëvendësuar ato me detyrime me interes dhe / ose thjesht do lejonte zvogëlimin e vëllimit të bilanceve të tyre (e çfarë është ajo, për shembull, përplasje e plotë me mënyrën në të cilën bankat qendrore iu përgjigjën krizës globale financiare dhe pasojave të saj - nëpërmjet një rritje drastike të vëllimit të bilancit të saj). Rezultati përfundimtar do të ishte një reduktim në fitimet e bankave qendrore, për shkak të humbjes së të ardhurave nga sinjorazhi. Gjithashtu, skemat e monedhave digjitale mund të kenë efekte të rëndësishme në (karakterin, strukturën, hartimin dhe efektivitetin e instrumenteve) zbatimin e politikës monetare nga bankat qendrore si emetues të monedhave sovraane dhe në kërkesën për agregat monetarë, që para se gjithash është përcaktuar nga fushëveprimi i kërkesave për alokimin e rezervave të detyrueshme (për shembull, nëse dhe si kërkesat për alokimin e rezervave të detyrueshme mund të zgjerohen nga sistemet bankare në skemat e monedhave digjitale) si dhe nga shkalla e lidhjes ekonomike dhe financiare mes përdoruesve të monedhave sovraane dhe përdoruesve të monedhave digjitale (BIS, 2015).

Pavarësisht rritjes relative të zbatimit të monedhave digjitale në vitet e fundit, megjithatë edhe më tej, skemat e monedhave digjitale në nivel global, i pranuan dhe i përdorin një numër i vogël i përdoruesve dhe akoma po përballen me një numër sfidash që mund të kufizojnë rritjen e tyre në të ardhmen. Për këtë arsye, ndikimi i tyre në shërbimet financiare dhe ekonominë në përgjithësi dhe në stabilitetin financiar dhe monetar deri më tani është modest, kurse disa autorë mendojnë se në afat të gjatë, duke pasur parasysh sfidat e shumta me të cilat përballen, monedhat digjitale do të mbeten një produkt i pranuar nga një numër i kufizuar përdoruesish dhe do të mbeten në kufijtë shërbimeve kryesore financiare (BIS, 2015). Megjithatë, pritët që teknologjia inovative mbi të cilën bazohet përdorimi i tyre të gjejë aplikime alternative dhe të përmirësojë aspekte të caktuara të sistemeve të pagesave dhe në përgjithësi infrastrukturën financiare, veçanërisht në fushën e tejkalimit të nevojës për krijimin e një rrjeti të centralizuar transaksionesh dhe kostove shtesë që bart ai<sup>211</sup>. Ndër të tjera, përdorimi i monedhave digjitale konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në shërbimet e pagesave me pakicë (pagesat ndërmjet personave fizik, tregtisë elektronike, pagesave ndërkufitare dhe të ngjajshme), duke i bërë ato më të shpejta dhe më të lira për përdoruesit e fundit


<sup>211</sup>Përdorimi eventual më i madh dhe më i gjerë i monedhave digjitale (para se gjithash, teknologjia e bonove të shpërndara) mund të ndryshojë dukshëm pamjen e infrastrukturës financiare. Kështu që, këto risi mund të kenë një ndikim të rëndësishëm mbi pamjen dhe mënyrën e regjistrimit të kolateralit të lënë peng, regjistrimin e aksioneve, obligacioneve, tregtimi me instrumentet derivative dhe mjeteve tjera, si dhe në zbatimin e pagesave, tregtimin, kliringun dhe barazimin. Ndryshimet e tilla, nga ana e tyre, mund të rrezikojnë mbijetesën e disa ofruesve tradicionalë të shërbimeve nga kjo fushë, jo vetëm në segmentin e shërbimeve të pagesave me pakicë, por edhe në fushën e pagesave me shumicë (përfshirë edhe nevojën nga funksionimi i depozituesve qendrorë dhe barazimi i letrave me vlerë)(BIS, 2015).

(konsumatorët dhe shitësit), ndonëse është ende shumë herët për të vlerësuar si do të ishin efektet në efikasitetin e sistemeve të pagesave, përfshirë edhe rreziqet e mundshme që lidhen me funksionimin e skemave të bazuara në monedhat digjitale dhe teknologjinë e bonove të shpërndara. Domethënë, se në të ardhmen e afërt pikërisht ndikimi i përdorimit të monedhave digjitale në sistemet e pagesave mund në një farë mase të ndikojë në bankat qendrore, si institucione përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemeve të pagesave. Nga ana tjetër, përdorimi eventual më i madh dhe më i gjerë i monedhave digjitale dhe teknologjia që i mbështet mund të ketë një ndikim të rëndësishëm edhe mbi fusha tjera me interes për bankat qendrore - stabilitetin financiar dhe politikën monetare (BIS, 2015). Një pjesë nga rreziqet e përfshira në përdorimin e monedhave digjitale janë të ngjashme me ato që lidhen me monedhat sovraane, veçanërisht kur përdoren në formën e parasë elektronike, por një pjesë tjetër e rreziqeve janë specifike dhe rezultojnë nga karakteristikat e veçanta të monedhave digjitale dhe teknologjia inovative mbi të cilat janë edhe të bazuara.

### ***Rreziqet për pjesëmarrësit në skemat e monedhës digjitale***

Grafik108

Çmimi i Bitkoinit në dollarë amerikan dhe përqindja e saj e përditshme (majtas), ndryshimet mujore dhe vjetore (djathtas)



Burimi: [www.bloomberg.com](http://www.bloomberg.com)

Ndryshimi i theksuar në çmimin e monedhave digjitale është një rrezik i rëndësishëm për ata që i zotërojnë ato. Gjegjësisht, siç u përmend më sipër, vlera e tyre bazohet vetëm në besimin se ata në një moment të dhënë mund të shkëmbehen për mallra dhe shërbime, ose për një sasi të caktuar të monedhës sovraane, që përcakton ofertën dhe kërkesën e këtyre monedhave digjitale. Në fillim të vitit 2013, pas fillimit të tregtisë më të madhe me Bitcoin, çmimi i Bitkoinit arriti rreth 10 dollarë amerikan (më parë çmimi ishte më pak se 1 dollarë amerikan dhe me një çmim të tillë nuk kishte blerës të interesuar), e në qershor të vitit 2017 të afrohet në nivelin e 3.000 dollarë amerikan për 1 bitcoin. Në tre vitet e fundit (qershor 2014 - qershor 2017), ndryshimet ditore në çmimin e bitkoinit variuan nga -25% deri + 20%, dhe ndryshimet mujore nga -50% deri + 100%, që tregojnë një ndryshueshmëri të theksuar në çmimin e bitkoinit dhe rritjen e rreziqeve të investimit nga investimi në këtë monedhë digjitale. Por, nga ana tjetër, karakteristikë e monedhave digjitale është korrelacioni i ulët i fitimeve të tyre me fitimet në klasat e



mbetura të mjeteve të investimit, që në fakt vepron si një pronë tërheqëse për ata investitorë që analizojnë investimet në monedhat digjitale dhe e analizojnë si një rimbushje të një portofoli tjetër të mjeteve. Prandaj, na habit fakti që në vitin 2016, rreth një e treta e Bitkoinëve ishin në pronësi të individëve të cilët vetëm "morën" Bitcoin, por kurrë nuk u "dërguan" Bitcoin pjesëmarrësve tjerë në rrjet, kurse pakicë ishin përdoruesit që e përdornin Bitcoinin kryesisht si mjet për pagesë<sup>212</sup>. Kjo tregon se në mesin e bartësve ekzistues të Bitcoinit, është zhvilluar perceptimi për të si një mjet investimi, që praktikisht do të thotë se motivi spekulativ është dominues për përfshirjen e tyre në skemat e monedhave digjitale.

Rreziqet nga mashtrimet<sup>213</sup>, sulmet e hakerëve të platformave për tregtimin me monedhat digjitale, rreziqet operacionale në funksionimin e infrastrukturës që mbështet përdorimin/tregtimin e monedhave digjitale, rrezikun e shlyerjes (të pranishëm për palët e treta që ofrojnë shërbime lidhur me monedhat digjitale për klientët e tyre), janë mjaft të sigurta. Edhe përkundër mbrojtjes kriptografike të të ashtuquajtura kuletat digjitale, prapë se prapë ekziston rreziku nga ndërhyrjet e hakerëve në kuletat digjitale (portofolit) dhe grabitjen e tyre. Teknologjia në të cilën bazohet përdorimi i monedhave digjitale nuk është imun ndaj problemeve<sup>214</sup> operacionale dhe problemeve tjera, e në veçanti janë të theksuara rreziqet nga sulmet e hakerëve në platformat për tregti me këto monedha, duke pasur parasysh natyrën publike, të hapur dhe fleksibile të skemave të monedhës digjitale. Po ashtu, ngritja e nivelit të sigurisë dhe të sigorisë së sistemit të përgjithshëm - skema e monedhës digjitale dhe cilët do qoftë përmirësime tjera nuk bëhen të centralizuara, por bëhen me një formë të konsensusit të pjesëmarrësve në skemë, që mund të ngadalësojë përmirësimet e nevojshme dhe rrit cenueshmërinë e sistemit të përgjithshëm<sup>215</sup>. Së fundi, mungesa e një strukture të qartë ligjore, në aspektin e të drejtave dhe përgjegjësive të palëve të veçanta të përfshirë në transaksionet me monedha digjitale thekson dhe rrezikun ligjor. Rreziqet e tilla, në fakt, veprojnë si faktorë kufizues për një zgjerim masiv të shkallës së pranueshmërisë së monedhave digjitale.

Anonimiteti relative (ose edhe pseudo-anonimiteti) mbajtësit e monedhave digjitale i bën tërheqëse për përdorim në aktivitetet që lidhen me larjen e parave, financimin e terrorizmit, mashtrimin dhe evazionit fiskal dhe në aktivitete tjera kriminale. Kjo para se gjithash varet nga ajo se sa (e sofistikuar dhe e mbrojtur nga sulmet e hakerëve) dhe çfarë evidence e të dhënave për transaksionet me të dhëna digjitale ruhet

<sup>212</sup> Burimi: Baur, Hong и Lee: „Virtual currencies: Media of exchange or speculative asset?“, SWIFT institute working papers nr.2014-007, qershor të vitit 2016, në dispozicion [https://www.swiftinstitute.org/wp-content/uploads/2016/06/Bitcoin-Baur-et-al\\_-2016-SWIFT-FINAL.pdf](https://www.swiftinstitute.org/wp-content/uploads/2016/06/Bitcoin-Baur-et-al_-2016-SWIFT-FINAL.pdf). Në këtë material, ndër të tjera konstatohet se rritja e kërkesës për monedha digjitale nga përdoruesit e mundshëm, për shkak të vetë dizajnit të skemave ndikon në rritjen e çmimit të tyre, që më tej tërheq investitorët spekulativë dhe ndikon edhe më tej në rritjen e kërkesës, që në thelb e kufizon përdorimin e monedhës digjitale si mjet këmbimi për mallra dhe shërbime (dmth për qëllime pagesore).

<sup>213</sup> Për shembull, është i njohur mire rasti me OneCoin (anglisht OneCoin), që megjithëse u ngjan modeleve të monedhave digjitale, megjithatë, në thelb përfshin elementë të skemave mashtruese piramidale (të ashtuquajtura në anglisht pony). Pjesëmarrësit në këtë skemë janë të udhëhequr të besojnë se "gërmojnë" dhe investojnë në monedhën digjitale (OneCoin), e madje edhe vetë organizata OneCoin (për përfaqësuesit qendror u vërtetua se edhe më herët kanë qenë të përfshirë në skemat piramidale), pretendon për veten se merrtet me shitjen e materialeve edukative për tregti. Në shumë vende (për shembull: Itali, Indi, Gjermani, Belize), janë ndërmarrë procedura ligjore për të hetuar dhe madje për të ndaluar aktivitetet e rrjetit të OneCoin. Aktualisht, këto të OneCoin nuk mund të shkëmbehen për asnjë monedhë tjetër, kurse më parë konvertimi i tyre bëhej përmes tregut të brendshëm (me kufijtë e përcaktuar ditor), organizuar në kuadër të skemës OneCoin, e cila në janar të vitit 2017 u mbyll pa ndonjë njoftim. Burim: <https://cointelegraph.com/news/one-coin-much-scam-onecoin-exposed-as-global-mlm-ponzi-scheme>

<sup>214</sup> Këshilli për mbikëqyrjen e stabilitetit financiar në SHBA (në anglisht: Financial Stability Oversight Council - FSOC) në raportin e tij vjetor të vitit 2016 tregon vonesa të rëndësishme në tregtinë me bitcoin, si dhe një sërë transaksionesh të pasuksesshme me këtë monedhë digjitale (burimi: Financial Times, June 22, 2016, "Regulators say bitcoin poses 'financial stability risks'").

<sup>215</sup> Burimi: Committee on Payments and Market Infrastructures, Bank for International Settlements (2015). "Digital currencies", <http://www.bis.org/cpmi/publ/d137.pdf> p.p. 15.



në skemat e monedhës digjitale (më saktë, në teknologjinë e bonove të shpërndara), mundësia e tregtisë së lirë ndërkufitare me monedhat digjitale dhe konvertimi i tyre në monedha sovraane, si dhe nga përfshirja e palëve të treta - ofruesve të shërbimeve për klientët e tyre në fushën e monedhave digjitale (më saktësisht përputhshmërinë e tyre me standardet për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit).

Duke e pasur parasysh faktin se monedhat digjitale janë sferë e parregulluar, kurse në nivel global ende nuk ekziston një agjendë e qartë se në cilin drejtim dhe vëllim do të rregullohej përdorimi i këtyre monedhave, mbajtësit e monedhave digjitale duhet të jenë të vetëdijshëm edhe për ekzistencën e një rreziku<sup>216</sup> të rëndësishëm rregullator. Në veçanti, futja e mundshme e kufizimeve rregullatore më të mëdha në përdorimin dhe mënyrën e funksionimit të skemave të monedhave digjitale mund edhe më tej të shkaktojë realizimin e rrezikut të investimeve, gjegjësisht duke ndikuar negativisht në çmimet e këtyre monedhave, e madje mund të rrezikojnë ekzistencën e disa prej tyre dhe / ose platformave perms së cilave tregtohet me monedha digjitale<sup>217</sup>.

Banka popullore, në disa raste, nëpërmjet njoftimeve publike vuri në dukje rreziqet e investimeve dhe tregtimin me monedhat digjitale. Gjithashtu, sipas rregullores dhe ekzistencës së të ashtuquajturit regjimi devizor, hapja, gjegjësisht mbajtja e llogarive jashtë vendit është e përcaktuar me një vendim të veçantë e sjellë nga Banka popullore, ku me ç'rast banorët (persona juridikë ose fizikë) të Republikës së Maqedonisë nuk mund të hapin, gjegjësisht të mbajnë llogari jashtë vendit, e as të rruajnë paranë këto llogari, përveç në kushte të veçanta, të tilla si mbi bazë të qëndrimit të rregulluar më gjatë se tre muaj ose gjatë marrjes së një vizë pune jashtë vendit, dhe kushteve të tjera të përcaktuara në vendimin në fjalë. Për këtë arsye, ekzistojnë kufizime rregullatore për rruajtjen e parave në llogaritë jashtë vendit (përfshirë investimet në monedhat digjitale) si dhe për transferimin e mjeteve nga jashtë në llogaritë bankare në Republikën e Maqedonisë (të cilat do të kishin origjinën nga konvertimi i një monedhe digjitale në një monedhë të caktuar sovraane, për shembull euro ose dollarë). Megjithatë, duhet të kihet parasysh se tek zinxhirët kriptografikë publikë të blloqeve, ndërlidhet nevoja/roli i bankave dhe në përgjithësi bartësve të qarkullimit pagesor, me çka kushdo qoftë (përfshirë dhe entitetin që zotëron një portofol digjital) mund të marrë bazën e zinxhirit kriptografik të blloqeve, me të gjitha

<sup>216</sup> Institucione të caktuara të BE-së në disa raste dhe në forma të ndryshme kanë deklaruar pikëpamjet dhe mendimet rreth monedhave digjitale dhe rregullimin e tyre në të ardhmen. Ndër të tjera, banka qendrore Europiane, organi bankar Europian, komisioni Europian dhe komiteti për çështjet ekonomike dhe monetare në raportet e tyre ose në deklaratat zyrtare kanë paraqitur pikëpamjet mbi rreziqet nga përdorimi i monedhave digjitale dhe rregullimin e tyre në të ardhmen, e në vitin 2016 edhe parlamenti Europian miratoi (jo të detyrueshme) rezolutën për keto monedha me të cilat, ndër të tjera, kërkon nga komisioni Europian të krijohet një grup pune i cili do të monitorojë zhvillimin e skemave për monedhat digjitale. Lidhur me këtë të fundit, në vitin 2017, komisioni Europian formoi të ashtuquajturën konsorcium për monedhat digjitale dhe "uebin e zi" (në anglisht: Digital Currency and Dark Web Consortium), i quajtur Titanium, qëllimi kryesor i të cilit është parandalimi i aktiviteteve kriminale dhe terroriste të lidhura me përdorimin e monedhave digjitale dhe i ashtuquajtur ueb i zi (në anglisht: dark web or darknet market), si dhe zhvillimin e drejtimeve dhe udhëzimeve për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, informacioneve dhe njohurive, dhe të ngjashme. Në korrik të vitit 2016, komisioni Europian paraqiti një rishikim të direktivës së katërt Europiane për parandalimin e larjes së parave, me të cilën ndër të tjera vendoset një detyrim për ofruesit e shërbimeve që lidhen me kuletat digjitale dhe tregtimin e valutave digjitale për kryerjen e analizave të thella për klientët e tyre dhe për raportimin e transaksioneve të dyshimta tek autoritetet dhe organet përgjegjëse, që do të kontribuonte në reduktimin e anonimitetit relativ, për momentin i pranishëm në skemat e monedhave digjitale. Aktivitete të caktuara për rregullimin e monedhave digjitale janë vërejtur edhe në vende të veçanta, të tilla si në Gjermani, Republikën Çeke, Kinë (Vondrackova, 2016).

<sup>217</sup> Përdorimi i bitkoinit si monedhë digjitale më e përhapur, është e legalizuar si mjet për pagesë në disa vende, por në të tjerat vende përdorimi i tij nuk është i rregulluar aspak, dhe në vendet e treta është e ndaluar në mënyrë eksplicite për përdorim ose kufizohet në mënyrë implicite në përdorimin e saj në operacionet e pagesave në vend, siç është rasti me Republikën e Maqedonisë.



Ilogaritë dhe transaksionet e bëra deri në momentin e marrjes (shkarkimit) dhe ta rruaj për vete (me fjalë të tjera, transaksionet për blerjen dhe shitjen e monedhave digjitale dhe për blerjen dhe shitjen e mallrave me monedha digjitale mund të bëhen pa ndërmjetësimin e bankave). Monedhat digjitale nuk përmenden në rregulloret vendore dhe nuk duhet të identifikohen me paratë elektronike në kuptim të ligjit mbi qarkullimin pagesor.

Përdorimi i Bitkoinit si monedhë digjitale më e përhapur, është e legalizuar si mjet për pagesë në disa vende, por në të tjerat vende përdorimi i tij nuk është i rregulluar aspak, dhe në vendet e treta është e ndaluar në mënyrë eksplicite për përdorim ose kufizohet në mënyrë implicite në përdorimin e saj në operacionet e pagesave në vend, siç është rasti me Republikën e Maqedonisë.